


Strategjia e Territorit Bashkia Dibër



Shkurt 2016

Ky publikim është përgatitur nga Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal (dldp), me mbështetjen financiare të Agjencisë Zvicerrane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

Përgatitur nga:

Z. Besnik Alku,

Znj. Lindita Manga

Z. Zenulla Mehmeti

Fondacioni Shqiptar për Zhvillimin e Kapaciteteve Lokale (ALCDF)

Mbështetur nga:

Valbona Karakaçi, Elvin Hoxha

Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal (dldp)

HELVETAS Swiss Intercooperation, Shkodër, Albania

Ky publikim reflekton mendimet e autorëve dhe jo detyrimisht të SDC.

Publikuar nga:

Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal (dldp)

HELVETAS Swiss Intercooperation (HSI) Albania

Rr. Oso Kuka, Nr. 11,

4000 Shkodër, Albania

www.dldp.al



Funded by



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confederation suisse
Conderazione Svizzera
Confederaziun svicra

**Swiss Agency for Development
And Cooperation SDC**



HELVETAS
Swiss Intercooperation

ALBANIA

Përmbajtja

Kapitulli I. Hyrje.....	1
1. Përshkrimi i përgjithshëm.....	1
2. Përmbajtja e strategjisë.....	1
3. Procesi i bashkëpunimit.....	3
4. Metodologjia.....	4
Kapitulli II: Analiza metabolike (Profili i bashkisë Dibër).....	5
1. Karakteristikat fiziko - gjeografike.....	5
1.1 Pozita gjeografike.....	5
1.2 Relievi.....	6
1.3 Pasuritë nëntokësore.....	7
1.4 Klima.....	7
1.5 Sizmiciteti.....	8
2. Karakteristikat mjedisore.....	9
2.1 Elementet mjedisore.....	9
2.1.1 Parqet natyrore.....	9
2.1.2 Monumentet e natyrës.....	10
2.1.3 Peizazhi natyror.....	11
2.1.4 Mjedisi ujor.....	11
2.1.5 Biodiversiteti (flora dhe fauna).....	12
2.2 Analiza e problematikave mjedisore.....	12
2.2.1. Menaxhimi i mbetjeve.....	12
2.2.2 Pasojat në florë dhe faunë.....	13
2.2.3 Zjarret.....	14
2.2.4 Erozioni i tokës.....	14
2.2.5 Dëmtimet në pyjet e larta.....	15
3. Karakteristikat e zhvillimit rajonal.....	16
3.1 Pozicioni strategjik rajonal.....	16
3.2 Identiteti historik.....	16
4. Karakteristikat ekonomike.....	19
4.1 Informacioni i përgjithshëm.....	19
4.2 Investimet.....	19
4.3 Fuqia punëtore (format e punësimit).....	20
4.3.1 Struktura e punësimit.....	20
4.3.2 Sektori privat jobujqësor.....	20
4.3.3 Papunësia.....	21
4.3.4 Emigrimi.....	21
4.3.5 Formimi profesional.....	21
4.4 Ndërveprimi ekonomik.....	22
4.5 Sektorët ekonomikë kryesorë.....	22
4.5.1 Bujqësia dhe blegtoaria.....	23
4.5.2 Turizmi.....	27
5. Karakteristikat sociale.....	29
5.1 Analiza dhe vlerësimi i problematikave sociale.....	29
5.1.1 Papunësia.....	29
5.1.2 Varfëria dhe grupet e rrezikuara.....	29
5.1.3 Përrjashtimi social i grupeve të rrezikuara.....	29
5.2 Analiza e zhvillimit social, punësimit, edukimit, shëndetit.....	30
5.2.1 Arsimi.....	30

5.2.2	Shëndetësia	31
5.2.3	Strehimi	32
6.	Karakteristikat demografike/Demografia.....	33
7.	Infrastruktura.....	35
7.1	Infrastruktura rrugore.....	35
7.2	Trafiku rrugor dhe parkimi	36
7.3	Transporti publik.....	36
7.4	Ujësjetës-kanalizimet.....	36
7.5	Rrjeti i kanalizimeve	37
7.6	Rrjeti elektrik dhe rrjeti i telefonisë celulare	37
7.7	Menaxhimi i mbetjeve urbane.....	38
7.8	Infrastruktura e ujitjes	38
8.	Çështjet e pronësisë.....	40
8.1	Pronat publike	40
8.2	Pronësia mbi tokën.....	41
9.	Çështjet, zonat dhe/ose objektet e rëndësisë kombëtare	43
10.	Analiza e elementeve të rëndësishme territoriale.....	44
10.1	Zonat gjeotermale	44
10.2	Zonat e mbrojtura natyrore	44
10.3	Zonat arkeologjike dhe historike.....	44
11.	Analiza e përdorimit ekzistues të tokës.....	45
11.1	Karakteristikat e tokës.....	45
11.2	Përdorimi i tokës	45
12.	Analiza e periferialitetit	47
	Kapitulli III: Ndarja e territorit sipas sistemeve bazë	48
1.	Sistemet bazë	48
1.1	Sistemi urban (UB)	48
1.2	Sistemi natyror	50
1.3	Sistemi bujqësor.....	51
1.4	Sistemi ujqor	52
1.5	Sistemi infrastrukturor	52
2.	Analiza e pikave të forta, pikave të dobëta, mundësive dhe rreziqeve	53
3.	Konkluzionet e pas analizës	53
	Kapitulli IV: Drejtimit e zhvillimit të territorit në bazë të treguesve të sistemeve	58
1.	Zhvillimi i sistemit urban.....	58
2.	Zhvillimi i sistemit të infrastrukturës.....	59
3.	Zhvillimi i sistemit bujqësor	59
4.	Zhvillimi i sistemit natyror	61
5.	Zhvillimi i sistemit ujqor.....	62
	Kapitulli V: Vizioni i zhvillimit të territorit të njësisë vendore	63
1.	Deklarata e vizionit	63
2.	Orientimet tematike strategjike.....	63
	Kapitulli VI: Objektivat strategjike për zhvillimin e territorit e njësisë vendore.....	66
	Kapitulli VII: Programet dhe projektet kryesore të zhvillimit	68
	Kapitulli VIII: Plani i veprimeve (Plani i Investimeve Kapitale)	80
1.	Plani i veprimit.....	80
2.	Plani i Investimeve Kapitale	80
3.	Analiza e aktorëve kryesorë bashkëfinancues.....	82
4.	Projektet prioritare për investimet kapitale në bashkinë Dibër	83
5.	Rekomandimet	86
	Anekset	87

Kapitulli I. Hyrje

1. Përshkrimi i përgjithshëm

Qëllimi i këtij dokumenti është të prezantojë vizionin afatgjatë të zhvillimit të territorit të bashkisë Dibrë deri në vitin 2030, si dhe të parashikojë strategjitë dhe programet për një zhvillim dhe rritje social-ekonomike të qëndrueshme në territorin e Dibrës.

Përgatitja e këtij plani ka filluar si nismë dhe detyrim, me miratimin e ndryshimeve në ligjin nr. 107/2014, datë 31.7.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” dhe me aprovimin e rregullores së Planifikimit të Territorit VKM nr. Nr. 671, datë 29.7.2015. Kështu, njësitë e reja vendore do të hartojnë Planin e Përgjithshëm Vendor (PPV) në kontekstin e nevojave të rivitalizimit të zonave urbane dhe rurale në këtë territor. Në këtë strategji do të përfshihen nevojat dhe perspektiva e zonës së Dibrës. Kjo, në përputhje me strategjitë dhe përgjegjësitë që dalin nga zbatimi i detyrimeve të ndryshme, siç janë konventat ndërkombëtare, kuadri ligjor, normativat teknike, etj.

Hartimi i këtij dokumenti mbështetet në konsultimin dhe studimin e Programit të Zonës Funktionale të Dibrës, i hartuar pas Reformës Territoriale nga Programi për Decentralizimin dhe Zhvillim Lokal (DLDP). Ky i fundit, i financuar nga qeveria zvicerane në periudhën nëntor 2014 - qershor 2015. Programi i Zonës Funktionale të Dibrës është përfshirë në shumë kapituj të kësaj strategjie, si pjesë integrale e një dokumenti të plotë.

2. Përmbajtja e strategjisë

Strategjia e zhvillimit të territorit është një plan zhvillimi për bashkinë e Dibrës dhe mbështetet në Planin e Përgjithshëm Kombëtar (PPK) të hartuar në vitin 2015 nga Ministria e Zhvillimit Urban dhe Agjensia e Kontrollit dhe Planifikimit të Territorit (AKPT).

Dokumenti i strategjisë përmban dhe përshkruan:

- Profilin e bashkisë së Dibrës, duke dhënë karakteristikat sociale, ekonomike dhe natyrore, duke bërë një analizë të gjendjes aktuale (analiza metabolike) dhe duke përshkruar territorin e saj sipas pesë sistemeve bazë: urban, bujqësor, natyror, infrastrukturor dhe ujor.
- Sfidat, me të cilat përballet dhe ato, çfarë plan-strategjia kërkon të adresojë në përcaktimin e objektivave për zgjidhjen e tyre;
- Vizionin e zhvillimit të një territori që përmbush dëshirat dhe nevojat e popullsisë së Dibrës, bizneseve dhe vizitorëve, në një të ardhme të afërt;
- Strategjinë që e orienton drejt rritjes së qëndrueshme dhe arritjes së vizionit;
- Politikat dhe prioritetet që do të zbatohen për përmbushjen e strategjive;
- Planin e veprimit, që shoqërohet nga kuadri zbatues dhe monitorues i tij. Ky plan veprimi shoqërohet edhe nga plani i investimeve kapitale në territorin e bashkisë së Dibrës.

Bashkia e Dibrës ka si detyrim ligjor të përgatisë, monitorojë dhe rishikojë Strategjinë e Zhvillimit të Territorit. Kjo strategji parashikon përmbushjen e detyrimeve dhe bashkëveprimet me Planin e Përgjithshëm Kombëtar (PPK), si dhe zbatimin rigoroz të politikave të parashikuara në të, si për shembull: i) zhvillimi i infrastrukturës kombëtare që lidh Shqipërinë me korridoret e transportit pan-europian; ii) zhvillimi i Shqipërisë si qendër ndërlidhëse infrastrukturore dhe energjitike për rajonin e Ballkanit; iii) rritja (zhvillimi) inteligjente e sistemit urban përmes zhvillimit policentrik, densifikues dhe gjithëpërfshirës; iv) promovimi dhe aksesimi i zonave me karakteristika natyrore e peisazhistike, menaxhimi inteligjent i pasurive natyrore dhe trashëgimisë kulturore, i cili siguron ruajtjen e identitetit dhe diversitetit kulturor, duke i bërë aktive dhe kontribuese në rritjen ekonomike të vendit përmes riaktivizimit si asete nëpërmjet përmirësimit të aksesueshmërisë dhe përshtatshmërisë së tyre; v) zhvillimi i sistemit të transportit multimodal dhe miqësor me ambientin; promovimi i transportit të integruar dhe i koncepteve të reja të lëvizjes miqësore me ambientin, transport që mbështet zhvillimin policentrik të territorit, për të arritur një progres gradual që siguron akses të barabartë në infrastrukturë dhe ekonomi; vi) zhvillimi i infrastrukturës energjitike të diversifikuar drejt energjisë së rinovueshme; vii) planifikimi dhe zhvillimi i integruar i flukseve shpërndarëse e ndërlidhëse të komunikimit, transportit, ushqimit dhe energjisë që siguron zhvillim koheziv, eficient e cilësor të korridoreve të mësipërme.

Pas aprovimit, bashkia do ta bëjë pjesë të punës së saj zbatimin e kësaj strategjie, si në plan-buxhetet vjetore, ato afatmesme dhe në planet e investimeve kapitale.

Plan-strategjia e zhvillimit të territorit të bashkisë së Dibrës kërkon të promovojë zhvillimin ekonomik dhe rritjen e punësimit duke dhënë siguri që ndërtimet e reja do të përmbushin nevojat e popullsisë me aktivitete tregtare (të vogla e të mesme) dhe sociale (sportive dhe argëtuese). Strategjia ka për qëllim të përmirësojë e të ruajë vlerat dhe cilësitë e mira natyrore e historike, si një komponent i rëndësishëm në tërheqjen e investimeve. Qëllimi final është zhvillimi i qëndrueshëm dhe i suksesshëm i zonës. Strategjia nuk është një “plan ndërtimi”, apo një “plan investimi”, por një përcaktim dhe orientim i hapësirave dhe zonave drejt përdorimit me efektivitet, sipas karakteristikave të tyre.

Ky plan reflekton politikat dhe strategjitë kombëtare sektoriale, si:

- ✓ Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, 2015-2020
- ✓ Strategjia Kombëtare Ndërsektoriale për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, 2014-2020
- ✓ Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve, 2014-2020
- ✓ Strategjia e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimet, 2014-2020
- ✓ Strategjia Kombëtare Ndërsektoriale për Administrimin e Mbetjeve, 2010-2025
- ✓ Plani Kombëtar për Administrimin e Mbetjeve, 2010-2025
- ✓ Strategjia Ndërsektoriale e Mjedisit, 2015-2020 (draft)
- ✓ Strategjia e Energjisë, 2013-2020 (draft)
- ✓ Plani i Përgjithshëm Kombëtar për Territorin, (draft)
- ✓ Legjislacioni përkatës mbi ekologjinë, ajrin, mjedisin detar, zonat e mbrojtura, VSM-në dhe VNM-në, administrimin e mbetjeve, trashëgiminë kulturore, zhurmat, ujin, bujqësinë, pyjet, etj.

Gjithashtu, ky plan do të kontribuojë në përgatitjen e një axhende lokale për cilësinë e jetës dhe shëndetit të banorëve të Dibrës në përputhje me strategjitë, kërkesat dhe detyrimet përkatëse kombëtare për çështjet sociale. Ky proces e ndihmon strategjinë që të koordinojë dhe përshtasë zhvillimin me objektivat dhe strategjitë kombëtare e ndërsektoriale që në fazën e planifikimit.

Strategjia e propozuar mbështetet dhe është konsultuar me strategjinë e zhvillimit të rajonit të Dibrës (2012-2017), hartuar nga UNDP-ja dhe planet lokale të zhvillimit (2009-2014) për 15 Njësitë Administrative, të hartuara në kuadër të programit “Forcimi i Qeverisjes Lokale në qarkun e Dibrës”, financuar nga ambasada holandeze. Rishikimi i planeve lokale do të ndihmojë strategjinë të përshtatet me kontekstin lokal, me hartimin e planit të investimeve kapitale, si dhe me bashkërendimin e hapave të zhvillimit me Këshillin e Qarkut dhe me bashkitë e tjera fqinje.

Ky dokument strategjik është konsultuar dhe ka marrë për bazë planin strategjik të zhvillimit të bashkisë Peshkopi për vitin 2012-2017, hartuar nga FLAG-u dhe mbështetur nga VNG-ja (Shoqata e Bashkive të Holandës), si dhe Plani i Veprimt Urban të kësaj bashkie, hartuar në vitin 2014 nga studio “ERALD G shpk” dhe financuar nga fondet e bashkisë. Të dy këto dokumente janë një bazë e mirë për metodologjinë e këtij dokumenti, por ata janë shumë të detajuar për territorin e qytetit të Peshkopisë.

3. Procesi i bashkëpunimit

Grupi i ngritur për hartimin e strategjisë ka bashkëpunuar me të gjithë aktorët dhe grupet e interesit në Dibër gjatë gjithë procesit. Grupi i punës, i përbërë nga stafi teknik i bashkisë së Dibrës dhe mbështetur nga ekspertët e ALCDF-së (Fondacioni Shqiptar i Zhvillimit të Kapaciteteve Lokale) ka ndjekur të gjitha detyrimet ligjore, që lidhen me procesin e diskutimit me publikun, grupet e interesit dhe përfaqësuesit e institucioneve të tjera qeverisëse në Dibër. Të gjitha hapat janë ndjekur rigorozisht sipas kërkesave ligjore, duke filluar që nga hapja e nismës, diskutimi i saj me komunitetin, aprovimi në këshillin bashkiak, krijimi i forumit konsultativ, dëgjuesat publike, etj.

Grupi i punës është përpjekur të zbatojë të gjitha kërkesat dhe detyrimet, në mënyrë që dokumenti të përputhet me kërkesat dhe procedurat ligjore. Strategjia është përgatitur pozitivisht, është e justifikuar, efektive, duke qenë kështu konsistente me politikat kombëtare.

- “Përgatitur pozitivisht” nënkupton marrjen në konsideratë dhe me objektivet të gjitha analizat, vlerësimet dhe kërkesat në territorin e Dibrës, duke qenë konsistent me arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm;
- “I justifikuar” nënkupton faktin që bazohet në të dhëna dhe analiza të besueshme dhe të sakta, nga ku kanë dalë strategji dhe alternativa të arsyeshme;
- “Efektivitet” nënkupton faktin që dokumenti bazohet që ndërhyrjet e parashikuara të jenë sipas prioriteteve strategjike për territorin dhe rajonin;
- “Sipas politikave kombëtare” nënkupton që dokumenti është mbështetur në dokumentet dhe bazën ligjore ekzistuese.

Strategjia është dokument i rëndësishëm dhe do të kontribuojë në procesin e hartimit të Planit të Përgjithshëm Vendor. Dokumenti i strategjisë parashikon zgjidhje që janë në mbështetje të bashkisë (pushtetit vendor), për të mundësuar kështu që bashkia të marrë një rol udhëheqës në zhvillimin e territorit dhe të tokës. Në këtë mënyrë, ajo do të mbrojë zonat natyrore, historike dhe bujqësore, do të garantojë partneritet publik e privat në financimin e infrastrukturave e shërbimeve dhe do të administrojë shpërndarjen e të drejtës së zhvillimit. Kjo, padyshim është e lidhur ngushtë edhe me kompetencat e reja që i janë dhënë pushtetit vendor pas reformës territoriale, e cila e lehtëson mjaft procesin, sepse qartësohen kufijtë territorialë dhe kompetencat mes autoriteteve në planifikim. Ky proces është mishëruar në këtë plan, në mënyrë që situata aktuale të ridimensionohet me standarde të pranueshme, që garantojnë frymëmarrje dhe zhvillim të qëndrueshëm për territorin e Dibrës.

4. Metodologjia

Dokumenti i strategjisë së bashkisë së Dibrës, i hartuar nga ALCDF-ja (Fondacioni Shqiptar për Zhvillimin e Kapaciteteve Lokale) është bërë në kuadër të programit DLDP. Ky produkt është në vazhden e studimeve dhe aktiviteteve që DLDP-ja ka ndërmarrë në bashkitë e Shqipërisë së Veriut, të cilat ishin pjesë edhe e programit të Zhvillimit të Zonave Funksionale, dhe bashkia Dibër do të mbështetet edhe nga qeveria shqiptare për hartimin e PPV-së (Planit të Përgjithshëm Vendor).

Procesi i hartimit të dokumentit strategjik ka kaluar në disa hapa, si: shfrytëzimi i të dhënave dhe prioriteteve strategjike nga dokumenti i Programit të Zonave Funksionale, takimet konsultative me aktorët kyç në nivel qendror me AKPT-në, DLDP-në dhe ato lokalë, krijimi i strukturave në nivel teknik në bashki dhe shfrytëzimi i strukturave të Forumit nga faza e PZF-së, grumbullimi i të dhënave nga institucionet lokale dhe qendrore, konsultimi me dokumentet strategjike kryesore lokale-rajonale-kombëtare, intervistimi dhe ëorkshopet në terren, takimet dhe diskutimet me grupe të fokusuara tematike, prezantimet dhe marrja e opinionëve dhe sugjerimeve nga AKPT-ja, DLDP-ja, ministria dhe aktorët lokalë kryesorë, etj.

Për të hartuar këtë dokument strategjik, ALCDF-ja, si ofruese e shërbimeve ka ndjekur me korrektësi kërkesat e përcaktuara në TOR, ka marrë pjesë aktive në diskutimet metodologjike të organizuara nga ekspertët e DLDP-së dhe AKPT-së, si dhe ka angazhuar një grup ekspertësh në fushat përkatëse të planifikimit urban, zhvillimit ekonomik, shërbimeve publike, GIS dhe në çështjet sociale.

Kontribut të rëndësishëm kanë dhënë anëtarët e grupit teknik të bashkisë Dibër dhe kryetari i saj, z. Shukri Xhelili, si drejtuesit dhe organizatorët e gjithë procesit. Ata kanë vënë në dispozicion eksperiencën, të dhënat dhe aksesin e tyre institucional në nivel lokal dhe qendror.

Kapitulli II: Analiza metabolike (Profili i bashkisë Dibër)

1. Karakteristikat fiziko - gjeografike

Gjendja ekzistuese e territorit të bashkisë Dibër analizohet në këtë kapitull duke u bazuar në dokumentacionin hartografik, të vënë në dispozicion nga AKPT-ja dhe IGJEUM-i. Gjithashtu janë analizuar të gjitha dokumentet e planifikimit, të hartuara më parë, për territorin në të gjitha nivelet, përfshirë këtu zbatueshmërinë e tyre. Analiza është bazuar në tre komponentë:

- njohja me çka ofrojnë planet dhe shkalla e zbatimit të tyre;
- evidentimi i problematikave dhe potencialeve të planeve;
- propozimet për planin e ri

Strategjia e propozuar mbështetet dhe është konsultuar me strategjinë e zhvillimit të rajonit të Dibrës (2012-2017), hartuar nga UNDP-ja dhe planet lokale të zhvillimit (2009-2014) për 15 njësitë administrative, siç u përmend në kapitullin 1. Planet lokale të zhvillimit kanë përfunduar afatet dhe 65% e projekteve të investimeve kapitale janë plotësuar nga ish-NJQV-ja.

Nga informacioni i marrë nëpërmjet këtyre burime është bërë i mundur leximi i territorit mbi, në dhe nën tokë, ashtu siç është paraqitur edhe në vazhdim të këtij kapitulli:

1.1 Pozita gjeografike

Bashkia e Dibrës shtrihet në veri-lindje të Shqipërisë, në koordinatat gjeografike 41° e 53' dhe 20° e 34', në një territor me sipërfaqe 1,001 km². Peshkopia është qendra administrative dhe urbane e bashkisë dhe ndodhet në largësinë 44 km nga Lura, 36 km nga Kalaja e Dodës dhe 18 km nga pika kufitare e Bllatës. Këto zona janë skajet e këtij territori. Territori është rural në më shumë se 91% të sipërfaqes së tij.

Zona e Dibrës ka një akses shumë të vështirë infrastrukturor rrugor, që e lidh me portet, aeroportet dhe qendrat e mëdha industriale dhe tregtare. Rruga nacionale Tiranë-Dibër (182 km), që e lidh Dibrën me metropolin e Tiranës, portin e Durrësit dhe aeroportin “Nënë Tereza” është më e keqja nga të gjitha rrugët në Shqipëri. Rrugët që lidhin Dibrën me pikën e Morinës (pika kufitare me Kosovën), 87 km e gjatë dhe ajo që e lidh me Bllatën (pika kufitare me Maqedoninë) 18 km, janë në gjendje të pranueshme, por vlerësohen si me akses të vështirë, për shkak të terrenit malor dhe gjeometrisë së rrugës.

Bashkia e Dibrës përbëhet nga një qytet (Peshkopia) dhe nga 141 fshatra, të cilat janë pjesë e 14 njësive administrative si: Lura, Zall-Reçi, Zall-Dardha, Selishta, Luzni, Muhurri, Arrasi, Fushë-Çidhna, Sllova, Kalaja e Dodës, Kastrioti, Tomini, Melani dhe Maqellara. Bashkia e Dibrës kufizohet me bashkitë e Kukësit në veri, me fshatrat e Matit dhe Mirditës në jug, me fshatrat e Bulqizës në jug-lindje dhe me kufirin shtetëror të Maqedonisë në veri-lindje.

1.2 Relievi

Dibra shtrihet në krahinën Malore-Qendore të Shqipërisë. Relievi i Dibrës është kryesisht malor. Vargmalet Deshat – Korab (pjesë e parkut natyror Korab-Korritnik) dhe Lurë-Selishtë janë

kufijtë natyrorë të territorit të Dibrës. Ato rrethojnë Luginën e Drinit të Zi, e cila shtrihet në gjithë gjatësinë e këtij territori.




Figura 1: Harta topografike e Dibrës

Mendohet se vargmalet janë formuar nga mbarimi i jurasikut, ndërsa gjatë erës kenozoike u shpejtua procesi malformues në tërësinë e Albanideve, që tani përbëjnë tokën e nëntokën e Shqipërisë. Lartësia mesatare e relievit të Dibrës është më e lartë se ajo e Shqipërisë, 708 metra, ose dy herë më e lartë se mesatarja e Evropës. Në territorin e Dibrës gjendet pika më e lartë në vend, mali i Korabit, 2751 metra mbi nivelin e detit.

Fushat përgjatë lumit të Drinit të Zi dhe rrëzë bazeneve të përrenjve si, në Maqellarë, Erebarë, Dohoshisht, Tomin, Gjellagjosh, Gramë dhe Veleshicë shtrihen në krah të vargmalit Deshat-Korab. Vargmalet Lurë – Selishtë përshkohen

nga përrenj me shtrat më të ngushtë duke krijuar kështu kanione dhe pamje të bukura. Këto fusha dhe pllaja, që ndërpriten nga kodrina dhe rrafshe janë shumë pjellore në drithëra buke, pemë frutore dhe kultura të tjera bujqësore.

Relievi i territorit të Dibrës nuk është kompakt, por i ndarë në disa masivë malorë, që ndërpriten nga lugina të ndryshme përrenjsh. Këta përrenj derdhen në lumin e Drinit të Zi. Diferenca e madhe mes lartësisë së këtyre masivëve (308 m) dhe malit të Korabit, 2751 m ndikon në ndryshimet e mëdha klimaterike, bimësi, si dhe në dendësinë e vendosjes së qendrave të banuara në drejtim vertikal. Në relievin e tyre mbizotërojnë kodrat dhe malet.

Duke u nisur nga lartësia mbi nivelin e detit, dallohen: relievi i mesëm dhe ai i lartë. Relievi i ulët (deri në 200 m) nuk shtrihet në territorin e Dibrës, ndërsa relievi i mesëm shtrihet nga 200 deri në 1000 m mbi nivelin e detit. Ai ka shtrirjen më të madhe dhe përfshin: kodrat, gropat, fushëgropat dhe luginat kryesore. Relievi i lartë shtrihet 1000 m mbi nivelin e detit dhe përfshin malet dhe sistemet malore. Pjesa më e madhe e këtyre maleve ka lartësi deri në 2000 m. Malet me lartësi më të madhe se 2000 m kanë shtrirje të konsiderueshme në territorin e Dibrës.

1.3 Pasuritë nëntokësore

Zona e Dibrës ndërtohet pothuaj nga të gjitha llojet e formacioneve gjeologjike, duke filluar nga ato më të vjetrat, sedimentare dhe metamorfike e deri tek ato magmatike, apo formimet e reja të sotme.

Ndër pasuritë minerale kryesore, përmendim ato të kromit, hekurit, manganit, bakrit, aluminit, polimetaleve, etj. Nga ato jometalore veçojmë gëlqerorët e mermerizuar, argjilat, anhidritet, gjipsët, selenitet, squfurin, pirofilitin, kuarçitet, dunitet, peridotitet, granitet, travertinat, azbestin, bojrat e dheut, etj. Gjithashtu nuk mungojnë edhe mineralizimet radioaktive, që janë të rralla e të çmuara. Rajoni i Dibrës ka premisa për naftë e gaz-mbajtje në rajon.

Shërbimi Gjeologjik në Dibër ka një inventarizim të plotë të studimeve, që janë bërë ndër vite, falë kërkimit të pasurive minerare. Kështu, janë zbuluar vendburime kromi në zonën e Selishtës dhe të Lurës. Zona e Korabit njihet për pasuritë e hekurit oksid, manganit, arsenikut, polimetaleve, etj. dhe hekurit pa nikel, pasuri këto në gjendje të “fjetur”. Pasuritë minerare të bakrit janë zbuluar në zonën e Lurës dhe Gramë-Tomin. Burime me argjilë janë zbuluar në Vakuf, Kastriot, Dardha e Kobenit, Dohoshisht, Pilafe, Kodra e Xhize, Zbinec, etj. Mermerë dhe gëlqerorë të mermerizuar janë zbuluar në Arras, Reç, Bardhaj-Reç, Tharkë, Lan Lurë, Korab dhe më i njohuri është mermeri i kuq në Muhurr (në shfrytëzim). Me interes janë burimet me evaporitet, që nga populli njihen si gjipse, ose avullore. Këto kanë në vetvete disa lloje mineralesh, që me pak shpenzime, apo punime gjeologjike mund të shndërrohen në vendburime të mirëfillta, si ai i Vrënjtit, i Urës së Druve në Radomirë, i Urës së Veleshicës, i Ujit të Ftohtë në Vleshë, i Përroit të Gramës, Shkallës së Sllatinës, Përroit të Bahutes, Gradishtës, Përroit të Llixhave, etj. Për nga përmbajtja mineralogjike këto janë objekte të gjipsit, anhidritit dhe selenit. Pasuri tjetër minerare janë travertinat (guri i shtufës), që gjenden në Vleshë, Sopanikë (Çidhën), Dipjakë, Melan dhe Staravec. Bojrat e dheut janë shumëngjyrëshe dhe mund të gjenden në Bllaçë, Rrenz, Përroin e Miravecit, Përroin e Kaut (Sohodoll), Pilafe, Tomin, Erebarë, Varri i Kaurit (Topuzë), etj. Gjithashtu me interes janë edhe burimet e kuarçiteve në Sorokol, Kulla e Zyberit, Cerenit, Përroit të Kaut, etj, të cilat pothuajse janë të gatshme për shfrytëzim në gjendje të hapur. Pasuri me shumë vlera për ekonominë duhet konsideruar edhe vendburimi i pirofilitit në Sohodoll dhe sqfurit në Kërçisht.

1.4 Klima

Shqipëria ndodhet mes zonës klimaterike bregdetare mesdhetare dhe të brendshme kontinentale. Territori i Dibrës, që shtrihet në pjesën e brendshme të vendit ka klimë mesdhetare kontinentale. Si pjesë e zonës malore, ky territor karakterizohet nga klima kontinentale me rreshje 600 – 1000 mm, por zona e Dibrës karakterizohet nga sasi rreshjesh mbi mesateren e vendit. Ato shkojnë deri në 980 mm, por gjithsesi, më pak se pjesa e Alpeve, ku sasia e rreshjeve shkon deri në 20000 mm. Temperaturat më të larta të vërejtura arrijnë 25°-30°C në korrik, ndërkohë që temperaturat minimale gjatë dimrit arrijnë deri në -20°C. Përgjithësisht mesatarja vjetore e rreshjeve në Shqipëri është 1.300-1.400 mm dhe 80% e rreshjeve bien gjatë periudhës nëntor - mars. Shuma vjetore e temperaturave aktive (mbi 10°C) varion midis 3.500-5.500°C. Orët vjetore me diell variojnë nga 2,100 dhe 2,300. Korriku dhe disa herë gushti janë muajt më të thatë, ndërsa dhjetori dhe janari, muajt më të ftohtë.

1.5 Sizmiciteti

Në vendin tonë janë përcaktuar zonat e burimeve sizmike me një aktivitet sizmik të dallueshëm. Shqipëria është një ndër vendet më sizmioaktive në Evropë. Sizmiciteti i Shqipërisë karakterizohet nga një mikroaktivitet sizmik intensiv ($1.0 < M < 3.0$), nga shumë tërmete të vegjël ($3.0 < M < 5.0$), nga tërmete të rralla me madhësi mesatare ($5.0 < M < 7$) dhe shumë rrallë, nga tërmete të forta ($M > 7.0$). Shumica e tërmeteve të forta ndodhin në 3 breza sizmikë të mirë përcaktuar, si në vijim:

- Brezi tërmetor Joniko-Adriatik, në buzën lindore të mikroplakës së Adrias, me shtrirje veriperëndim-juglindje.
- Brezi tërmetor Peshkopi-Korçë, me shtrirje veri-jug.
- Brezi tërmetor Elbasan-Dibër, me shtrirje verilindore.


Dibra është pjesë e dy sistemeve sizmike me shtrirje veri-jug dhe me shtrirje në verilindje. Ky fakt e rendit Dibrën ndër zonat më të rrezikuara për nga veprimtaria e tërmeteve. Ajo është goditur nga tërmete të fuqishme në shekullin XIX dhe XX.

Të dhëna të hollësishme për tërmetet historike, të regjistruara në zonën ku shtrihet qyteti i Peshkopisë dhe rrethinat e tij, mungojnë. Ndër to përmendim tërmetin e Prizrenit (1456), Pejës (1662), Dibrës (1921, 1935).

Ndër ngjarjet më të forta që janë regjistruar në Dibër gjatë dekadave të fundit përmendim:

- Tërmeti i 27 gushtit, në vitin 1942 me manjitudë $M=6.0$. Kohëzgjatja e tij ka qenë 4 sekonda. Ky tërmet ka shkatërruar Peshkopinë: janë dëmtuar më tepër se 80% e shtëpive, ka shkakuar 44 viktima dhe 119 të plagosur. Nga ky tërmet janë shkatërruar që nga themelet 495 shtëpi dhe 2200 të tjera janë dëmtuar rëndë.
- Tërmeti i 30 nëntorit, në vitin 1967 me manjitudë $M=6,6$ dhe $I_u=IX$ ballë : \MSK-64 me epiqendër në Gollobordë (mali i Zylit). Nga ky tërmet, në rrethin e Dibrës dhe të Librazhdit janë prekur 13 lokalitete me 177 fshatra. Tërmeti shkaktoi 12 viktima dhe u plagosën 174 persona të tjerë. U dëmtuan 6336 godina, nga të cilat, 5664 shtëpi banimi dhe 156 objekte social-kulturore. Viktima në njerëz ka patur edhe në teritorin e ish-Jugosllavisë.
- Tërmeti i 6 shtatorit, në vitin 2009 me epiqendër në fshatin Gjoricë, me manjitudë $M=5.2$ dhe intensitet $I_u= VII$ ballë: \MSK-64. Ky tërmet u shoqërua me dëme materiale në Gjoricë dhe fshatrat përreth. Tërmeti u ndje i fuqishëm edhe në qytetin e Peshkopisë dhe fshatrat përreth.

Figura 2: Harta e makrozonimit sizmik



2. Karakteristikat mjedisore

2.1 Elementet mjedisore

Në këtë kapitull bëhet skanimi dhe evidentimi i problematikave dhe potencialeve mjedisore që mbart zona e Dibrës. Ai paraqet gjendjen aktuale të mjedisit për Dibrën.

2.1.1 Parqet natyrore

Bashkia Dibër ka një peisazh natyror shumë të pasur, si në aspektin e biodiversitetit, gjeodiversitetit dhe atraksioneve panoramike natyrore. Në territorin e Dibrës gjendet Parku Kombëtar i Lurës me 1200 ha, Parku Natyror Korab-Korritnik me 20667 ha, rezervati i mbrojtur natyror Luzni-Bulaç dhe 41 monumente të natyrës që kanë vlera ekologjike, natyrore, me florë dhe faunë të pasur, vlera turistike, atraktive dhe studimore. Me ligj këto zona janë shpallur zona të mbrojtura dhe bëjnë pjesë në inventarin e zonave dhe monumenteve të mbrojtura të Shqipërisë, sipas standardeve të Unionit Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN).

Figura 3: Zonat e mbrojtura dhe monumentet e natyres



Parku Kombëtar i Lurës është një zonë e mbrojtur e kategorisë II, e shpallur në vitin 1969 si park kombëtar dhe ka një sipërfaqe prej 1,280 ha. Shquhet si zonë me vlera shumë të mëdha të biodiversitetit: me pyje pishe, arë, rrobull, ah dhe shkurre; lloje të ndryshme endemike, disa lloje subendemike dhe drurë relikte. Parku ka liqene akullnajore të shumta, me bimësi ujore (zambakët e ujit) e faunë karakteristike, mjaft të veçantë për vendin tonë; livadhe alpine (bjeshkë),


etj. Ka gjithashtu të mëdhenj që mbrohen me rregullore të veçanta, si: ariu, ujku, rrëqebulli, dhia e egër, kaprolli dhe, ndër shpendët veçojmë gjelin e egër dhe shqiponjën.

Parku ka vlera shkencore, estetike, peisazhore, turistike mjaft tërheqëse për vizitorët vendas dhe të huaj. Pasuritë natyrore dhe biologjike, bukuritë e peisazhit janë potenciale të mëdha për zhvillimin e turizmit. Aktualisht gjendja mjedisore është tepër e rëndë, me pyje të prera, faunë dhe florë të rrezikuara. Plani i menaxhimit të tyre nuk ekziston.

Parku natyror Korab-Korritnik me sipërfaqe 20,663 ha klasifikohet në kategorinë IV, sipas Unionit Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN). Ky park konsiderohet peisazh natyror i mbrojtur, i shpallur si i tillë në vitin 2012. Ai mbulon pjesën më të madhe të territorit të Dibrës. Parku është i ndarë në tre nënzona: i) *nënzona qendrore*, që shtrihet në zonën e Dibrës, 1,621 ha dhe përfshin habitatet kryesore pyjore. Përcaktohet si zonë me vlera të larta për trashëgiminë

natyrore e biodiversitetin. Për të zbatohet shkalla e parë e mbrojtjes, që siguron një territor të pashqetësuar. Në këtë nënzonë lejohen kërkimi shkencor, zhvillimi i veprimtarive eko-turistike të lira në natyrë si dhe kullotja sezonale, ii) *Nënzona e përdorimit tradicional*, me sipërfaqe në zonën e Dibrës 17,734.5 ha, që përfshin tërësisht tokat bujqësore, pyjet e kullotat, ku mundësohet vazhdimi i veprimtarive tradicionale, si bujqësi, pyje, kullotje, grumbullimi i bimëve mjekësore e aromatike, me përdorim të balancuar të tyre dhe nuk lejohen ndërtimet e veprimtaritë që shkaktojnë ndryshimin e gjendjes natyrore të ekosistemit. iii) *nënzona e zhvillimit të qëndrueshëm*, me sipërfaqe 1,572 ha, nga të cilat, 1,307.9 ha në zonën e Dibrës, që përfshin territoret urbane dhe trojet e përziera me tokë bujqësore e pyjore pranë qendrave të banuara dhe veprimtaritë përgjatë lumenjve, përfshirë këtu edhe ujërat termale.

Nënzona mundëson vazhdimin e veprimtarive ekonomike, sociale e të agrobiznesit të qëndrueshëm dhe përdorimin e balancuar të peizazhit e të burimeve natyrore, si dhe shtimin e drurëve arrorë, lajthive, gështenjave e të bimëve mjekësore dhe aromatike. Ky park ka plan menaxhimi dhe është në gjendje të kënaqshme. Korridoret natyrore me parkun e malit të Sharrit dhe parkun e Mavrovës, krijojnë premisa për pasurimin e habitateve natyrore (florë dhe faunë) në këtë territor.



2.1.2 Monumentet e natyrës

Territori i zonës së Dibrës dallohet për monumente të shumta natyrore

(41 monumente), qofshin këto gjeo-monumente, hidro-monumente apo bio-monumente. Për vlerat e tyre të veçanta historike, estetike, turistike, biologjike ato përbëjnë një numër të madh objektesh dhe peizazhesh të shpallura si monumente natyre. Këto monumente janë: 1. Shpella e Gurit të Kuq, 2. Karsti i Malit të Bardhë, 3. Burimi dhe Shpella e Sopanikës, 4. Liqenet e Kasnisë, 5. Pasqyrat e Gramës, 6. Gropa e Panairit, 7. Liqeni i Zi (mbi Radomirë), 8. Ujëvara e Pocestës (Maqellarë), 9. Bjeshka e Zonjave, Zimur, 10. Gryka e Setës (pjesa më e ngushtë dhe më e thellë), 11. Shpella e Rusit (Grykë-Nokë), 12. Shpella e Qytezës, 13. Shpella e Akullit – Bulaç, 14. Burimi i Ujit të Ftohtë, Vleshë, 15. Burimi i Kërçinit, 16. Kroi i Mbretit – Serakol, 17. Burimi termomineral i Llixhave të Peshkopisë, 18. Liqeni i Luleve (Lurë), 19. Liqeni i Zi (Lurë), 20. Liqeni i Madh (Lurë), 21. Hartinat e Lurës, 22. Shllinasi, 23. Guri i Kërçinit, 24. Krasta e Pocestit, 25. Boroviku i Begjunecit, 26. Burimet e Bellovës, 27. Gryka e Madhe, Lurë, 28. Rrafshi i Korabit, 29. Morenat e Fushëlurës, 30. Cirku i Kurorës së Lurës, 31. Kodra e

Parave, Blliçe, 32. Fusha e Pelave – Lurë, 33. Rrapi i Kërçishtit, 34. Pisha e Blliçes, 35. Ahu i Blliçes, 36. Lisi i Dobit, 37. Vakufi i çangës, 38. Lisi Kabe, 39. Vakufi i Sinës së Sipërme, 40. Rrobulli i Lurës, 41. Rrapi i Çidhnës.


2.1.3 Peizazhi natyror

Peizazhi dominues në territorin e Dibrës është ai rural, si në aspektin e përdorimit të hapësirave të tokës, në ngastra të vogla dhe me diversitet kultivimi, si në stilin e ndërtimit të fshatrave, tipike e familjeve dhe ekonomive rurale. Peizazhi rural është i ndryshëm. Në të dallohen qartë pjesa e territoreve në zonat malore, ku përdoret guri për ndërtim, rasat për mbulim dhe tokat në ngastra të vogla e të pjerrëta. Dallohen gjithashtu edhe zona fushore me shtëpi të mëdha që kanë oborre të mbjella me pemë frutore, tokat e sistemuara të mbjella me drithëra, foragjere dhe pemë frutore. Kjo gjë konsiderohet një aset shumë tërheqës për vizitorët dhe turistët, që janë të interesuar për turizmin rural. Ky peizazh, shumë pak është shfrytëzuar për turizëm.

2.1.4 Mjedisi ujor

Mjedisi ujor është pasuri për këtë territor. Këtu gjenden disa burime ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore. Burimi ujor më i madh është Lumi i Drinit të Zi, i cili ka vlera estetike, turistike dhe biologjike për territorin. Megjithëse ka këto vlera, ai shfrytëzohet në mënyrë spontane për turizëm në verë dhe shumë pak për sporte ujore. Përdoret edhe për peshkim, por peshkatarët përdorin mjete dëmtuese, si eksploziv, etj.

Figura 5: Harta hidrografike e Dibrës



Për shkak të topografisë malore, përrrenjtë rrjedhin përgjatë kodrave të pjerrëta. Ndryshueshmëria e tyre, vit pas viti është shumë e lartë: rrjedhjet vjetore në vite të thata përbëjnë 1/10 e rrjedhjeve vjetore në vite të lagështa. Shumica e përrrenjve paraqesin modele shumë të çrregullta të rrjedhjes sezonale. Rrjedhjet e lumenjve janë më të larta gjatë dimrit, ose në fillim të pranverës. Pothuajse të gjithë kanë më pak se 10% (dhe nganjëherë, 0 %) të mesatares së tyre të dimrit gjatë stinës së verës. Më shumë burimet ujore përdoren për ujë të pijshëm, në bujqësi

për vaditje, si dhe për hidro-energji (tre HEC-e në Lurë dhe dy në Selishtë). Përrrenjtë janë të vështirë për t'u kontrolluar. Dibra është e prirur ndaj erozionit të tokës. Megjithatë ky konsiderohet një fenomen natyror tipik për zonën, pasi përrrenjtë janë malorë me rreshje të shumta dhe me pjerrësi të madhe. Në rastin e Dibrës ky fenomen është thelluar më shumë nga aktivitetet e dorës së njeriut (p.sh: shpyllëzimi). Si pasojë, vërehen sasi të mëdha sedimentesh në shtratin e lumenjve dhe dalje nga shtrati të tyre. Të rrezikshëm janë përroi i Veleshicës, i Blliçes,

Gjelagjoshit, Dohoshishtit dhe Kusarres. Përdorimi i pasurive ujore për turizëm dhe hidro-energji ka nisur, por mbetet në hapat fillestare.

2.1.5 Biodiversiteti (flora dhe fauna)

Flora dhe fauna janë një pasuri e rrallë e zonës së Dibrës. Dibra njihet për një diversitet të lartë të ekosistemeve. Brenda territorit të saj ka ekosisteme liqenore, lumore, shkurre me gjelbërim të përhershëm dhe gjethegjërë, pyje dushku dhe ahu, pyje me pisha, kullota dhe livadhe alpine e sub-alpine, si dhe ekosisteme të larta malore. Zona e Dibrës, e cila është më shumë ballkanike se mesdhetare, ka afro 1,800 lloje bimësh, nga të cilat 86 lloje janë shpallur ndërkombëtarisht të rëndësishme, 32 lloje janë të përfshira në Listën e Kuqe të Evropës të bimëve të kërcënuara, sipas IUCN-së. Ekziston një listë e ngushtë e llojeve bimore të rralla dhe të rrezikuara, por Shqipëria ende nuk e ka të përgatitur Listën e Kuqe të llojeve të rrezikuara. Disa lloje bimore, që konsiderohen të rralla e të rrezikuara në Shqipëri gjenden edhe në zonën e Dibrës, si: bershei i rëndomtë/*taxus baccata* L., bujgeri/*quercus trojana* uebb, vidhi i rëndomtë/*ulmus campestris* L., panja malore/*acer heldreichii* Orph., boshtra/*forsythia europea* Deg. Et Bald., vulfonia/*ëulfenia carinthiaca* Jack., tulipani i Korabit (bjeshkës)/*tulipa scardica* Bornm, etj.

Fauna është prezente me lloje të veçanta të kafshëve, të cilat ekskluzivisht janë të lidhura për biotope specifike, që do të thotë se përhapja e tyre është e ngushtë dhe u përkasin llojeve endemike. Ndërsa llojet e tjera, që hasen në biotope të ndryshme janë të përhapjes së gjerë. Fauna e Dibrës deri sot nuk është hulumtuar aq sa duhet, mirëpo, në bazë të të dhënave të literaturës mund të konstatohet se fauna e saj përbëhet prej: 7 lloje peshqish, 9 lloje amfibësh, 10 lloje reptilësh, 154 lloje shpendësh dhe 30 lloje gjitarësh. Më karakteristikët janë shqiponja e Korabit, thëllëza gurore dhe gjeli i egër (i veçantë për zonën e Lurës), iriqi, lepuri, ketri, rrëqebulli (tigr i Ballkanit), ariu i murrmë, ujku dhe dhia e egër (simbol për Korabin).

2.2 Analiza e problematikave mjedisore

Në këtë kapitull trajtohet analiza e problematikave mjedisore, burimeve ndotëse dhe të dhënave të ndryshme, bazuar kjo në evidentimet e bëra më sipër. Problematika mjedisore në zonën e Dibrës lidhet më së shumti me menaxhimin e mbetjeve, biodiversitetin (mbrotjen e florës dhe faunës), erozionin, zjarret, etj.

2.2.1. Menaxhimi i mbetjeve

Menaxhimi i mbetjeve në bashkinë Dibër klasifikohet ende në një nivel të ulët. Me sisteme për grumbullimin e mbetjeve është pajisur vetëm qyteti, por jo zonat rurale. Në zonën e Dibrës akses në shërbimin e menaxhimit të mbetjeve kanë vetëm 23.6% e familjeve. Pikat e grumbullimit të mbetjeve në këto zona ku ofrohet shërbimi, janë koshat (gjithsej, 197 të tillë) dhe 8 makina (2 traktorë dhe 6 makina transportuese) për transportin e mbeturinave, të cilët, jo në gjendje të mirë. Në Peshkopi ndodhet një vend depozitimi i mbetjeve me një kapacitet prej 33 tonësh në ditë dhe kapacitet të plotë rreth 1,000 ton. Kjo pikë depozitimi është jashtë çdo standardi teknik të një

fushe depozitimi. Në zonat rurale si vend depozitim shërbejnë shtratet e lumenjve, duke u kthyer kështu në rrezik për shëndetin e njerëzve dhe peizazhin. Problemet kryesore që lidhen me këtë shërbim janë:

- Sistemet për grumbullimin dhe heqjen e mbetjeve janë të pamjaftueshme dhe joefektive;
- Vendimet për mbledhjen dhe heqjen e tyre nuk mund të ekzekutohen, në mungesë të një informacioni të besueshëm;
- Nuk ka një traditë të mirëfilltë për trajtimin dhe heqjen e mbetjeve;
- Burimet financiare dhe teknike janë të pamjaftueshme;
- Publiku ka mungesë informacioni për sa i përket rrezikut që shkaktohet nga administrimi i dobët i mbetjeve;
- Mungon plani i menaxhimit të mbetjeve;

2.2.2 Pasojat në florë dhe faunë

Sipas përditësimeve, të bëra në nëntor 2013 nga Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN), 109 lloje kafshësh të grupeve të ndryshme taksonomike janë konsideruar si të kërcënuara. Përveç kësaj, lista e llojeve të rrezikuara të bimëve në nivel kombëtar është shumë më e madhe. Gjithsej janë 319 lloje, nga të cilat, 76 lloje të rrezikuara në një masë kritike, 123 lloje konsiderohen në rrezik dhe 120 lloje, të përkeqësuar. Këto lloje bimësh përballen me një rrezik të lartë në një kontekst më të gjerë kombëtar. Ky rrezik është i pranishëm edhe në zonën e Dibrës.

Zonat më të kërcënuara janë zona e Parkut të Lurës, ku ka prerje masive të pyjeve, gjë që ka ndikuar dhe në habitatin përreth, zona e Pratit në Selishtë dhe disa lloje bimësh mjekësore, që rrezikohen nga vjelja pa kriter, si agulicja dhe 32 lloje të tjera bimësh. Më e rrezikuar është situata për disa lloje kafshësh, shpendësh dhe gjallesash të tjera, që rrezikojnë zhdukjen, si pasojë e degradimit të mjedisit natyror (pyjeve të prera, ose të djegura), por dhe ndërhyrjes pa kriter nga dora e njeriut. Të rrezikuara janë gjeli i egër, dhia e egër, thellëza, etj.

Kërcënimet kryesore ndaj biodiversitetit janë: gjuetia ilegale pa kriter, peshkimi me lëndë plasëse dhe helmuese, erozioni i tokës, energjia dhe minierat, transporti dhe turizmi, zhvillimi industrial, urbanizimi, sektorë këto që kanë ndikim në shumëllojshmërinë biologjike.

Aktivitetet antropogjene, ku përmenden shpyllëzimi dhe lënia djerrë e tokës së punueshme, shkatërrimi i livadheve dhe kullotave kanë pasur një ndikim të madh në ndryshimet e habitateve në të kaluarën e afërt.

Ndërtimi i rrugëve dhe ndryshimet në rrjedhën e ujit, ndotja që vjen nga origjina të ndryshme, zjarret, sëmundjet dhe ndryshimet klimatike janë arsyt e degradimit dhe fragmentimit të habitateve në Dibër.

Mbrojtja e biodiversitetit mund të arrihet vetëm duke pranuar dhe respektuar objektivat dhe parimet e ruajtjes dhe rritjes së zhvillimit të qëndrueshëm në sektorët që lidhen me biodiversitetin. Këta sektorë janë: bujqësia, pylltaria, peshkimi, industria, urbanizimi, transporti dhe turizmi.

2.2.3 Zjarret

Zjarret në pyje kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme, duke u shoqëruar me pasoja të mëdha e negative për ekosistemet, si: humbja e biodiversitetit, shkretëtirëzimet, gërryerja e tokës, prishja e rregjimit ujor, por mbi të gjitha, humbja e funksioneve biologjike, të cilat pasohen me humbje të mëdha socialekonomike.

Sipërfaqet e djegura gjatë periudhës 1990-2014 janë të madhësive të ndryshme. Niveli më i lartë u arrit në vitin 2007, me 600 ha pyje. Kjo dukuri negative ka qenë e shtrirë në të gjithë territorin e Parkut të Lurës dhe pjesës së Selishtës. Përveç pyjeve prodhuese, zjarret kanë djegur edhe zona të mbrojtura, në sipërfaqe të konsiderueshme, duke u humburatyre vlerat dhe rëndësinë që kanë patur. Përsa u përket shkaqeve, në shumicën e rasteve ato nuk kanë qenë natyrore. Temperaturat e larta vetëm kanë favorizuar përhapjen e zjarreve.

Zjarret, në mënyrë të veçantë ato të 10-vjeçarit të fundit, në shumicën e rasteve kanë shërbyer si faza përmbyllëse e prerjeve të paligjshme. Ato kanë shërbyer për “zhdukjen e këtyre gjurmëve”, në sipërfaqet e shfrytëzuara me dhe pa kontrata, sepse pikërisht këto sipërfaqe janë djegur prej tyre. Kjo mbetet arsyeja kryesore për pjesën më të madhe të rasteve, duke konfirmuar shkakun kryesor të tyre, faktorin njeri.

Pasojat janë katastrofike, jo vetëm se është eliminuar tërësisht mundësia e ripërtëritjes, për shkak të djegies së drurëve farorë, por sepse është djegur edhe gjenerata e re, e instaluar së fundmi, duke pakësuar në këtë mënyrë sipërfaqen pyjore. Aktualisht këto sipërfaqe nuk janë pyje, por djerrë, ose me bimësi pyjore dhe praktikisht të pamundura për t'u ripyllëzuar.

2.2.4 Erozioni i tokës

Erozioni vepron në kundërshti me ekuilibrin natyror të ekosistemeve. Nevojitet një kohë shumë e gjatë për të kompensuar humbjen e lëndës, të shkaktuar nga erozioni për një kohë fare të shkurtër.

Erozioni mbetet një rrezik serioz për tokën në Dibër.

Ndryshimet klimaterike shpesh shfaqen me çrregullime në sasinë dhe intensitetin e reshjeve duke kontribuar në shkallën e erodimit të tokës. Parandalimi dhe kufizimi i erozionit është i lidhur direkt me përmirësimin e kushteve të mjedisit dhe në një kohë afatgjate ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e jetës.

Faktorët që përcaktojnë erozionin në zonën e Dibrës renditen si më poshtë:

- **Relievi/pjerrësia:** konfigurimi i terrenit dhe pjerrësia janë një faktor bazë në përcaktimin e rrezikut potencial të erozionit. Shumica e përrrenjve në Dibër janë të rrëmbyeshëm dhe terreni është i pjerrët. Kështu, kemi rrezik dhe ngjarje erozioni në Gjelagjosh

(zhavorizimi i fushës së Kubenit), te Përroi i Gramës, Përroi i Veleshicës, Përroi i Dohoshishtit, Përroi i Kusares, Përroi i Arrë-Mollës, etj.

- Faktorët klimatikë: reshjet dhe temperaturat, që të konvertuara në indeksin Fourier dhe indeksin Bagnouls - Gaussen përcaktojnë potencialin e klimës për të stimuluar erozionin e tokës në një rajon të caktuar.
- Faktorët tokësorë: tekstura, thellësia e tokës dhe përmbajtja e gurëve, që përcaktojnë erodibilitetin e tokës, ose aftësinë e saj për t'u shkëputur, transportuar dhe depozituar gjatë procesit të erozionit.
- Vegjetacioni: vlerësimi i shkallës së mbulesës bimore si faktor frenues për erozionin, që njëkohësisht bën lidhjen mes rrezikut potencial dhe erozionit. Zhveshja nga bimësia e shpateve të maleve, nga ku dhe e kanë burimin ujërat, e favorizon erozionin.
- Faktori njerëzor: duhet përmendur që ky faktor mund të ndikojë potencialisht në të dy drejtimet, për mirë dhe për keq. Fatkeqësisht ndërhyrjet njerëzore përgjithësisht kanë rënduar situatën e erozionit në vend.

Vlerat e këtyre faktorëve në kushtet e territorit të Dibrës favorizojnë potencialisht nivelin e lartë të erozionit të tokës.

Të dhënat teorike tregojnë se në rreth 45% të tokave bujqësore rreziku potencial është mesatar, ndërsa në rreth 55% të tokave rreziku është i lartë.

Relievi i thyer, reshjet, dëmtimi i vegjetacionit natyror, braktisja e tokave bujqësore, etj., ngelen faktorë që nxisin proceset e shkarjeve dhe shembjeve të tokës. Faktorët më kryesorë që ndikojnë në shkarjet e tokës janë:

- mosmenaxhimi i ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore;
- mbikullotja në zonat me bimësi livadhore ;
- reshjet me sasi relativisht të larta;
- ndërtimi hidrogeologjik i shtresave të tokës;
- sipërfaqet e tokave të rrëshqitura në vitin 2014 rezultojnë të kenë të njëjtën tendencë krahasuar me vitet më parë.

Për shkak të reshjeve dhe mungesës së menaxhimit të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore rreziku i shkarjeve të tokës mbetet i lartë.

Një tjetër lloj erozioni është gërryerja e tokës në brigjet e lumenjve dhe përrenjve. Gjatë viteve të fundit dëmtimet në brigjet e lumenjve kanë ardhur si rezultat i shfrytëzimit të materialeve inerte në shtretërit e lumenjve, i dëmtimit të objekteve mbrojtëse dhe dëmtimit të vegjetacionit përgjatë shtratit të tyre.

2.2.5 Dëmtimet në pyjet e larta

Problemi më i madh mjedisor në Dibër është prerja e pyjeve të larta, sidomos ato të Parkut Kombëtar të Lurës dhe maleve të Selishtës, në Prat, Kacni, Lukan, etj. Masivë të tërë me pyje të larta janë masakruar nga prerjet pa kriter, pa studim, pa cilësi dhe në sasi të mëdha. Prerjet janë kryer më tepër për lëndë drusore ndërtimi, industri dhe lëndë djegëse. Mendohet se janë më shumë se 1,500 ha pyje të larta të dëmtuara në territorin e Dibrës, duke na lënë kështu një masakër mjedisore dhe pyjore, e cila kërkon vite dhe masa të shumta shtrënguese për rigjenerimin dhe kthimin në situatën e mëparshme.

3. Karakteristikat e zhvillimit rajonal

Në këtë kapitull bëhet analiza dhe vlerësimi i pozicionimit strategjik të njësisë së qeverisjes vendore në raport me rajonin ku ajo shtrihet, përfshirë këtu identitetin historik, urban dhe ekonomik të territorit, sipas karakteristikave të paraqitura më poshtë.

3.1 Pozicioni strategjik rajonal

Dibra, sipas Planit të Përgjithshëm Kombëtar (PPK) renditet në rajonet ekonomike të specializuara. Ajo është pjesë e rajonit “Dibër-Mat-Bulqizë” dhe përbën një rajon me tipare komplekse, si në fushën e turizmit malor, natyror dhe atij balnear. Por vlerat e specializimit të këtij rajoni qëndrojnë në nxjerrjen dhe përpunimin e mineraleve, zhvillimin e industrisë dhe teknologjisë përpunuese të mineraleve.

Dibra, në objektivat strategjike kombëtare shihet si arterie e “Korridorit 8”. Ajo do të bëhet pjesë e këtij korridori nëpërmjet ndërtimit të “Rrugës së Arbrit”, duke u lidhur kështu me Shkupin, Sofjen dhe Stambollin. Gjithashtu, ky korridor shihet si mundësi e mirë për shkëmbimin e energjisë, korridoreve natyrore, etj.

Në kontekstin e bashkëpunimit ndërkufitar, Dibra ka mundësi të bashkëpunojë me rajonet e Maqedonisë (sidomos me Dibrën e Madhe, Rostushe-Mavrovën, Gostivarin dhe Tetovën), si dhe me rajonet e Kosovës. Këto ndërveprime mund të lidhen me aksesimin e fondeve IPA (cross-border), por mund të jenë edhe pjesë e shkëmbimeve ekonomike, kulturore, njerëzore, mjedisore, etj. Kjo, falë aktiviteteve dhe politikave të qeverisjes lokale dhe bashkëpunimeve të tjera private e të shoqërisë civile.

Territori i Dibrës është pjesë e planeve të zhvillimit sektorial dhe projekteve të mëdha kombëtare për turizmin me (via Scanderbeg) dhe për sistemin energjitik do të jetë pjesë e rrjetit ndërkombëtar të transmetimit të tensionit të lartë me Kosovën, ku planifikohet të ndërtohet nën/stacioni i Skavicës për hidrocentralet e vegjël që nga Lura, Lapaj etj.

Bashkia e Dibrës shtrihet në territorin e qarkut të Dibrës. Ajo është një nga katër bashkitë e rajonit ekzistues, bashkë me Matin, Bulqizën dhe Klosin. Peshkopia është qendra administrative e Qarkut të Dibrës, ku janë vendosur të gjitha institucionet e dekoncentruara, të cilat përfaqësojnë ministritë e linjës në rajon. Kjo gjë i ofron Dibrës mundësi të mëdha në të qenit promotore e bashkëpunimit ndërvendor me njësitë e tjera fqinje.

3.2 Identiteti historik

Në aspektin tradicional Dibra është shumë e larmishme, e pasur, e pazbuluar dhe eksploruar ende. Në histori, Dibra përfaqësonte një krahinë të madhe, që shtrihej nga “Gur e më zhur”, nga

Lura dhe Kalaja e Dodës, vazhdonte në Mavrovë me krahinën e Rekës, në qytetin e Dibrës së Madhe, në Bulqizë, në krahinën e Gollobordës dhe deri në rrethinat e Ohrit dhe Strugës.

Historia e Dibrës është monumentale, me ngjarje, vepra, dhe figura historike. Simboli më i lartë historik i Dibrës lidhet me vendlindjen e heroit kombëtar, Gjergj Kastriot-Dibrani, ose “Skënderbeu”. Bëhet fjalë për fshatin Sinë në Cidhën, ku 300 kalorësit dibranë e shoqëruan Skënderbeun në luftrat e tij me turqit. Njëzetë e katër (24) betejat e tij u zhvilluan në territorin e Dibrës. Toponimet, gojëdhënat dhe ngjarjet lidhen me “Kastriotët” dhe Skënderbeun në çdo cep të Dibrës.

Emri i Dibrës mendohet se vjen nga fisi ilir i Deborëve, i cili jetonte në këtë territor. Me evoluimin e tij deri në ditët e sotme ky emër ka ndryshuar nga “Deborë” në “Dibër”, varianti shkencor. Ekziston edhe një version tjetër më folklorik, që lidhet me ndarjen gjeografike të territorit nga lumi Drin në dy brigjet e tij, që në dialekt dibran është Di(y)-Bri. Ky dualizëm është shumë i përdorur në toponominë dibrane si për shembull: Dibra e Epërme dhe e Poshtme, Sina e Epërme dhe e Poshtme, Bresti i Epërm dhe i Poshtëm, Lishani i Epërm dhe i Poshtëm. Gjithashtu kjo ide lidhet dhe me simbolin e Kastriotëve (përkrenarja me dy brirë), që ishin zotëruesit e krahinës së Dibrës.


Lumi Drin i Zi ka qenë kufiri gjeografik i ndarjes së Perandorisë së Romës me Bizantin. Edhe në ditët e sotme lumi Drin është kufiri gjeografik i ndarjes së Dibrës në pjesën e Malësisë (që përfaqësohet nga nëntë malet) dhe Top-Alltia. Ky lumë përkon edhe me kufirin ndarës të katolicizmit, ose “Latinët”, që në gjuhën dialektore dibrane njihen “llatink”. Siç vërehet, ky emër përkon me territorin e malësisë dhe ortodoksisë në pjesën e Top-Alltisë. Në historitë e Skënderbeut thuhet: “Luftëtarët ishin dibranë latinë dhe administrimi bëhej nga dibranët ortodoksë, prandaj Ai ishte i pamposhtur”.

Në territorin e Dibrës gjenden shumë rrënoja arkeologjike, shumë pak prej të cilave janë të zbuluara dhe të eksploruara. Këto rrënoja lidhen me qytetërimin ilir, bizantin, kristian dhe mesjetar. Më të famshmet ndër to janë: Kalaja e Grezhdanit, Kalaja e Skënderbeut, Kalaja e Çetushit, kishat e Peshkopisë në Kodër-Shtjefën, qyteza e Bellovës, Shtëpia e Selman Agollit në Dohoshisht, Kulla e Zunës në Sohodoll, etj.

Feja ka luajtur një rol të rëndësishëm në historinë e Dibrës, ku kleri dhe shërbyesit e feve katolike, ortodokse dhe myslimane (që përbën 97% të popullsisë) kanë luajtur një rol të rëndësishëm në edukimin, kulturën dhe mbajtjen gjallë të patriotizmi. Përmendim shtatë teqet e Dibrës dhe më të famshmen, teqenë e “Bilbilit” në Vleshë. Klerikët e nderuar, përveç misionit fetar kanë luajtur rol të rëndësishëm edhe në ngjarjet dhe veprimtaritë politiko-shoqërore. Emra të shquar janë Dom Nikollë Kaçorri (nënkryetar i qeverisë së Ismail Qemalit), Haxhi Vebi Dibra (kryetar i kuvendit të parë të Qeverisë 1912), Sheh Shezemani i Vleshës (pjesëtar i Lidhjes së Prizrenit dhe Kongresit të Lushnjës), si dhe rilindasit Josif Bageri, Seit Najdeni dhe Hoxhë Voka, vendimtar në përhapjen e arsimit.

Dibra trashëgon një kulturë dhe traditë të pasur, që nga koha e paganëve e deri në ditët tona. Festat, doket dhe zakonet janë ruajtur dhe pasuruar brez pas brezi. Nuk janë çenuar karakteristikat dhe vlerat autentike, si: festat, ritet, kostumet, vallet, këngët, arkitektura, etj. Kështu, akoma ruhen dhe vazhdojnë të festohen: dita e Verës, dita e Shën Gjergjit, dita e Shën Nikollit, ritet e dasmës, me vallet e grave dhe burrave, kostumet popullore, lojrat popullore, ku më e spikatura është kalaja dibrançe.

Mençuria, mikpritja, mjeshtria, këto vlera të dibranëve përbëjnë një art më vete. Oda e Dibrës, me oxhakun me gurë të gdhendur nga mjeshtrat dibranë, me “kryet e vendit”, që simbolizon kuvendin dhe ku spikat mençuria, dija, rregulli protokollar dhe alegoria, ku çdo gjë është e rregulluar sipas kanunit të Dibrës, i bazuar në kanunin e Skënderbeut, është një thesar i pasurisë dibrane dhe asaj kombëtare.



Hartat e Zhvillimit Rajonal për Bashkinë Dibër

Bazat e legjislacionit për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore janë: Ligj nr. 9048 për Trashëgiminë Kulturore dhe Ligji nr. 9386 për Muzetë, si dhe institucionet përkatëse, Qendra e Kulturës, “Haki Stërmilli”, Instituti i Monumenteve, Muzeu, etj. Duhet përmendur se, megjithëse ekziston ky kuadër ligjor dhe institucional, Dibra ka ende shumë probleme në mirëmbajtjen dhe menaxhimin e trashëgimisë kulturore, për shkak të financimeve të kufizuara si dhe ndërgjegjësimit, ende të ulët, të vetë banorëve.

4. Karakteristikat ekonomike

Analiza dhe vlerësimi ekonomik përfshin mundësitë lokale dhe pengesat për zhvillimin ekonomik, konkurrenshëmërinë ekonomike apo rajonale, pozicionimin dhe përqendrimin e poleve ekonomike lokale, cilësinë e kapitalit dhe të burimeve njerëzore, pikat e forta apo të dobëta për zhvillimin e ardhshëm të territorit.

4.1 Informacion i përgjithshëm

Dibra është zonë agrare, me potenciale turistike balnerare dhe rurale. Për nga kushtet e zhvillimit ekonomik, zona e Dibrës është e pozicionuar në zonat e fundit (58%) në krahasim me GDP-në mesatare kombëtare (indeksuar në 100). GDP-ja për zonën e Dibrës është 177.111 lekë për frymë, kurse në nivel nacional ajo është 305.229ALL. Sektorët që kontribuojnë më shumë janë bujqësia, pylltaria, turizmi, ndërtimi, minierat dhe hidroenergja.

Dibra është një zonë ku dalllohen qartazi ekonomia e zonës rurale dhe ekonomia e zonës urbane. Ekonomia e zonës urbane bazohet kryesisht në sektorin e shërbimeve, tregtisë, hoteleri-turizmit, përpunimit dhe ndërtimtarisë. Ndërsa zona rurale ka karakter të qartë bujqësor. Ajo bazohet në ekonominë familjare të fermave të vogla bujqësore dhe blegtorale, me një tendencë në rritje. Gjithashtu bazohet edhe në disa shërbime bazë dhe biznese tregtare (më e përqendruar dhe e dalluar kjo gjë në zonën e Maqellarës). Këto vitet e fundit ka një fillim të investimeve në përpunimin e produkteve bujqësore, kryesisht të qumështit (rreth 19 baxho), të frutave (punishte për lëngje frutash, pijesh alkoolike, kompostosh/reçelnash, të jufkave, etj). Shumica e këtyre bizneseve, në sektorin bujqësor janë me bazë familjare.

4.2 Investimet

Tregues negativ për zhvillimin ekonomik në zonën e Dibrës është mungesa e investimeve të mëdha dhe atyre të huaja. Edhe pse, ka një rritje të interesit të këtyre investimeve në sektorin e pasurive natyrore, kryesisht të gipseve (interes nga Knauf), hidroenergjisë, ku kanë vazhduar investimet në shtatë HEC-e të vegjël, në kërkimet dhe nxjerrjet e kromit në zonën e Selishtës dhe të Lurës (katër licenca). Investime në industrinë e lehtë (fasoneri), që mund të kenë impakt në shtimin e numrit të të punësuarve nuk ka në këtë zonë. Kjo, për shkak të infrastrukturës së keqe rrugore dhe largësisë nga portet dhe metropoli.

Investimet e vogla e të mesme janë më të pranueshme e me më shumë potencial për banorët dhe investitorët lokalë. Tendenca e investimeve të vogla vihet re kryesisht në sektorin e ndërtimit: shtëpi banimi, dyqane dhe shërbime të tjera. Kjo ka bërë që të rritet presioni i ndërtimit në zonën urbane, ku dhe këto investime janë përqendruar më shumë duke krijuar një situatë problematike në menaxhimin urban të hapësirës së terrorit të qytetit. Ka një tendencë për të investuar edhe në sektorin e agropërpunimit, kryesisht në linja të vogla dhe të mesme, si në përpunimin e frutave, të qumështit dhe magazinave frigoriferike (19 baxho, 16 magazina frigoriferike, 3 linja përpunimi).

4.3 Fuqia punëtore (format e punësimit)

Zona e Dibrës ka një popullsi të aftë për punë në një tregues moshe të barabartë me 66% të popullsisë së përgjithshme në zonë. Për periudhën 2002-2014 treguesi i popullsisë së aftë për punë ka qenë mjaft i qëndrueshëm (norma e rritjes, 46%). Përqindja e popullsisë së aftë për punë në zonat urbane është 45% dhe në ato rurale, 52.5%.

4.3.1 Struktura e punësimit

Struktura e punësimit mbështetet në sektorin e bujqësisë, në sektorin privat dhe në sektorin publik. Bujqësia dhe sektori privat janë sektorët kryesorë që kanë mbajtur peshën e punësimit në vitet e fundit, duke vazhduar të dominojnë ende. Të dhënat tregojnë se numrin më të lartë të të punësuarve e kemi në sektorin bujqësor (58.6%) dhe sektorin privat jobujqësor (24%), ndërsa punësimi në sektorin shtetëror është 17.4% në periudhën 2014. Struktura gjinore e krahut të punës, e matur kjo në vitin 2014 përbëhet nga 13% femra dhe 87% meshkuj. Dëshmi kjo e një çekuilibri gjinor në punësim.




Figura 6: Struktura e punësimit (të dhënat nga INSTAT)

4.3.2 Sektori privat jobujqësor

Sektori privat jobujqësor zë një peshë të konsiderueshme në punësimin e popullsisë në Dibër. Bizneset janë më shumë të karakterit të vogël dhe të mesëm. Në ndryshim nga rajoni, në Dibër nuk kemi biznese dhe ndërmarrje të mëdha, pasi industria nxjerrëse dhe përpunuese e mineraleve nuk është dominuese për Dibrën, siç është për Bulqizën dhe Matin. Biznesi kryesisht është i përqendruar në zonën urbane të Peshkopisë dhe kryesisht në sektorin e shërbimeve, tregtisë, hotelerisë, transportit, etj. Numri i bizneseve aktive në zonën funksionale të Dibrës për vitin 2014 është 1,381. Këto biznese janë përqendruar kryesisht në qytetin e Peshkopisë (1,018). Në zonat rurale numri më i lartë i tyre vërehet në zonën e Maqellarës, 180 biznese dhe më pak në zonat e Zall-Dardhës, Reçit dhe të Luznisë, 3 biznese. Këto biznese janë me karakter familjar

dhe kryesisht kanë nga 1 deri në 3 persona të punësuar. Tregtia, transporti, baret dhe hotelet zënë numrin më të madh të aktiviteteve. Figura më poshtë jep numrin e bizneseve jobujqësore.




Figura 7: Të dhëna nga Zyra e Tatim-taksave

4.3.3 Papunësia

Sipas statistikave zyrtare mendohet se papunësia në zonën e Dibrës është 16%. Por në fakt kjo përqindje është shumë më e lartë dhe përlllogaritet tek afërsisht 32%. Sipas censusit të fundit mendohet se 17,963 persona janë të punësuar dhe kjo shifër përbën 35% të fuqisë së aftë për punë. Pjesa tjetër mendohet të jetë e vetëpunësuar në sektorin bujqësor (58.6%).

4.3.4 Emigrimi

Emigrimi ka qenë dhe mbetet baza kryesore e të ardhurave në familjet dibrane. Dërgesat e emigrantëve janë të rëndësishme për standardet e jetesës në Dibër, sidomos për familjet në zonat rurale. Zonat rurale thithin pothuajse 64% të volumit vjetor të dërgesave. Në zonat rurale dërgesat zënë një pjesë të madhe të të ardhurave mujore, deri në 40% në vitet e kaluara. Megjithatë, tashmë vlera e dërgesave ka rënë me pothuajse 1/3 në të gjithë zonën. Dërgesat përdoren për të mbështetur nevojat e familjeve dhe kryesisht konsiderohen si një rritje e të ardhurave familjare. Rreth 20% e dërgesave përdoren për qëllime investimi dhe kursimi. Familjet në zonat rurale duken të jenë më të interesuara në investime krahasuar me zonat urbane, bujqësia dhe blerjet e pasurive të paluajtshme janë sektorët më të parapëlqyer për të investuar.

4.3.5 Formimi profesional


Dibranët kanë një traditë të mirë dhe karakterizohen si punëtorë, me zotësi profesionale të lartë, si në administrim, ndërtimtari, bujqësi, etj. Një shprehje e vjetër popullore thotë: “Nëse digjet Stambolli, dibranët e ndërtojnë, por nëse digjet Dibra, Stambolli nuk e ndërton dot”. Para viteve 1990 kanë funksionuar disa shkolla profesionale, si Shkolla Bujqësore, Shkolla Artistike, Shkolla e ndërtimit dhe disa qendra të formimit profesional. Aktualisht është në aktivitet një shkollë e mesme profesionale, që i aftëson nxënësit në disa degë kryesore si: mekanikë, elektrik, tekstile,

pedagogjike, ekonomike, etj. Por kjo shkollë nuk përmbush kërkesat e tregut të punës. 14% e nxënësve që mbarojnë shkollën 9-vjeçare ndjekin Shkollën e Mesme Profesionale, më shumë se 17% e nxënësve nuk vazhdojnë asnjë shkollë të mesme. Kërkesat për degë të tjera, që t'i përgjigjen tregut të punës janë të shumta. Ndër më emergjentet janë ato degë që lidhen me bujqësinë, turizmin malor, ndërtimin, etj. Gjithashtu, kërkesa të shumta ka edhe për qendra të formit profesional, me kurse të shkurta dhe të gjata, me qëllim aftësimin në profesione të lira.

4.4 Ndërveprimi ekonomik

Ndërveprimi më i madh ekonomik vërehet në aspektin e punësimit, në tendencën e shkëmbimit të atyre që blejnë dhe atyre që konsumojnë. Ndërveprimi më i madh ndodh në qytetin e Peshkopisë, më pak në Maqellarë dhe me Dibrën e Madhe të Maqedonisë

Figura 8: Harta e lëvizjes drejt tregut



Peshkopia është qendra më e madhe e ndërveprimit në aspektin e punësimit, si në sektorin publik (qendër administrative), në sektorin e bizneseve dhe shërbimeve, dhe si qendër e tregjeve ditore e javore. Në Peshkopi numërohen 1,240 të punësuar në sektorin publik dhe 3,150 biznese. Ndërsa zona tjetër, që ka një aktivitet më të lartë ekonomik është Maqellara. Këtu ndërveprimi është më i lartë mes banorëve të vetë kësaj komune. Një ndërveprim frytdhënës në zonën e Dibrës është

ndërveprimi ndërkufitar me Dibrën e Madhe. Raporti është 1/6 për shkak të numrit të popullsisë dhe sasisë së produkteve. Banorët bëjnë shkëmbim tregtar dhe njerëzor. Banorët e Dibrës blejnë në Maqedoni, pasi çmimet janë më të lira, si ato të ushqimeve, karburanteve, dhe shumë produkteve të tjera. Ndërsa nga Dibra e Madhe këta banorë blejnë më shumë fruta bregdetare, porcelanozë dhe marrin disa shërbime.

4.5 Sektorët ekonomikë kryesorë

Sektorët kryesorë të ekonomisë në Dibër janë bujqësia dhe turizmi. Bujqësia është sektori kryesor në zonën e Dibrës. Kjo për faktin se lidhet me traditën, përqendrimin e popullsisë (75% e popullsisë jeton në zona rurale) dhe punësimit (58.6% e të punësuarve). Turizmi është sektori i dytë prioritar në Dibër dhe njihet për vlerat curative. Aktualisht, turizmi plotëson nevojat për pushim të rreth 12,000 vizitorëve në vit. Kjo, falë shumë investimeve në hoteleri dhe shtëpi pritëse. Ekziston një mundësi tjetër, ajo e shfrytëzimit të turizmit rural dhe malor, pasi zona ofron shumë potenciale të pashfrytëzuara ende.


4.5.1 Bujqësia dhe blegtoria

Bujqësia është sektori më i rëndësishëm që karakterizon zonën e Dibrës. Blegtoria është sektor jetik për zhvillimin e zonës rurale dhe ekonomisë në përgjithësi. Ajo nuk ndahet nga zhvillimi i bujqësisë dhe është pjesë integrale e zhvillimit të këtij sektori.

4.5.1.1 Përdorimi i tokës bujqësore

Sipërfaqja më e madhe e tokës mbillet me drithërat e bukës, pemëtari, foragjere, perime dhe patate. Figura e mëposhtme jep strukturën e mbjelljes së tokës me kulturat bujqësore.

Figura 9: Tabela e përdorimit të tokës



Sipërfaqja më e madhe e tokës mbillet me foragjere dhe drithëra buke. Kjo, për nevojat e blegtorisë dhe nevojat vetjake familjare, por edhe për shkak të kulturës së deritanishme. Ka një tendencë për shtimin e sipërfaqes së mbjellë me pemë frutore, sidomos me mollë, qershi, kumbull dhe arvore, pa cënuar prodhimtarinë e foragjereve, që kanë destinacion blegtorinë.

4.5.1.2 Prodhimi blegtoral

Prodhimi nuk është në rendimente të larta për shumë arsye. Racat nuk janë të shquara për prodhimtari të lartë, tregu i produkteve blegtorale është i vogël dhe mbarështimi i tufave bëhet në forma primitive. Mbarështohen gjedhët, dhitë, delet dhe ka një tendencë për pula dhe bletë, si ekonomi alternative mbështetëse të familjeve rurale. Tabela e mëposhtme jep numrin e krerëve në blegtori.




Figura 10: Numri i krerëve në blegtori (Të dhëna nga Drejtoria e Bujqësisë)

Karakteristikë e dallueshme është që zona fushore mbarështon më shumë gjedhin dhe zona malore, delet dhe dhitë. Kjo për arsye të kushteve mjedisore, sepse kullotat janë më të shumta në zonën malore dhe mbarështimi stallor është më i përshtatshëm në zonën fushore. Sipërfaqja e tokës lejon që ky numër të jetë disa herë më i madh, duke shkuar deri në dyfishimin e numrit të krerëve.

Përpunimi i qumështit është një tendencë e investimeve në zonën e Dibrës. Janë rreth 19 punishte të vogla (baxho) që prodhojnë djathë dhe nënprodukte të tjera të qumështit. Kjo ka nxitur fermerët që të shtojnë dhe sasinë e qumështit për treg dhe shtimin e krerëve.

Tregu i prodhimeve blegtorale të përpunuara është i mirë dhe ka kërkesa. Kjo gjë vihet re edhe në tregun e mishit. Prodhimet e Dibrës kanë cilësi të konkurueshme me prodhimet e tjera, duke u bërë kështu shumë të kërkuara në tregun vendas, krahasimisht me konkurrentët.

Në Dibër kanë filluar të ngrihen edhe ekonomi alternative: me bletë, shpendë dhe rezervate peshku. Kjo, si nxitje e investimeve të vetë fermerëve për të shfrytëzuar pasuritë natyrore të zonës. Në territorin e bashkisë Dibër numërohen gjithsej 4 rezervate peshku, 8,600 kosha me bletë dhe 170,000 shpendë.

4.5.1.3 Prodhimi bujqësor

Sipas të dhënave të grumbulluara nga Drejtoria e Bujqësisë, por edhe nga diskutimet me grupet fokus, në zonën e Dibrës mbillen kryesisht prodhimet tipike tradicionale bujqësore, si: drithërat e bukës, perimet, fasulet, foragjeret, patatet dhe frutat, ku peshën më të madhe e zënë molla, kumbulla, qershia, etj. Përsa i takon volumit të sasisë së prodhimit, më shumë prodhohen drithëra

buke, foragjere, patate, perime dhe më pak fruta, pasi destinacioni kryesor është për përdorim familjar.




Figura 11: Volumi i prodhimeve (Të dhëna nga Drejtoria e Bujqësisë)

Tregu i prodhimeve bujqësore: sasia e prodhimit bujqësor, që ka destinacion tregun është e vogël për disa arsye: (i) aksesit në tregje është i vështirë; (ii) nuk prodhohen produkte në sasinë dhe cilësinë e duhur për tregjet e mëdha; (iii) kostoja e prodhimit është e lartë. Për prodhimin synohet kryesisht tregu lokal në Peshkopi, por edhe tregu kombëtar, i cili kryesisht në Tiranë dhe që arrihet nga vetë tregtarët. Produktet më të kërkuara në treg janë pemët frutore (mollë, qersh, kumbull, arvore) dhe më pak drithërat e bukës. Figura më poshtë jep këtë marrëdhënie të kërkesës në treg.




Figura 12: Sasia e daljes në treg (SARED 2014 – Zinxhiri agrobuqësor në Dibër)

Analiza e kostos: prodhimet për nga rendimenti, kostoja e prodhimit dhe çmimi në treg janë shumë të ndryshme dhe për shumë kohë ato janë pothuajse të pandryshueshme në treg. Figura e mëposhtme jep këto të dhëna për secilin produkt.




Figura 13: Të ardhurat neto 1ha (SARED 2014 – Zinxhiri agrobuqësor në Dibër)

Grafiku i mësipërm tregon qartë rendimentin dhe fitimin për 1ha që kanë plantacionet me frutikulturë, me kërkesën më të madhe në treg dhe fitimin më të lartë.

4.5.1.4 Sfidat e sektorit bujqësor në Dibër

- Fragmentarizimi i madh i tokës, i cili rrit koston e shërbimeve, ul fitimin, dëmton cilësinë dhe sasinë e prodhimit, vështirëson aksesin e prodhuesve në treg dhe pengon investimet në këtë sektor.
- Mungesa e studimeve dhe orientimeve të fermerëve për të kaluar nga bujqësia tradicionale dhe primitive në bujqësinë intensive dhe të integruar.
- Mungesa e kapaciteteve dhe specialistëve për numër të fermerëve dhe apatia e njohjes dhe adaptimit të njohurive dhe teknikave të reja në bujqësi. Kjo reflektohet edhe në mungesën e aftësive për të hartuar plane dhe dosje aplikimesh me qëllim thithjen e investimeve në skemën e subvencioneve dhe programeve të tjera, që kanë në fokus bujqësinë.
- Mungesa e strukturave të kooperativave dhe mungesa e aftësisë së bashkëpunimit dhe kooperimit mes fermerëve. Ekziston ligji për Shoqëritë e Përbashkëta Bujqësore, i cili ndihmon në formalizimin e kooperimit mes fermerëve, por me këtë ligj nuk është punuar dhe nuk ka një fushatë ndërgjegjësimi të fermerëve për hapat, modelet dhe përfitimet që vijnë nga ky lloj bashkëpunimi, formalizimi i strukturës së kooperativës.
- Mungesa e një zinxhiri të plotë tregu, ku të përfshihen markat, pikat e grumbullimit, dyqanet e shitjeve, kontrolli, promovioni, që produktet bujqësore dibrane të kenë markën dhe linjën e tyre të tregut.

- Diversikimi i lartë i produkteve, duke bërë që familjet fermere dhe grupet prodhuese të merren me kultivimin e shumë kulturave që nuk japin rendiment dhe kanë normë fitimi të ulët.

4.5.2 Turizmi

Turizmi është sektori i dytë prioritar dhe me shumë potencial për zhvillimin e zonës të Dibrës. Potencialet e larta turistike, me burimet e shumta natyrore, vlerat e mëdha kulturore dhe historike, kulinarinë tradicionale e të pasur janë të pashfrytëzuara për turizmin.

4.5.2.1 Turizmi kurativ

Zona e Dibrës është e njohur për turizmin kurativ. Ai shfrytëzon burimet termale të Llixhave të Peshkopisë. Në këto llixha pushojnë rreth 12,000 pushues në vit, të cilët vijnë nga të gjitha trevat e Shqipërisë, Kosova dhe Maqedonia.

Në luginën e përroit të Llixhave, ose siç njihet nga popullsia lokale, “Lugina e Shërimit” gjendet burimi i famshëm termal i llixhave. Ato kanë një temperaturë rreth 40°C, me një përmbajtje kripërash dhe gazrash të tretura në to. Në këtë territor ndodhet dhe kompleksi balnear i llixhave, pronë e bashkisë Dibër. Aty ofrohen të gjitha shërbimet e nevojshme, duke filluar nga pishina, vaska, masazhi, balta dhe shërbimi mjekësor. Cilësia e ujit të llixhave të Peshkopisë është nga më të mirat në Evropë.

Llixhat, si pjesë e turizmit kurativ shërojnë dhimbjet reumatizmale dhe frekuentohen nga një shtresë e gjerë e popullsisë. Numri më i madh i pushuesve është ai i moshës 45-70 vjeç. Këta pushues vijnë nga pjesa e Shqipërisë Veriore, Tirana, Durrësi, Kosova dhe Maqedonia. Ky turizëm është sezonal dhe frekuentohet kryesisht në vjeshtë (shtator-nëntor) dhe në periudhën e pranverës, në sezonin mars-qershor.




Figura 14: Akomodimi për turizmin kurativ (Të dhënat nga Bashkia)

Akomodimi dhe shërbimi turistik janë në një gjendje të kënaqshme. Ato ofrohen nga një numër i konsiderueshëm hotelesh dhe shtëpish pritëse. Në zonën e përroit të Peshkopisë janë ndërtuar rreth 300 shtëpi pritëse (të madhësive të ndryshme) dhe 7 hotele me afro 60 shtretër, që u shërbejnë pushuesve. Në këto ambiente shërbimi ofrohet i plotë ditor (duke përfshirë fjetje, ushqim dhe terapinë e ujit të ngrohtë). Kostoja e shërbimit nuk është e lartë. Ajo u përgjigjet mundësive të klientelës dhe varion nga 10-13 Euro në ditë për një paketë 10-ditore, pra 100-130 Euro për person, me të gjitha shërbimet të përfshira.

4.5.2.2 Turizmi malor dhe rural

Zona e Dibrës ka potenciale të shumta për zhvillimin e turizmit malor dhe rural. Avantazhet që mbështesin zhvillimin e turizmit në Dibër janë:

- Burimet e shumta natyrore, si mali i Korabit (më i larti në Shqipëri), Vargmali i Lurës me 23 liqene akullnajore, 41 monumente të natyrës, peizazhi rural piktoresk.
- Vlerat historike, si vendlindja e Skënderbeut, zbulimet arkeologjike në Kalanë e Grezhdanit, Kishat e Peshkopisë, Kalaja e Çetushit, zbulimet arkeologjike në Çidhën, Muzeu i Peshkopisë dhe i Sinës.
- Tradita e pasur me doket dhe zakonet e lashta, “Oda Dibrane” (folk festival dhe traditë), alegoria dibrane, Kanuni i Nëntë Maleve, ose Skënderbeut, vallet, këngët dhe lojrat popullore (kalaja dibrance).
- Mikpritja: “Mikut i takon kryet e vendit”.
- Kulinaria dibrane, kuzhina e pasur (jufkat me pulë, pula me arra, llallangija, flija me rende, sheqerpareja, hallvaja me arra, etj).

Pengesat e zhvillimit të turizmit janë të shumta, por ndër më kryesoret rendisim:

- ✓ infrastruktura rrugore dhe turistike e dobët dhe e largët me qendrat metropolitane;
- ✓ mungesa e shërbimeve turistike;
- ✓ mungesa e operatorëve turistikë;
- ✓ kapacitetet e ulëta njerëzore për shërbime turistike;
- ✓ cilësia e dobët e shërbimeve;
- ✓ mungesa e investimeve në sektorin e turizmit (investime modeste);
- ✓ dëmtimi i burimeve natyrore, moskujdesi për zonat e mbrojtura dhe monumentet e natyrës;
- ✓ dëmtimi i monumenteve të kulturës, moskujdesi për zonat historike dhe monumentet e kulturës;
- ✓ mungesa e promovimit turistik të zonës;
- ✓ konkurrenca rajonale dhe e territoreve fqinje, që kanë infrastrukturë më të mirë;
- ✓ politikat e gabuara dhe spontane, të pabazuara në zgjidhjen e problemeve reale të turizmit (hapa të mëdhenj, pa kaluar në hapa të vegjël);
- ✓ paqartësia në pronësinë e pyjeve, natyrën dhe monumentet e natyrës;
- ✓ korrupsioni, etj.

5. Karakteristikat sociale

5.1 Analiza dhe vlerësimi i problematikave sociale

Kapitulli analizon dhe vlerëson problematikat sociale të bashkisë Dibër, ku janë përfshirë edukimi, kriminaliteti, komunitetet e marxhinalizuara, papunësia, etj. Ky kapitull jep një panoramë të përgjithshme të këtyre aspekteve sociale, që prekin komunitetin e bashkisë dhe ndihmon në përcaktimin e programeve dhe projekteve strategjike në këtë sektor. Fokusi i kësaj analize nxjerr në pah problematikat e mëposhtme.

5.1.1 Papunësia

Papunësia, sipas statistikave zyrtare të vitit 1999 kap shifrën 16 % të popullsisë në moshë pune. Por papunësia në të vërtetë mund të kapë shifra më të larta, 35-40% të popullsisë, vetëm se deri tani nuk kemi tregues të matshëm. Ndërkohë që papunësia është më tepër fenomen urban dhe reflektohet në treguesit e papunësisë së regjistruar në zyrat e punës, nëpunësimi (under-employment) është fenomen rural. Në zonat urbane të qytetit të Peshkopisë mendohet se papunësia kap shifrën 42% duke qenë kështu më e lartë se niveli mesatar kombëtar. Papunësia është më tepër e pranishme te të rinjtë, ku mbi 60% përqind e tyre janë nën moshën 34 vjeç.

5.1.2 Varfëria dhe grupet e rrezikuara

Grupet e rrezikuara dhe varfëria në Dibër nuk identifikohen vetëm te të papunët, apo te familjet që jetojnë në varfëri ekonomike. Ato përfaqësohen gjithashtu edhe nga kategori, të cilat janë të përjashtuara nga të drejtat themelore për të patur një banesë, ushqim të mjaftueshëm, ngrohje dhe veshje në dimër, punë në përputhje me aftësitë fizike dhe nivelin arsimor, shkollë afër shtëpisë dhe mundësi për ta ndjekur atë, shërbim primar shëndetësor, mbrotje nga grabitja dhe dhuna, të drejta dhe zë për të kërkuar të drejtat. Në Dibër jetojnë nën nivelin zyrtar të varfërisë rreth 4,859 familje dhe trajtohen me ndihmë ekonomike rreth 25% e familjeve që jetojnë në këtë territor.

Në Dibër përqindja e familjeve që mbështeten me të ardhura të pjesshme nga ndihma ekonomike është më e lartë në zonat rurale duke shkuar deri në 45-55% të popullsisë. Programi i mbështetjes së familjes me të ardhura (ndihma ekonomike), për shkak të pagesave tepër të ulëta nuk i ndihmon familjet të dalin nga varfëria.

5.1.3 Përjashtimi social i grupeve të rrezikuara

Varfëria, padituria, problemet në sistemin arsimor dhe atë shëndetësor ndikojnë direkt në përjashtimin e këtyre shtresave nga shoqëria. Megjithëse mungojnë të dhëna zyrtare në nivel komunitar, grupet e rrezikuara aktualisht përfaqësohen nga:

- fëmijë në rrezik (fëmijë që braktisin shkollën, fëmijë jetimë, fëmijë që punojnë, fëmijë të abuzuar, apo të përfshirë në gjakmarrje). Në Dibër janë gjithsej 623 fëmijë me aftësi të kufizuara, nga të cilët 286 janë femra dhe vetëm 402 prej tyre mund të vazhdojnë shkollën;

- gra në rrezik (të papuna, kryefamiljare, që vuajnë pasojat e dhunës brenda familjes, të trafikuar);
- të moshuar të vetmuar, të paaftë për t'u kujdesur për veten;
- të rinj në rrezik (përdorues të drogës, alkoolit, që braktisin shkollën, të rinj të papunë, të rinj të përfshirë në aktivitete kriminale, etj). Në Dibër, gjatë vitit 2015 janë dënuar rreth 13 të mitur, kryesisht për përdorim drogash të lehta dhe dëmtim pasurie;
- të paaftë dhe invalidë.

Skemat aktuale të mbrojtjes shoqërore, sistemi arsimor, shëndetësor, gjyqësor dhe policor janë të pamjaftueshme t'i mbrojnë, apo t'i integrojnë këto kategori në jetën normale. Popullsia e zonave rurale është më tepër e ekspozuar ndaj fenomeneve të përjashtimit social.

5.2 Analiza e zhvillimit social, punësimit, edukimit, shëndetit

Analiza dhe vlerësimi i problematikave sociale ka përfshirë edukimin, punësimin, shërbimet për shëndetësinë publike dhe jep një panoramë të përgjithshme të këtyre aspekteve sociale, që prekin komunitetin e Dibrës. Nëse në kapitullin paraardhës evidentohen dhe analizohen disa nga problematikat sociale, në këtë kapitull fokusi është nxjerrja në pah e potencialeve, pra pikat e forta të aspektit social.

5.2.1 Arsimi

Sistemi publik arsimor parauniversitar përfshin rreth nëntë shkolla të mesme, 41 shkolla 9-vjeçare dhe 69 kopshte, të shtrira në të 15-të njësitë administrative. Tabela më poshtë jep në një mënyrë më të detajuar këto të dhëna:

Njësia	Kopshte			Shkolla 9-vj			Shkolla te mesme		
	PUBLIK E	PRIVAT E	TOTALI	PUBLIK E	PRIVAT E	TOTALI	PUBLIK E	PRIVAT E	TOTALI
Dibër	69	0	69	40	1	41	9	0	9

Tabela: Të dhënat për sistemin arsimor në Dibër (Të dhëna nga Drejtoria Arsimore)

Gjatë vitit mësimor 2014-2015 numri i nxënësve në arsimin parauniversitar ishte 14,462 nxënës nga të cilët 2.124 nxënës i takojnë arsimit parashkollor, 9.525 nxënës arsimit 9-vjeçar dhe 2.813 arsimit të mesëm. Gjatë po këtij viti arsimor u angazhuan 1.087 mësues dhe edukatore, nga të cilët 112 janë edukatore, 749 mësues në ciklin 9-vjeçar dhe 226 mësues në shkollën e mesme.

Gjatë dhjetë viteve të fundit sistemi arsimor në përgjithësi dhe shkolla në veçanti, kanë qenë objekt i reformave ristrukturuese. Me financimet e buxhetit të shtetit, Bankës Botërore, Komunitetit Evropian, UNICEF-it, Fondacionit SOROS, IADSA-s janë rikonstruktuar rreth 48% e shkollave ekzistuese, janë ndërtuar të reja rreth 4 shkolla në Peshkopi, Melan, Kastriot, etj. Një ndër problemet më serioze të arsimit është braktisja e arsimit të detyruar 9-vjeçar. Përqindja e grupmoshës që duhet të ndjekë arsimin nëntëvjeçar është ulur në 95%. Më serioze paraqitet gjendja e fëmijëve, të cilët nuk regjistrohen në shkollë. Ky problem është më i ndjeshëm në zonat

e karakterizuara nga lëvizje të fuqishme migratore, si Reçi, Zall-Dardha, Lura, Selishta, Luznia, Slllova, dhe Kalaja e Dodës. Disa vlerësime dëshmojnë se në zonat e sipërpërmendura, rreth 5-10% e fëmijëve në moshë shkollare nuk janë të regjistruar në shkollë. Braktisja e shkollës është më shumë fenomen rural.

Mbipopullimi i zonës urbane në Peshkopi ka krijuar probleme, të cilat lidhen, jo vetëm me shpërndarjen gjeografike të shkollave, por edhe me funksionimin normal të orëve mësimore në shkollat ekzistuese. Në zonën urbane numri i nxënësve për një klasë është në rritje. Në të gjitha klasat e shkollave në qytet ky numër i kalon kuotat normale dhe arrin deri në 40- 42 nxënës për një klasë në arsimin nëntëvjeçar dhe 35-40 nxënës për një klasë në arsimin e mesëm.

E kundërt paraqitet gjendja në zonat rurale. Shpërndarja e madhe territoriale e komunitetit dhe numri i ulët i nxënësve për çdo klasë ka çuar në krijimin e klasave mikse, me deri 18 nxënës për shkollën nëntëvjeçare dhe 15 nxënës për shkollën e mesme, si në Zall-Dardhë, Reç, Muhurr, Kala e Dodës, etj.

Në Dibër gjendet një shkollë e mesme profesionale “Nazmi Rushiti”, ku ofrohet arsim i mesëm profesional në degët pedagogji, gjuhë të huaja, ekonomi, mekanikë. Ndërkohë, si rrjedhojë e nevojës së tregut, kësaj shkolle pritet t’i shtohen së shpejti edhe disa degë të tjera, si bujqësi, blegtori, etj.

Mbyllja e universitetit “Aleksandër Moisiu” në Dibër shënoi një regres për sistemin arsimor në Dibër. Universiteti pati një ndikim pozitiv në rritjen e njohurive dhe nxjerrjen e studentëve për degë të ndryshme, që përshtateshin mjaft mirë me tregun e punës. Megjithëse degë e universitetit të Durrësit, ai pati dhe një impakt social e shoqëror në rajonin e Dibrës, duke i dhënë pamjen e qytetit universitar, me më shumë gjallëri. Kjo eksperiencë shtron nevojën e hapjes së një dege universitare në Dibër, me orientim drejt tregut të punës dhe më afër profilit të zonës, që lidhet me zhvillimin agrar dhe ekonominë rurale.

5.2.2 Shëndetësia

Në Dibër aktualisht operojnë në nivel komuniteti 162 qendra mjekësore pa shtretër (1 poliklinikë, 15 qendra shëndetësore dhe 146 ambulanca, 1 spital rajonal, 15 konsultore të nënës, 15 konsultore për fëmijë dhe 15 farmaci dhe 11 klinika dentare private).

Spitali rajonal ofron shërbime në patologji, obstetri-gjinekologji, kirurgji, infektiv, pediatri, reanimacion, radiologji dhe shërbime laboratorike. Spitali ka një kapacitet prej 270 shtretërish. Numri i punonjësve në shërbimin shëndetësor është 24 mjekë specialistë, 222 staf mjekësor (infirmierë) dhe 137 punonjës administrate. Struktura gjinore e stafit spitalor është 84% femra, ndërkohë që femrat përbëjnë vetëm 33% të mjekëve specialistë. Shërbimi spitalor është i përqendruar në tri godina, ku kurohen, jo vetëm pacientë nga bashkia, por dhe nga të gjitha njësitë administrative të rrethit të Dibrës. Në sajë të investimeve të kryera janë përmirësuar ambientet dhe pajisjet mjekësore, ndërkohë që mbetet shqetësim mungesa e mjekëve në disa specialitete. Kjo mungesë detyron shumë pacientë të shkojnë për kurim dhe vizita mjekësore më të specializuara drejt Tiranës.

Sistemi shëndetësor shqiptar është një nga më të pabarabartët në Evropë dhe Azi, sipas Bankës Botërore në një studim të vitit 2013. Sipas studimit të vitit 2014, Shqipëria shpenzon rreth 2.6% të PBB-së për kujdes shëndetësor, por nga kjo sasi mbulon vetëm 40% të nevojës dhe njerëzit paguajnë 60%-in e mbetur. Sipas Bankës Botërore, për 17% të familjeve shqiptare kostoja e kujdesit shëndetësor është shumë e rëndë, pasi kalon 10% të të ardhurave të tyre. Tranzicioni i vështirë ka lënë gjurmë edhe në sistemin shëndetësor në Dibër. Treguesi në ulje i jetëgjatësisë mesatare, nga 72 në 70.5 vjeç, niveli i lartë në përgjithësi i mortalitetit, 10 të porsalindur, niveli i lartë i mortalitetit mëmësor, i theksuar ky në zonat rurale, të gjithë këta janë tregues të një gjendjeje jo shumë të kënaqshme.

Qendrat mjekësore pa shtretër u bënë objekte të shkatërrimit dhe zaptimit, kryesisht në zonën e fshatrave. Me institucionet spitalore dhe ato të shërbimit parësor ka gjithmonë probleme, që lidhen me pronësinë e tokës. Sot zona e Dibrës ka edhe numrin më të vogël të qendrave shëndetësore për çdo 10,000 banorë dhe gjendja në këto qendra nuk është e kënaqshme. Mungesa e infrastrukturës, që lidhet me rrugët, si dhe me mjetet, çon në rritjen e rasteve të urgjencave të patrajtuara nga personeli i kualifikuar.

5.2.3 Strehimi

Strehimi në Dibër është kryesisht privat. Numri total i banesave nuk është i regjistruar, por vlerësohet të jetë tek 11,000 shtëpi në zonën rurale dhe 3,250 shtëpi në zonën urbane, vlerësim i bërë nga zyra për planifikimin e urbanistikës në bashki.

Aktualisht njësia e qeverisjes lokale, që është përgjegjëse për strehimin ka mbuluar vetëm pjesën e familjeve që jetojnë në zonën urbane (qytetin e Peshkopisë), sepse në zonën rurale është mbuluar nga vetë banorët. Në qytetin e Peshkopisë, ku vlerësohet se janë 3,250 shtëpi banimi, në çdo shtëpi jetojnë afro 1.5 familje. Numri i shtëpive është më i vogël se numri i familjeve, për shkak të kushteve ekonomike dhe pamundësisë së njerëzve për të blerë një shtëpi.

Sidoqoftë, shifra 1.5 duket shumë e madhe për faktin se ka plot njerëz të papërfshirë në këtë shifër. Për momentin janë 750 familje të regjistruara si të pastreha dhe që po presin të marrin një apartament. Ka shumë prej këtyre familjeve që jetojnë me të afërmit e tyre, apo diku tjetër me qera. Më parë bashkia e Peshkopisë ka përfituar nga mbështetja e qeverisë qendrore me programet e saj për strehimin, falë dhënies së kredive me interes 0, si dhe me projektin e banesave sociale, financim i CEB-së (Banka Qendrore Evropiane). Në total janë ndërtuar 26 apartamente dhe u janë shpërndarë të pastrehëve.

Gjatë viteve të fundit janë ndërtuar disa pallate me apartamente të shumta në disa lagje të qytetit, ashtu siç është përcaktuar nga bashkia, shumë banesa private multifunksionale dhe shtëpi private në periferi të qytetit. Këto shtëpi janë ndërtuar si prona private, por pa leje ndërtimi (në total 2,932 kërkesa janë në proces legalizimi). Vetëm 122 certifikata legalizimi janë përfunduar.

6. Karakteristikat demografike/Demografia

Popullsia e zonës së Dibrës përbëhet nga 78,940 banorë, e shpërndarë kjo popullsi në qytetin e Peshkopisë dhe në 141 fshatra. Qyteti i Peshkopisë është qendra urbane e zonës së Dibrës dhe ka një popullsi prej 20,000 banorësh, ndërsa popullsia tjetër banon në zonën rurale të Maqellarës, Melanit, Tominit, Kastriotit, Fushë-Çidhnës, Sillovës, Kalasë së Dodës, Reçit, Zall-Dardhës, Arrasit, Muhurrit, Luznisë, Selishtës dhe Lurës. Tabela e mëposhtme jep strukturën e popullsisë.

Popullsia	Familje	M	F	Moshë (0-14)		Moshë (15-59)		Mbi 60	
				M	F	M	F	M	F
78,940	21381	40,624	38,314	9103	8270	27039	25082	4491	4960

Tabela: Struktura e popullsisë në Dibër (Të dhëna nga zyra e Gjendjes civile)

Gjatë dekadës së fundit situata demografike në zonën e Dibrës ka ndjekur të njëjtën tendencë me zonat e tjera në veri dhe veri-lindje. Ajo është karakterizuar nga një lëvizje e përgjithshme e popullsisë drej qendrave metropolitane dhe urbane të rajoneve të tjera dhe migracionit brenda zonës funksionale, kryesisht në qytetin e Peshkopisë. Mes viteve 1990 dhe 2013 popullsia është ulur deri në 25% (në varësi të metodës së matjes). Migrimi më i lartë ka ndodhur gjatë viteve 1990-2006. Që nga viti 2006 ndryshimi i numrit të popullsisë është më i vogël, përkatësisht 2,1% dhe 1,6% për periudhat 2006-2008 dhe 2008-2013. Tendencat e lëvizjes ka qenë e pranishme pothuajse në të gjitha njësitë administrative, por më e dukshme, në komunat malore të Zall-Dardhës, 59% dhe Reçit, 58%.

Vitet	1990	2012	2013	2014	Sipër/ km ²	Dendësia banorë/ km ²
Popullsia	92000	82802	78944	78940	1001.51	78.82

Tabela: Lëvizja mekanike në vite (Të dhëna nga zyra e Gjendjes civile)




Figura 16: Harta e shpërndarjes së popullsisë

Dendësia mesatare e popullsisë në zonën e Dibrës është 78.2 banorë/km², një shifër shumë më e ulët se niveli kombëtar, 148 banorë/km². Kjo shifër varion nga 270 banorë/km² për zonat fushore në 50 banorë/km² për zonat malore.

Dendësinë më të madhe e ka qyteti i Peshkopisë me 1,008 banorë/km dhe përbën 25% të popullsisë së zonës, ndërsa dendësinë më të ulët e ka zona malore e Zall-Dardhës, Reçit dhe Lurës, me shifra që variojnë nga 11-24 banorë/km².

Shifra e popullsisë urbane ka qenë pak a shumë e qëndrueshme gjatë periudhës 2002-2013. Aktualisht popullsia urbane përbën 25% të totalit të popullsisë.

Bazuar në analizën e zhvillimeve demografike dhe hapësinore, Dibra si bashki paraqet karakteristikat e mëposhtme:

Zona e Dibrës ka një popullsi relativisht të re. Megjithatë, kjo zonë vazhdon të përjetojë lëvizje të popullsisë nga pjesët me më pak mundësi ekonomike, në veri, drejt bregut perëndimor, veçanërisht në pjesën qendrore, Tiranë dhe Durrës. Ky fenomen parashikohet të ketë pasoja të dukshme për zhvillimin e zonës, pasi bashkë me lëvizjen demografike, lëvizin dhe kapitalet financiare e ato njerëzore, duke krijuar kështu zona të boshatisura.

Karakteristikat gjeografike (relievi i thyer dhe largësia mes qendrave të banuara) ndikojnë në lidhjet e zonave periferike, që janë kryesisht malore, me qendrën administrative dhe shërbimet bazë, duke paraqitur në këtë mënyrë sfida të rëndësishme socio-ekonomike dhe administrative. Kjo është një karakteristikë që duhet të merret parasysh në menaxhimin e ardhshëm të NJQV-së.

7. Infrastruktura

Ky kapitull paraqet analizën e gjendjes ekzistuese të infrastrukturës rrugore, transportit dhe të fluksit të lëvizjes së mjeteve. Gjithashtu, ky kapitull paraqet situatën e gjendjes së infrastrukturave të tjera bazë, të cilat kanë ndikim direkt në cilësinë e jetës, si ujësjellës-kanalizime, infrastruktura e menaxhimit të mbetjeve, kanalet e ujitjes për tokat bujqësore, telekomunikacioni, shërbimet e internetit të paraqitura më poshtë:

7.1 Infrastruktura rrugore

Sistemi rrugor i zonës funksionale të Dibrës përbëhet nga një sistem rrugor prej 911 km, nga të cilat 145 km janë të asfaltuara dhe 766 km të paasfaltuara. Infrastruktura rrugore funksionon mbi bazën e tre kategorive kryesore rrugore, që janë: rrugë kombëtare, gjithsej 109 km, nga të cilat 60 km janë të asfaltuara, rrugë rajonale, gjithsej 72 km, ku vetëm 3 km janë të asfaltuara dhe rrugët lokale të brendshme që lidhin fshatrat dhe lagjet me njëra-tjetrën, gjithsej 730 km, nga të cilat 82 km të asfaltuara. Në figurën më poshtë jepen treguesit e sistemit rrugor.




Figura 17: Paraqitja grafike e sistemit rrugor në Diber (Të dhëna nga Këshilli i Qarkut)

Siç shikohet edhe nga grafiku, shumica e rrugëve janë të paasfaltuara, por edhe rrugët e asfaltuara, që përbëjnë 16% të infrastrukturës rrugore, lënë për të dëshiruar, sidomos pjesa e akseve të rrugës nacionale.

Zona e Dibrës ka një akses të vështirë e të kufizuar në rrjetet infrastrukturore kryesore të vendit, përfshi kryeqytetin, portet dhe aeroportin. Projekti i ndërtimit të Rrugës së Arbrit i hap një mundësi shumë të rëndësishme zhvillimit të




Figura 18: Harta e rrjetit rrugor Diber

zonës në lidhje me aksesin shumë të shpejtë në tregjet kombëtare dhe rajonale, nga 182 km vetëm në 78 km, dhe me rrugë cilësore.

7.2 Trafiku rrugor dhe parkimi

Ndryshimet social-ekonomike, të ndodhura pas viteve 1990 u shoqëruan edhe me ndryshime në të drejtën e pronësisë mbi automjetet private. Vihet re se ky trend në Shqipëri është gjithmonë në rritje, edhe pse, krahasuar me rajonin numri i automjeteve për 1000 banorë mbetet i ulët. Sipas të dhënave të INSTAT-it dhe ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, në Shqipëri raporti është 121 automjete për 1000 banorë. Në mungesë të të dhënave mbi numrin e mjeteve për banorë në bashkinë Dibër (duke konsideruar mesataren kombëtare prej 1000 banorësh), vetëm për numrin e rezidentëve (rreth 1,000 banorë) rrjeti rrugor ekzistues, pavarësisht gjendjes së tij, përmbush kërkesat për lëvizshmëri të rezidentëve.

Peshkopia karakterizohet nga trafik jo shumë i rënduar, i cili lehtësohet edhe nga parkimet buzë rrugëve dhe parkimet e shpërndara në hapësirat publike.

Në qytetin e Peshkopisë nuk ka linja të rregullta transporti dhe ende nuk ka një terminal të integruar për autobusët rreth-qytetës. Bashkisë i mungon stacioni i autobusëve qytetas dhe ndër-qytetas, për të mundësuar kështu lidhjen e qytetit me rrethinat e tij. Kjo situatë kërkon realizimin dhe zhvillimin e një pike të tillë tranziti, ashtu sikurse kërkon të shoqërohet me krijimin e një unaze perëndimore, në mënyrë që të ulët fluksi i makinave për qytetin.

7.3 Transporti publik

Transporti publik është privat dhe kryhet me furgonë. Në të gjithë zonën e Dibrës nuk ka transport me autobuzë, tren apo aeroport. Transporti lokal, që lidh qendrat e komunave dhe fshatrat me Peshkopinë, kryesisht bëhet me furgonë jo të licencuar. Përllogaritet të jenë rreth 282 furgonë që kryejnë aktivitet në nivel lokal. Më e vështirë është rruga e Lurës, që nuk ka linjë me Peshkopinë, si dhe zonat e Reçit, Dardhës, Selishtës, Arrasit, Slllovës dhe Kalasë së Dodës. Mjetet e transportit në këto zona lëvizin vetëm dy herë në ditë (mëngjes dhe pasdite). Për zonat e tjera situata e transportit është më e mirë.

Transporti publik me Tiranën kohët e fundit është disiplinuar. Ai kryhet me furgonë të licencuar që kanë një kapacitet mbi 11+1 persona. Ata nisen me një orar të mirëpërcaktuar dhe janë brenda kushteve teknike dhe standardeve të vendosura nga ministria e Punëve Publike dhe Transportit. Gjithsej numërohen 284 furgonë, të cilët nisen çdo ditë nga Peshkopia dhe Tirana në orare fikse: pothuajse në çdo 20 minuta niset një furgon me orare, që fillojnë nga ora 5:30 e mëngjesit dhe mbarojnë në orën 15:00 të pasdites.

7.4 Ujësjellës-kanalizimet

Spektori i ujësjellës-kanalizimeve në zonën e Dibrës është një sektor shumë i rëndësishëm. Nëpërmjet tij sigurohet furnizimi me ujë të pijshëm dhe procesi i largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura.

Burimet ujore: furnizimi me ujë bëhet kryesisht nëpërmjet përdorimit të ujërave të burimeve sipërfaqësore. Kjo gjë pa ndonjë trajtim të veçantë, për arsye se cilësia e tyre është brenda kushteve higjieno-sanitare të përcaktuara nga standardet e cilësisë së ujit të pijshëm, me karakteristikat fiziko-kimike të lejuara. Burimet kryesore të ujit të pijshëm, që shfrytëzohen në zonën e Dibrës janë: burimi i Preshit dhe i Bjeshkës së Shehit në Korab, Sopanika në Arras, Lashkiza në Zall-Dardhë, Gura e Muhurrit, Gura e Meres në Luzni, Burimet e Selishtës, Hinoska në Melan, burimet e Kërcinit në Maqellarë.

Megjithëse me shumë burime ujore, sistemi i ujit të pijshëm dhe KUZ-i është problematik në Dibër, pasi ky shërbim lë pa mbuluar një pjesë të konsiderueshme të popullsisë, rreth 83.5% me KUZ dhe 39% me ujin e pijshëm. Mesatarisht në Dibër nuk ka më shumë se 4-8 orë ujë në ditë, për shkak të keqmenaxhimit dhe keqadministrimit të ujit.

Mungesa e investimeve, apo investimet e gabuara, siç është rasti i ujësjellësit të Peshkopisë, me burimet ujore nga lumi Drin dhe ai i ujësjellësit të Maqellarës, me sistem pompimi, kanë pasur efekt negativ në situatën e shërbimit me ujë të pijshëm. Gjithashtu, konfliktualiteti i lartë social mbi pronësinë është bërë pengesë për investimet dhe realizimin e disa ujësjellësave, si rasti i ujësjellësit të Luznisë (i ndërtuar më 1997-1998), 15 km i gjatë. Ai u përgjigjet kërkesave për ujë të 14,000 banorëve. Mungesa e aftësisë për zgjidhjen e konflikteve sociale, ligjore dhe të pronësisë ka bërë që shumë projekte apo investime të dështojnë, apo të mos fillojnë.

Investimi prej 4 milion Eurosh, i mbështetur nga qeveria austriake (është në proces), për rehabilitimin e gjithë rrjetit të brendshëm me gjatësi 33km, të depove, të 24 pikave të kryqëzimit me fshatrat, të pasarelës së Përroit të Kapshit, dhe vendosjes së dy klorifikatorëve dhe 3,500 aparateve pritet me shumë interes. Ai do të përmirësojë ndjeshëm furnizimin dhe cilësinë e ujit.

7.5 Rrjeti i kanalizimeve

Në Dibër vetëm 27% e popullsisë ka akses në sistemin e kanalizimeve. Kryesisht Peshkopia, në masën 98% dhe më pak fshatrat, si: Kastrioti, Maqellara, Tomini dhe Muhurri. Karakteristik është fakti se nuk ka ndërhyrje për përpunimin e tyre, kështu që ato derdhen në përrenj ose lumin Drin.

Në Peshkopi rrjeti i kanalizimeve të ujërave të zeza është i amortizuar dhe me kapacitet më të vogël se nevoja e banorëve të Peshkopisë. Me gjithë ndërhyrjet për rikonstruktimin e këtij rrjeti, me mbështetjen e Bankës Islamike, një pjesë e madhe e tij ka nevojë për ndërhyrje të mëtejshme. Ujërat e ndotura, në mungesë të impiantit përpunues derdhen në përroin e Llixhave dhe në atë të Tominit.

7.6 Rrjeti elektrik dhe rrjeti i telefonisë celulare

Furnizimi me energji elektrike i bashkisë Peshkopi mundësohet nga hidrocentrali i Ulzës. Shërbimi i furnizimit është i vazhdueshëm gjatë 24 orëve.

Shërbimi i telefonisë fikse dhe internetit mbulohet nga “Albtelecom”. Shërbimi i telefonisë celulare ofrohet nga operatorët e tjerë të telefonisë celulare dhe mbulon të gjithë territorin e bashkisë, duke zgjidhur plotësisht problemin e komunikimit për qytetarët e Peshkopisë.

Niveli i komunikimit elektronik në bashkinë Dibër bëhet me lidhjet ADSL (20% në zonën urbane), lidhjet e telefonisë fikse (62% në zonën urbane) dhe me telefonat celularë në masën 88%.

7.7 Menaxhimi i mbetjeve urbane

Në bashkinë Dibër mbulimi me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve kryhet vetëm për 26.3% të familjeve. Këtu, vetëm qyteti i Peshkopisë mbulon të gjitha familjet, ndërsa në zonat rurale nuk ofrohet ky shërbim.

Mbledhja dhe transporti i mbetjeve, si dhe i gjithë shërbimit të pastrimit kryhet nëpërmjet brigadës së pastrimit, që është pjesë e bashkisë. Në qytet gjenden pikat e grumbullimit të mbetjeve, të cilat janë vendosur në blloqe pallatesh. Gjithsej janë 160 kazanë, ku hidhen mbetjet shtëpiake, mbetjet tregtare dhe mbetjet industriale. Mbetjet spitalore kanë koshat e tyre pranë spitalit rajonal të Peshkopisë. Transporti i mbetjeve bëhet nga pesë makina, që janë pronë e bashkisë (4 në gjendje të mirë dhe 1 jashtë shërbimit), si dhe 1 traktor me zinxhir, që gjendet në fushën e depozitimit. Brigada është përgjegjëse edhe për procesin e fshirjes së rrugëve dhe gjelbërimit.

Depozitimi i mbeturinave është një problem i madh, pasi ka vetëm një fushë depozitimi, jo me kriteret teknike dhe ku mbeturinat digjen, duke ndotur ajrin. Ujërat që dalin nga kjo fushë ndotin përroin e Dohoshishtit. Në zonat rurale ato hidhen buzë përrenjve dhe lumenjve, jashtë çdo standardi dhe kriteri.

Kohët e fundit, me mbështetjen e DLDP-së, programi zviceran në Shqipëri, ka filluar puna për hartimin e planit të menaxhimit të mbetjeve urbane dhe përmirësimin e pastrimit, duke investuar në teknologji, rehabilitimin e fushës ekzistuese të depozitimit dhe shtrirjen e shërbimit edhe në zonat rurale, ose rrethinat e Peshkopisë. Ky do jetë një pilotim i mirë i projektit “Dibra e pastër”, si një nga projektet prioritare.

7.8 Infrastruktura e ujitjes

Aktualisht ujitja e tokave bujqësore në bashkinë e Dibrës, nga Ura e Topojanit deri në Urën e Dodës në drejtim të rrjedhës së lumit Drin i Zi (kufijtë natyrorë), realizohet kryesisht me: (i) kanale ujitëse, që sigurojnë prurje vetëm nga marrja e ujit nga perrenjtë dhe burimet natyrore; (ii) ujëmbledhësat, të ndërtuar pas viteve 1960; (iii) ujitja me ngritje mekanike, që është braktisur plotësisht.

Veprat kryesore të marrjes së ujit nga perrenjtë dhe burimet natyrore (kanalet ujitëse) jepen në pasqyrën e mëposhtme:

Nr	Emërtimi i Veprës (kanalit)	Aftësia ujitëse (ha)	Burimi i furnizimit
1	Kanali Setë-Zall Dardhë	600	Përroi i Setës dhe burimet e tij
2	Kanali Setë-Kastriot	400	Përroi i Setës dhe burimet e tij
3	Kanali Setë-Fushë Alie	250	Përroi i Setës dhe burimet e tij
4	Kanali Mure-Vakuf	500	Përroi i Mures dhe burimet e tij
5	Kanali Kacni-Gjuras	300	Liçenet natyrore Shtrungez Bataqe
5	Kanali Katund i Ri	100	Lumi Drin i Zi
6	Kanali Cernjevë-Trojak	400	Përroi i Veleshicës
7	Kanali Gramë-Sohodoll	400	Përroi i Gramës
8	Kanali Qendër (Kandrit)	400	Burimet e Përroit të Llixhave
9	Vepra të vogla ujitëse	1000	Burime, hurdha, hauze
	Shuma	4 350	

Tabela: Sistemi i ujitjes me kanale ujitëse (Të dhëna nga Drejtoria e Ujërave)

Marrja e ujit nga rezervuarët kryesorë ka qenë një teknologji e përdorur pas viteve 1960, kohë kur u ndërtuan një sërë veprash ujëmbledhëse për ujitje, por që u përdorën edhe për peshkim. Vitet e fundit, në vendet e EU-së kjo metodë përdoret si instrument për projektet e ndryshimeve klimatike. Në territorin e bashkisë Dibër gjenden këto rezervuare:

Nr.	Emërtimi i Veprës (Rezervuari)	Kapaciteti mijë m ³	Aftësia ujitëse (ha)
1	Rezervuari Shumbat	300	100
2	Rezervuari i Gramës	300	100
3	Rezervuari i Renxit	300	100
4	Rezervuari i Melanit	150	50
5	Rezervuari i Qenokut	450	150
6	Rezervuari i Grezhdanit	300	100
	Shuma	1 350	600

Tabela: Veprat ujëmbledhëse në Dibër (Të dhëna nga Drejtoria e Ujërave)

Me kalimin e funksionit të ujitjes bashkisë duhet patjetër që stafi i ri të ketë një studim të plotë për inventarizimin e veprave ujitëse. Ky staf duhet të ketë edhe një plan menaxhimi, në bashkëpunim me komisionet dhe shoqatat e menaxhimit të kanaleve ujitëse në ato zona ku ato janë ngritur nga programi IFAD2.

8. Çështjet e pronësisë

8.1 Pronat publike

Procesi i inventarizimit dhe transferimit të pronave publike rregullohet me Ligj Nr. 8743, datë 22.2.2001, shpallur me dekretin nr. 2916, datë 9.3.2001 dhe Ligj Nr.8744, datë 22.2.2001, shpallur me dekretin nr.2917, datë 9.3.2001 si dhe nga VKM-ja nr.500, datë 14.8.2001.

Pronat publike të shtetit, sipas legjislacionit aktual grupohen në dy kategori:

1. Prona me interes kombëtar;
2. Prona me interes vendor, që me vendim të Këshillit të Ministrave regjistrohen pranë Zyrave të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, nga këshilli i bashkisë përkatëse.

Kalimi i pronave në favor të bashkive ka ecur nëpër tre faza, ku të gjitha Njësitë e Qeverisjes vendore kanë qenë pjesë e këtij procesi. Ai përbëhet nga:

- miratimi i listës së inventarit
 - miratimi i listave paraprake
 - miratimi i listës përfundimtare të pronave publike.
- Secila fazë kalon me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.

Më pas, bashkia përgjegjëse në bashkëpunim me ZRPP-të përkatëse bën regjistrimin e pronave. Administrimi i mëtejshëm vazhdon sipas ligjeve për funksionimin e pushtetit vendor dhe Kodit Civil në Republikën e Shqipërisë.

Bashkia Dibër është e përbërë nga 15 njësi administrative. Të gjitha këto njësi e kanë përfunduar fazën e parë, atë të miratimi të listës së inventarit. Nëntë prej tyre kanë miratuar listat paraprake të inventarit, 3 prej tyre kanë miratuar listën përfundimtare të pronave publike.

Sa u përket pronave të tipit, pyje-kullota, me procedurë të përsheptuar janë miratuar me listë përfundimtare 13 njësi administrative.

Nr	Bashkia	EMERTIMI		ECURIA E PROCESIT				
				Miratur lista e inventarit	Miratur lista paraprake	Miratur lista përfundimtare	Miratur pyje-kullota	Shënime
6	Dibër	Qendra e bashkisë	Nj. Adm. Përbërëse	15	9	3	13	
1		Peshkopi	Peshkopi	2006-04-10	67/28.1.08	1533/19.11.08		
2			Tomin	1529/19.11.08	51/16.1.2013		796/4.6.08	
3			Melan	1179/ 20. 08. 08			743/28.5.08	
4			Kastriot	719/30/10/07	367/1.4.09		121/3.2.08	
5			Lurë	182/19.2.09			796/4.6.08	
6			Maqellarë	700/ 21.05.08			607/14.5.08	
7			Muhurr	760/28.5.08	305/10.4.2013		742/28.5.08	
8			Luzni	791/16/11/06			608/14.5.08	
9			Selishtë	102/3.2.08			746/28.5.08	
10			Sillovë	479/16.4.08	211/16.3.2011		745/28.5.08	
11			K.Dodës	701/21.05.08	126/22.2.2012	699.10.102012	698/21.5.08	
12			Zall-Dardhë	204/21.2.08	451/18.4.2013		744/28.5.08	
13			Zall-Reç	92/31.3.07			122/3.2.08	
14			F.Çidhën	1237/10.9.08	364/24.4.2013			
15			Arras	705/19/10/07	70/21.1.09	1001/10.12.10	119/3.2.08	

Tabela: Situata e procesit të regjistrimit të pronave publike (Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike)

Lidhur me regjistrimin e pronave publike në favor të Këshillit Bashkiak, pranë ZRPP-së Peshkopi mungon informacioni i saktë dhe i përditësuar. Në raport me bashkitë e tjera të Republikës, bashkia Dibër është shumë mbrapa me tërë procesin.

8.2 Pronësia mbi tokën

Duke parë problematikat, që kanë shoqëruar pronësinë mbi tokën këto 25 vitet e fundit, marrëdhëniet njerëzore në zona të ndryshme të vendit rezultojnë mjaft konfliktuale. Kjo situatë, përveçse e kthyer në një problem social për banorët, është direkt e lidhur edhe me pengimin e zhvillimit (nga investitorë të huaj dhe vendas) në këto zona. Gjithashtu, në këtë kapitull duhet referuar edhe niveli i informalitetit dhe ecuria e procesit të legalizimit.

E drejta e pronësisë është parakusht për mirëfunksionimin e ekonomisë së tregut dhe demokracisë. Në Dibër toka nuk është ndarë sipas ligjit 7501, por secili ka marrë tokën e tij, ose, kthimi i pronës tek i zoti. Ky proces u bazua në të drejtën zakonore dhe u krye mbi bazë të

komisioneve të ngritura nga vetë komuniteti. Probleme me moszbatimin e zakonit ka vetëm në Maqellarë, ku për disa toka është zbatuar ligji 7501.

Megjithatë, në praktikë, edhe në Dibër ndeshen disa vështirësi dhe konflikte për pronësinë e tokës, konflikte që vazhdojnë të jenë çështje gjyqësore. Arsyet janë të shumëllojshme, sepse kanë ndodhur një sërë ndryshimesh me tokën, si: prishja e kufijve, tjetërsimi, ndërtimet industriale dhe qendrat urbane, problemet e trashëgimisë, etj. Mungesa e kulturës institucionale, regjistrimet jo të sakta, arkivimi i dobët, baza ligjore jo e plotë dhe e ndryshueshme, të gjitha këto krijuan vonesa dhe zvarritje të njohjes së pronësisë dhe certifikimit të pronave. Kështu, individët i kanë pronat në zotërim, por nuk kanë dokumentacionin përkatës, si dhe dokumente të njohjes së pronësisë.

Më problematike kjo çështje ka qenë në qytetin e Peshkopisë dhe në zonat me interesa ekonomike, si ish-ndërmarrje, apo ish-godina, të cilat në vitet e para iu nënshtruan edhe procesit të privatizimit me ligjet e kohës, ku si pronarë njiheshin ish-punëtorët. Të gjitha këto janë probleme si kudo tjetër në Shqipëri.

Regjistrimi i pronave në ZRPP dhe marrja e certifikatës ka krijuar probleme edhe për investimet, pasi ato kushtëzohen nga marrja e lejes së ndërtimit për hapjen e një biznesi, apo ngritjen e një objekti. Më e dallueshme kjo pengesë ka qenë për aplikimet e bëra si pjesë e skemave të subvencionit në bujqësi dhe për agropërpunimin. Këto janë fonde të donatorëve pranë ministrisë së Bujqësisë.

Procesi i legalizimit ka vazhduar edhe në zonën e Dibrës. Akoma nuk kemi shifra të sakta, por vetëm për bashkinë e Peshkopisë janë depozituar 2,932 kërkesa, nga të cilat janë aprovuar 122 leje nga ALUIZNI në Dibër. ALUIZNI ka dhe hartën në GIS për gjithë territorin e qendrave urbane të zonës së Dibrës dhe po vazhdon punën për inventarizimin e saktë të ndërtimeve informale dhe procesin e legalizimit të tyre.

Problem në Dibër është ajo pronësi toke që konsiderohet si pronë e fshatit, ose siç njihet ndryshe në terminologjinë popullore, vakufe. Këto prona janë nën shfrytëzimin, menaxhimin dhe administrimin e fshatrave. Akoma nuk kemi një bazë ligjore që t'i njohë ato. Kjo gjë krijon mundësi për konflikte me të quajturën e tyre, prona të shtetit. Këto prona përbëjnë rreth 8% të sipërfaqes së territorit në Dibër.

9. Çështjet, zonat dhe/ose objektet e rëndësisë kombëtare

Në Dibër ndodhen një sërë zonash dhe objektesh me rëndësi kombëtare. Këto janë zonat historike, arkeologjike dhe kulturore, si dhe parqet natyrore, zonat e mbrojtura me rëndësi kombëtare dhe vendore.

Monumente culture, të shpallura sit ë tilla për rëndësinë e tyre arkeologjike dhe kulturore, dhe që mbrohen me ligj janë Kalaja e Grezhdanit, Kisha e Shpërfytyrimit në Herbel, Kisha e Shën-Dhimitrit në Kërçisht, Xhamia e Allabegisë, Kulla e Zunës në Sohodoll.

Zona të Mbrojtura, rezervate dhe monumente natyrore në territorin e Dibrës janë Parku Kombëtar i Lurës, Parku Natyror Korab-Korritnik, rezervati i mbrojtur Bulaç-Luzni dhe 41 monumentet e natyrës me vlera gjeomonumentale, hidromonumentale dhe biomonumentale.

Përdorimi i burimeve natyrore dhe rezervave minerare e inerteve realizohet ashtu siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi. Kjo lidhet më shumë me procesin e shfrytëzimit dhe zhvillimit të këtyre pasurive. Ministrinë e linjës janë përgjegjëse për dhënien e lejeve për shfrytëzim të këtyre resurseve.

Zonat, instalimet dhe objektet e destinuara për qëllime të mbrojtjes kombëtare, të rendit dhe sigurisë publike janë vendosur në pikën kufitare të Bllatës, ku është edhe posta e policisë kufitare. E gjithë zona kufitare konsiderohet si zonë e sigurisë kombëtare dhe u nështrohet ligjeve përkatëse.

Prona të paluajtshme publike, që i përkasin shtetit, me aktivitet të ngurtësuar (ose të trupëzuara), që shërbejnë për kryerjen e shërbimeve publike janë:

- rrugët dhe urat nacionale
- sistemet e prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë

Në Dibër gjenden tre nënstacione, që bëjnë shpërndarjen e energjisë, si ai i Maqellarës, Peshkopisë dhe Çidhnës.

- sistemet e shërbimit të telekomunikacionit dhe postës
- sistemet e furnizimit me ujë të pijshëm
- sheshet publike në qytete e qendra të banuara, ndërtesat së bashku me oborret, që përdoren për shërbime të ofruara nga shteti për arsimin, shkencën, kulturën dhe sportet, për shërbimin shëndetësor e shoqëror, për institucionet qendrore dhe vendore, si dhe rezidencat qeveritare, së bashku me trojet mbi të cilat ngrihen këto prona.

10. Analiza e elementeve të rëndësishme territoriale

Më poshtë paraqitet analiza e elementeve të rëndësishme territoriale, natyrore apo artificiale, që kanë ndikuar dhe ndikojnë në formimin e vazhdueshëm të territorit të bashkisë Dibër.

10.1 Zonat gjeotermale

Dibra është një vend i pasur me zona gjeotermale, të cilat shfrytëzohen nga banorët vendas dhe ato të vendeve fqinje. Kushtet e terrenit kanë zhvilluar mundësinë e krijimit të burimeve natyrore gjeotermale, të cilat përbëjnë një ndër asetet më të rëndësishme të bashkisë e më gjerë, rrethit e parkut, duke shërbyer si një pikë e rëndësishme për të gjithë Shqipërinë.

Shumë qytetarë nga e gjithë Dibra, por edhe nga rrethe të tjera të vendit vijnë çdo vit në Peshkopi për të qëndruar 10-15 ditë në banjot e llixhave të Peshkopisë. Numri i tyre shkon deri në 6000, ku mbi 500 janë të ardhur nga jashtë Shqipërisë, kryesisht Maqedonia. Ky lloj turizmi, i quajtur turizëm kurativ është një mundësi e mirë për bashkinë dhe vetë qytetarët në rritjen e të ardhurave lokale. Burimi i ujërave termale i ka dhënë emrin edhe lagjes ku ndodhet ky burim. Kështu lagjja e Llixhave, e krijuar kryesisht nga banorë të ardhur pas viteve 90 është edhe lagjja më problematike për sa i takon infrastrukturës.

10.2 Zonat e mbrojtura natyrore

Zonat e mbrojtura të parkut Korab-Korritnik, Parkut të Lurës dhe 41 Monumentet e natyrës janë një pasuri atraktive dhe e rrallë në territorin e Dibrës. Malet, livadhet dhe kullotat alpine në këto zona janë një pasuri me potenciale të mëdha dhe resurse natyrore. Më të njohur janë Mali i Korabit, Mali i Kërcinit, Mali i Valivarit, Mali i Skërtecit, Mali i Gramës, Mali i Bardhë, që janë pjesë e Parkut Natyror Korab-Korritnik dhe malet e Lurës, Kurora e Lurës, Krej-Lura, Draj-Lura, Runja, Deja, Prati, që janë pjesë e Parkut Kombëtar të Lurës. Këto bukuri të rralla plotësohen edhe nga bjeshkët e mrekullueshme, si Bjeshka e Zonjave, Gropa e Panairëve, Bjeshka e Shehut, e Hynoskës, livadhet e Skërtecit në Parkun Natyror Korab-Korritnik dhe Livadhi i Gjatë, Fusha e Pelave, Fushë-Lura, Palgjait në Parkun e Lurës, etj. Turistët tërhiqen shumë nga këto peizazhe, nga ajri i pastër, shumëllojshmëria e botës bimore, uji i pastër dhe i ftohtë, apo edhe sportet dimërore, si gjuetia apo alpinizmi.

10.3 Zonat arkeologjike dhe historike

Dibra është një zonë e pasur në vlera historike. Historia e saj lidhet me kufirin natyror të Romës me Bizantin, që është lumi Drin i Zi dhe aktualisht, akoma e pastudiuar. E veçanta e Dibrës lidhet me vendlindjen e Skënderbeut, fshati Sinë i Çidhnës, ku gjendet edhe kalaja e Skënderbeut. Aty gjenden edhe shumë toponime, vende dhe ngjarje historike, që lidhen me jetën dhe historinë e Skënderbeut, si dhe faljen e Kastriotëve.

Me shumë interes janë rrënojat dhe gërmimet arkeologjike të paeksploruara, si Kalaja e Grezhdanit, që ka qenë edhe kalaja më e madhe në Ballkan, kishat në Gradishtë të Peshkopisë, kalaja e Çetushit dhe një sërë monumentesh të tjera historike, të përmendura në inventarin e monumenteve të kulturës.

11. Analiza e përdorimit ekzistues të tokës

11.1 Karakteristikat e tokës

Shtrirja e territorit nga 310m deri në lartësi të Korabit ka bërë që në të të gjejmë shumë breza dhe nënbreza tokash. Kjo shtrirje ndikon drejtpërdrejt në bimësinë e zonës. Larmia e kushteve natyrore pedogjenetike ka favorizuar edhe shumëllojshmërinë e tokave. Në këtë drejtim dallohen:

- *Tokat e kafenjta* - kanë shtrirje jo të madhe dhe zënë 30% të territorit të zones, shtrihen në lartësitë 600-1000 m mbi nivelin e detit, sidomos në pjesën veriore përgjatë luginave. Tokat e kafenjta (që ndryshe quhen toka pyjore) krijohen në shkëmbinj të thatë dhe silicate, që takohen kryesisht në zonat ku gjenden edhe burimet e ujërave minerale.
- *Tokat e murrme pyjore* - ose të pyjeve të ahut e të pishës, që shtrihen në lartësitë 1,000-1,200 m mbi nivelin e detit, duke zënë kështu pjesën më të madhe të kësaj malësie, rreth 40%. Ato i gjejmë të përhapura në pjesën qendrore, jugore dhe atë lindore.
- *Tokat livadhore-malore* - këto toka zënë 30 % të territorit të kësaj malësie dhe shtrihen në lartësitë mbi 1,700 m mbi nivelin e detit. Ato i gjejmë të përhapura në lindje të zonës. Formohen mbi struktura gëlqerore, në kushtet e një klime të ashpër dhe me reshje, kurse relievi i tyre është heterogjen dhe dallohet për copëtimin dhe pjerrësinë e madhe.

11.2 Përdorimi i tokës

Toka në Dibër është e ndarë në: tokë arë 25%, pyje 46%, kullota 17%, pemë frutore 2%, vreshta 1%, tokë e papërdorur 2% dhe tokë e refuzuar (vakufe) 8%. Sipërfaqja e tokës me pyje zë pjesën më të madhe të territorit, me afro 46% dhe bashkë me kullotat, ajo zë 63% të territorit. Më pak sipërfaqe zënë pemëtoret dhe vreshtaria, 1-2%. Kjo e dhënë më shumë u referohet sipërfaqeve ekzistuese.




Figura 19: Përdorimi i tokës në territorin e Dibrës (Të dhëna nga Drejtoria e Bujqësisë)

Nr	Sip. Gjith.	Tokë arë	Pemë Frutore	Vresh ta	Pyje	Kullota	Tokë e papërdorur	Tokë e refuzuar
1	66209	18436	1165	51	34193	12898	1805	5726

Tabela: Të dhënat statistikore të sipërfaqes së tokës në Dibër.

Toka bujqësore arë zë 25% të sipërfaqes dhe për momentin punohet dhe mbillet me drithëra buke, foragjere, pemë frutore, vreshtari, perime, patate, etj. Sipërfaqja më e madhe mbillet me foragjere dhe drithëra buke, kryesisht për nevojat e blegtorisë dhe të ekonomive familjare. Figura më poshtë jep strukturën e tokës arë të mbjellë me kultura të ndryshme.




Figura 20: Struktura e mbjelljes së tokës arë sipas kulturave bujqësore (Drejtoria e Bujqësisë)

Toka e refuzuar zë një sipërfaqe prej 7,531 ha, ose 11.5% (e refuzuar). Kjo sipërfaqe është tokë joproduktive dhe e pambjellë. Nga përbërja kjo tokë është shumë e përshtatshme për t'u mbjellë me arrore, ose gështenja.

Mungesa e ujit vaditës të sipërfaqeve të tokës më e dukshme është në Maqellarë, Kastriot dhe territore të tjera. Pengesa kryesore është sistemi vaditës primitiv dhe rrjeti i kanaleve vaditëse, krejt i amortizuar. Gjatë viteve 1999-2002 pati ndërhyrje për rehabilitimin e kanaleve vaditëse nga projekti IFAD2, por akoma nuk janë bërë ndërhyrje në zonën e Dibrës nga programi i ujitjes me pika, zbatuar nga ministria e Bujqësisë. Struktura e tokës sipas mbulimit me vaditje është:




Figura 21: Struktura e tokës së ujitur (Të dhëna nga Drejtoria e Bujqësisë)

12. Analiza e periferialitetit

Në thelb treguesi i periferisë së territorit mund të interpretohet si një funksion i anasjelltë i aksesueshmërisë. Pra, sa më i lartë treguesi i aksesit, aq më i ulët është ai i të qenit periferik. Në legjislacionin shqiptar nuk ka kriteret për të përcaktuar shkallën e aksesueshmërisë së një territori. Për këtë arsye, në këtë studim janë përdorur kriteret e mëposhtme për të përcaktuar aksesueshmërinë/periferialitetin e Peshkopisë:

- aksesit në infrastrukturën rrugore
- aksesit në infrastrukturën inxhinierike
- aksesit në shërbimet sociale
- informaliteti i pronësisë
- shkalla e varfërisë
- kriminaliteti

Këto kriteret janë analizuar nga 1 në 5, ku 1 është faktori më pozitiv dhe 5 më negativ.

Aksesi në infrastrukturën rrugore	Aksesi në infrastrukturën inxhinierike	Aksesi në shërbimet sociale	Informaliteti i pronësisë	Shkalla e varfërisë	Kriminaliteti	Mesatarja
5	4	4	3	4	2	3.6

Tabela: Vlerësimi i periferialitetit

Në përfundim, duke analizuar edhe pozicionin e Dibrës në territorin e Shqipërisë rezultoi që, edhe pse ka një pozicion kryesor - pranë qendrës rajonale - me akseset të infrastrukturës rrugore kombëtare dhe interurbane, ajo përsëri është në gjendje shumë të keqe. Fshatra të caktuara vuajnë mungesa të theksuara infrastrukturore dhe shërbimesh sociale.

Kjo ka bërë që sot të kemi një vlerësim negativ të periferialitetit. Ajo që bie në sy në Dibër është niveli i ulët i kriminalitetit, si pasojë e marrëdhënieve, kulturës dibrane dhe homogjenitetit të popullsisë.

Kapitulli III: Ndarja e territorit sipas sistemeve bazë

1. Sistemet bazë

Njësitë bashkiake, për qëllime planifikimi ndahen në pesë sisteme territoriale: sistemi urban (UB), sistemi natyror (N), sistemi bujqësor (B), sistemi ujor (U) dhe sistemi infrastrukturor (IN).

Me ligjin e ri të urbanistikës, standardet e planifikimit ndryshojnë sipas numrit të popullsisë në territoret urbane. Këto territore kategorizohen, sipas rastit, në tri grupe kryesore: deri në 10,000 banorë, mbi 10,000 banorë dhe mbi 100,000 banorë. Dibra përfshihet në zonën e dytë, me mbi 10,000 banorë. Në këtë kapitull nuk do të japim të dhëna të detajuara, pasi ato janë dhënë në kapitujt e mësipërm dhe për më shumë, studioja që do të merret me PPV-në gjatë fazës së ardhshme do të bëjë një analizë profesionale më të thelluar.

1.1 Sistemi urban (UB)

Sistemi urban formohet nga bashkimi i territoreve urbane dhe kufizohet nga vija e gjelbër, ose vija e verdhë e dikurshme. Sipas ligjit të ri të urbanistikës, është përcaktuar ndarja në zona dhe në njësi.


Figura 22: Harta zhvillimit të sistemit urban

Kjo do të ndihmojë një planifikim më të mirë urban.

Sipërfaqja totale e bashkisë është 1001 km². Duke iu referuar të dhënave, të mbledhura deri tani, për popullsinë dhe sipërfaqen e territorit nën administrimin e bashkisë, llogaritet që dendësia të jetë $Db = \frac{78940}{1001} = 78.82$ banorë/km².

Territori urban i zonave të banuara përbëhet nga qyteti i

Peshkopisë dhe 141 fshatra, që gjenden në territorin e 14-të Njësi Administrative dhe përkojnë me ish-komunat. Pjesën më të madhe të këtij territori e zënë sipërfaqet për përdorim “banimi” - banesa private, 1 dhe 2-katëshe, me oborre në zonat rurale dhe apartamente 3-5 katëshe më së shumti, por edhe më të larta në zonën urbane të Peshkopisë. Gjithsej në bashkinë e Dibrës gjenden 13,767 ndërtesa, nga të cilat, shtëpi banimi, 17,772. Aktualisht banohen 12,149 prej tyre dhe të pabanueshme janë 5,404 të tilla (INSTAT). Pra, siç shihet më shumë se 29% e banesave ekzistente nuk banohen. Kjo, për shkak të lëvizjes së popullsisë.



Nëse i referohemi hartës së kategorizimit të zonave sipas lartësisë mesatare, vihet re se ato variojnë:

1. Për zonën e urbanizuar urbane numri i kateve varion nga 1 deri në 11 kate. Përqendrimi maksimal i banesave 4-5-katëshe vihet re në lagjen Dobrovë, në Lagjen e Re, në lagjen “Gjokë Doçi”, etj.
2. Në zonën e urbanizuar rurale vihen re ndërtime masive me 1-2 kate.

Më poshtë jepen të dhënat rreth zonimit të funksioneve brenda territorit të bashkisë Dibër:

Kategoria baze	Nenzonat	Siperfaja ne ha
Zona banimi	Fshatrat	14469
	Dendesi e ulet para 90	0.6
	Dendesi e mesme para 90	1.2
Zona bujqesore	Toke bujqesore	19117
	Livadhe	11886
Zone shërbimesh	Rruge	10
	Fushe sporti	4
	Sociale	1
	Nenstacione	4
Zone industriale	Zona mikse	10
	Industriale	6
Zona natyrore	Pyje	53857
	Burime ujore	8
Zonat e perdorimet te veçante	Varrezat	710
	Minierat	16

Zonat e fshatrave

Dallohet një epërsi shtëpish për një familje, shtëpi 1-2 katëshe.

Pronësia mbi tokën është përgjithësisht e qartë.

Ka ndërtime të reja, kryesisht në zonat pranë zonave urbane.

Gjendja e objekteve nuk është e mirë, ka mungesë të hapësirave dhe shërbimeve publike.

Aksesi në shërbimet urbane është shumë i dobët.

Zona të urbanizuara me dendësi të ulët

Përzjerje strukturash të vjetra, përgjithësisht, banesa kolektive jo të larta.

Trojet janë me pronësi legale, kurse ndërtimet e reja përgjithësisht janë pa leje ndërtimi.

Rrugët janë lineare dhe ndjekin topografinë.

Akses relativisht i mirë në shërbimet publike (kanalizime të ligjshme për furnizimin me ujë, grumbullim i plehrave, etj). Zona me ish-banesa shtetërore me dendësi të mesme.

Bllloqe apartamentesh të ndërtuara nga shteti si shtëpi punëtorësh në periudhën mes viteve ‘45-‘80. Apartamentet janë privatizuar nga banorët. Cilësia e hapësirave publike është e dobët.

Akses relativisht i mirë në shërbimet publike (kanalizime të ligjshme për furnizimin me ujë, grumbullim i plehrave, etj).

Zona me ndërtime të larta

Aktualisht janë pesë ndërtime të larta në lagjen “Nazmi Rushiti” dhe “Gjokë Doçi” në qytet.

Trojet janë përgjithësisht me pronësi legale (pronarët kompensohen nga ndërtuesi).

Objektet kanë leje ndërtimi.

Këto objekte nuk përputhen plotësisht me rrethinat e tyre, që janë të degraduara dhe kanë nevojë për ndërhyrje, mungojnë hapësirat publike.

Zona të reja informale

Zonat e reja informale janë ndërtuar pas vitit 1990 dhe janë përqendruar në rrethinat e qytetit të Peshkopisë, në ish-zonën industriale, ish-zonën ushtarake, në ish-parkun e Llixhave, në tokat bujqësore të ish-Ndërmarrjes Bujqësore në Dobrovë dhe në zonën e Maqellarës, në qendër të saj dhe në aksin rrugor për në doganën e Bllatës. Këto janë ndërtime pa plan, pa kritere teknike dhe u mungon aksesimi në shërbimet publike.

1.2 Sistemi natyror

Sistemi natyror përbëhet nga peizazhet, hapësirat e paprekuara të natyrës, korridoret ekologjike dhe hapësirat, që kanë një kategori bazë të përdorimit, “natyrë” (N) dhe janë në përputhje me legjislacionin e posaçëm.


Tokat natyrore janë zona të rëndësishme për mjedisin dhe biodiversitetin. Këto, sipas kriterëve dhe ligjshmërisë janë zonat e mbrojtura dhe monumentet e natyrës, pyjet, dhe kullotat. Në Dibër ushtron veprimtarinë e saj edhe Agjencia e Zonave të Mbrojtura, struktura përgjegjëse për menaxhimin e këtyre aseteve dhe ku NJQV-ja është pjesë e bordit dhe strukturave menaxheriale dhe vendimmarrëse të kësaj agjencie.

Zonat e mbrojtura në Dibër janë të ndara sipas kategorive nga AZM-ja:

Kategoria	Emërtimi	Zona	Sipërfaqja/ha
II	Park Kombëtar	Parku Kombëtar i Lurës	1280 ha
IV	Park Natyror	Korab-Korritnik	20663 ha
VI	Peizazh i mbrojtur	Rezervati Luzni-Bulaç	5900 ha
Monumente natyre (41 monumente)	1. Shpella e Gurit të Kuq 2. Karsti i Malit të Bardhë 3. Burimi dhe Shpella e Sopanikës 4. Liqenet e Kacnisë 5. Pasqyrat e Gramës 6. Gropa e Panairit 7. Liqeni i Zi (mbi Radomirë) 8. Ujëvara e Pochtës, Maqellarë 9. Bjeshka e Zonjave, Zimur	15. Burimi i Kërçinit 16. Kroi i Mbretit, Serakol 17. Burimi termomineral i Llixhave të Peshkopisë 18. Liqeni i Luleve, Lurë 19. Liqeni i Zi, Lurë 20. Liqeni i Madh, Lurë 21. Hartinat e Lurës 22. Shllinasi 23. Guri i Kërçinit	29. Morenat e Fushë-Lurës 30. Cirku i Kurorës së Lurës; 31. Kodra e Parave Blliçe; 32. Fusha e Pelave – Lurë; 33. Rrapi i Kërçishtit; 34. Pisha e Blliçes; 35. Ahu i Blliçes;

10. Gryka e Setës (pjesa më e ngushtë dhe më e thellë)	24. Krasta e Pocestit	36. Lisi i Dobit;
11. Shpella e Rusit, Grykë-Nokë	25. Boroviku i Begjunecit	37. Vakufi i çangës;
12. Shpella e Qytezës	26. Burimet e Bellovës	38. Lisi Kabe;
13. Shpella e Akullit, Bulaç	27. Gryka e Madhe, Lurë	39. Vakufi i Sinës së Sipërme;
14. Burimi i Ujit të Ftohtë, Vleshë	28. Rrafshi i Korabit	40. Rrobulli i Lurës;
		41. Rrapi i Çidhnës

Tabela: Zonat e mbrojtura në Dibër (Të dhëna nga Agjencia e Zonave të Mbrojtura)



Zonat e mbrojtura, megjithëse mbrohen me ligj janë dëmtuar shumë gjatë viteve të fundit. Më e dëmtuara është zona e Parkut Kombëtar të Lurës, si dhe ajo Luzni-Bulaç. Zona e Parkut Korab-Koritnik është më e mbrojtur, por pak e promovuar për vlerat e saj turistike dhe studimore.

Figura 23: Zonat e mbrojtura dhe monumentet e natyres

1.3 Sistemi bujqësor

Sistemi bujqësor përbëhet nga toka bujqësore, e zënë me bimët e arrave, pemishtet, vreshtat dhe arrotet. Kudo ku ajo shtrihet ka si veçori thelbësore pjellorinë dhe kanalet, rezervuarët në shërbim të saj. Sistemi bujqësor formohet nga bashkimi i tokave me kategori bazë të përdorimit të tokës, “bujqësinë” (B).

Ky sistem është rezultat i ndërveprimit në kohë të aktiviteteve njerëzore për kultivimin dhe ndërtimet me karakter bujqësor në territor. Në Dibër kemi toka arë, toka pyjore, kullota, pemëtari dhe vreshtari. Para viteve 1990 sistemi bujqësor ka qenë i organizuar mirë, si në aspektin e territorit, ashtu edhe atë të ekonomisë, duke krijuar kështu profile të specializuara, sipas bonanitetit të tokës dhe prodhimtarisë. Pas viteve 1990 kemi një sistem bujqësor shumë të copëtuar në ngastra të vogla. Si pasojë janë krijuar vështirësi në zhvillimin e sektorit bujqësor dhe në investimet e infrastrukturës bujqësore duke ulur rendimentin. Sot kemi një ekonomi bujqësore tradicionale dhe primitive.

Toka fushore dhe kodrinore, e cila shtrihet përgjatë luginës së lumit Drin dhe luginave të përrenjve është shumë e mirë për drithërat e bukës dhe pemët frutore. Aty gjejmë mollë, kumbull, qershi dhe arroje. Ndërsa, pjesa e tokës malore zihet nga pyje dhe kullota. Këtu futen edhe ngastrat e pjerrëta, që janë të mira për pataten dhe sipërfaqet kullosore, të mira për bagëtitë e imëta.

Ministria e Bujqësisë dhe Drejtoria rajonale Dibër janë duke punuar që të bëjnë rajonalizimin e tokës bujqësore, e cila do të jetë një kontribut i madh për zhvillimin e bujqësisë në Dibër.

1.4 Sistemi ujq

Sistemi ujq përbëhet nga tërësia e burimeve nëntokësore dhe mbitokësore ujqore, si dhe përmban të gjithë trupat ujqorë, përfshi brigjet, sipas përcaktimeve të legjislacionit të posaçëm. Sistemi ujq formohet nga rrjeti me kategori bazë të përdorimit të tokës “ujë” (U) i sistemit urban. Përdorimi “ujëra”, me kod “U”, të gjithë trupat ujqorë, përfshi brigjet e përrenjve dhe lumenjve, sipas përcaktimeve të legjislacionit për ujërat.

Sistemi ujq në territorin e Dibrës përbëhet nga lumenj, përrenj, liqene dhe burime të tjera ujqore. Lumi Drin i Zi përshkon gjithë territorin. Në të derdhen të gjithë përrenjtë, të cilët janë malorë me pjerrësi të lartë (>30%) dhe sigurojnë një burim të mirë për energjinë hidrike dhe sasitë ujqitëse për bujqësinë.

Liqenet natyrore janë akullanajore dhe ndodhen në Malet e Lurës, Kacnisë, Gramës dhe Korabit. Ka edhe një sërë rezervuaresh artificiale për nevoja ujqitjeje (6 rezervuare).


Çështja më e nxehtë në zonën e Dibrës janë studimet dhe projektet për ndërtimin e Hidrocentralit të Skavicës mbi lumin Drin, për të cilin ka disa variante të hershme dhe të reja. Këto variante e shohin hidrocentralin nga këndvështrime dhe interesa të ndryshme: si rezervë hidrike për kaskadat e tjera mbi lumin Drin, ose thjesht si prodhues energjie. Kjo vepër do të ndikojë shumë në morfologjinë e territorit të Dibrës, në përmbytjen e një sipërfaqeje të madhe toke bujqësore, në shpërnguljen e banorëve, si dhe në tërësinë e komunikimit të të gjithë rajonit. Banorët dhe qytetarët e Dibrës nuk janë përfshirë në këtë diskutim dhe nuk ka projekte, apo studime transparente.

1.5 Sistemi infrastrukturor

Sistemi infrastrukturor përmban rrjetet kryesore të infrastrukturës në nivel kombëtar, nivel qarku dhe në nivel vendor. Sistemi infrastrukturor formohet nga rrjeti me kategori bazë të përdorimit të tokës “infrastrukturë” (IN). Përdorimi “infrastruktura”, me kod “IN” përfshin të gjitha pjesët e infrastrukturave për transportin, mbetjet e ngurta e të lëngshme, furnizimin me ujë, komunikimin elektronik, furnizimin me energji elektrike, mbrojtjen e tokës nga erozioni dhe rrëshqitja, si dhe mbrojtjen kundër zjarrit. Kjo, sipas legjislacionit të posaçëm.

Ashtu siç është përshkruar me detaje në kapitullin e infrastrukturës, në zërin “Analizë metabolike”, sistemi infrastrukturor në Dibër është më i vështiri.

Figura 24: Harta e zhvillimit sistemit te infrastrukturës



Dibra është bërë pjesë e planeve kombëtare për të qenë edhe ajo arterie e Korridorit të 8-të me ndërtimin e Rrugës së Arbrit, si dhe korridoreve të tjera energjitike. Në pjesën e brendshme, ajo ka rrugën Kukës-Peshkopi të asfaltuar, që është edhe pjesë e unazës rurale veriore, që e lidh me rrugën e Kombit dhe një sërë rrugësh rurale rajonale, si ajo e Lurës, që e lidh me Mirditën, rruga e Qafë-Murrës, që e lidh me Matin dhe pika kufitare e Bllatës, që e lidh me Maqedoninë.

Edhe sistemi i ujit të pijshëm dhe kanalizimeve është dhënë i detajuar në kapitullin e analizës metabolike, por theksojmë se ujësjellësit më të rëndësishëm janë ata rajonalë, që u shërbejnë disa qendrave të banuara, si: ujësjellësi i Peshkopisë, ujësjellësi i Sopanikës, ujësjellësi i Muhurrit, ujësjellësi i Ilnicës, ujësjellësi i Maqellarës, ujësjellësi i Selishtës. Në Peshkopi ndërmarrja e Ujësjellësit ka statusin SH.A.

2. Analiza e pikave të forta, pikave të dobëta, mundësive dhe rreziqeve

Analiza e detajuar për secilin sektor, duke u bazuar në pikat e forta, pikat e dobëta, mundësitë dhe rreziqet për secilin sistem është bërë në bashkëpunim me grupin e punës dhe grupet fokus. Nga kjo analizë kemi dalë me konkluzione, të cilat janë shfrytëzuar për zhvillimet e mëtejshme të sistemeve urbane, ujore, bujqësore, natyrore dhe infrastrukturore. Analiza më e detajuar për secilin sistem ndodhet në Aneksin 1, bashkangjitur këtij materiali.

3. Konkluzionet e pas analizës

Pas analizës dhe diskutimeve me grupet fokus të të dhënave dhe matricës së analizës SWOT, dalim në disa konkluzione, që lidhen me shumë elemente kyç dhe ndikojnë, si pozitivisht, ashtu edhe negativisht në zhvillimin e territorit të Dibrës.

Elementet kyç pozitive në sistemin urban:

Pozicioni i favorshëm gjeografik i krijon Dibrës mundësi për një bashkëpunim rajonal ndërkufitar me zonën e Maqedonisë, duke mundësuar aksesimin e fondeve të EU-së dhe rritur ndërveprimin ekonomik dhe social në nivel rajonal.

Qyteti i Peshkopisë dhe fshatrat janë zona kompakte, të hershme dhe të ndërtuara si qendra banimi. Aty ka elemente të duhura urbanistike, si: në banesa, shërbime dhe zona të zhvillimit ekonomik.

Në politikat kombëtare bashkia e Dibrës shihet si një qendër rajonale me aglomerim të ndërmjetëm, që avantazhohet nga prania e institucioneve shtetërore rajonale, si qendër Qarku dhe ku do të kalojë Korridori i 8-të. Mendohet se do të ndërtohet Rruga e Arbrit, duke e bërë kështu këtë zonë lehtësisht të aksesueshme në korridoret e transporteve shpërndarëse të energjisë dhe korridoret natyrore.

Elementet kyç negative në sistemin urban:

Presioni i lartë i ndërtimeve në qytet, mungesa e planeve të zhvillimit, mungesa e hapësirave publike, parregullsia në ndërtim, pastërtia e dobët, mungesa e parqeve dhe ambienteve çlodhëse, jeta e varfër artistike dhe sportive, cilësia e dobët e shërbimeve, të gjitha këto kanë bërë që banorët të mos jenë të kënaqur me qytetin e tyre.

Lëvizja e madhe demografike nga Dibra drejt Tiranës dhe Durrësit, si dhe nga zonat rurale drejt zonës urbane të Peshkopisë është shoqëruar me efekte negative sociale, si: papunësi, konflikte social-kulturore dhe braktisje të shumë banesave në fshat. Ky fenomen ka sjellë si pasojë pasjen e fshatrave me pak familje dhe ndërtime pa kriter në Peshkopi, trafik, mjedis jo i shëndetshëm për banim.

Mungesa e arsimit profesional, mbyllja e universitetit, cilësia e dobët e infrastrukturës shkollore dhe shëndetësore ka detyruar shumë familje dibrane që fëmijët t'i çojnë në qytete të tjera, me kosto shpenzimesh më të larta dhe me rrezikun e moskthimit në zonën e Dibrës. Kjo gjë ndikon negativisht në të ardhurat e familjeve, në ekzistencën e fuqisë punëtore të pakualifikuar dhe një rinie përherë në ikje.

Rekomandime për ndërhyrje në sistemin urban:

Të ndërhyhet me plan dhe studim në përmirësimin e zonës urbane të qytetit të Peshkopisë, në të gjitha elementet e tij, duke zbatuar standardet teknike dhe duke bashkëpunuar ngushtë me qytetarët, si pronarët e vërtetë të qytetit.

Të ndërhyhet në vitalizimin e fshatrave, duke përmirësuar shërbimet publike dhe duke promovuar modelet pozitive të familjeve, apo fshatrave në Dibër, që janë të suksesshme.

Të punohet dhe ndërhyhet në përmirësimin e sistemit edukativ dhe shëndetësor për qytetarët e Dibrës, duke u fokusuar në aftësimin dhe edukimin e të rinjve me profesione, që i përshtaten

tregut të punës. Që kjo të ndodhë duhet lobuar shumë për hapjen në Dibër të një qendre të formimit profesional dhe të një universiteti me profil agrar.

Elementet kyç pozitive në sistemin infrastrukturor:

Financimet e Fondit Shqiptar të Zhvillimit kanë përmirësuar sistemin rrugor të disa fshatrave dhe rrugën Dibër-Kukës, e cila ka krijuar akses të mirë për një zonë të madhe, që shtrihet nga Kalaja e Dodës deri në Peshkopi.

Ndërrhyrje pozitive po bëhen në sistemin e ujësjellësit të Peshkopisë, si në rrjetin e furnizimit, shpërndarjes dhe menaxhimit. Ky i fundit do të shërbejë si një model i mirë për menaxhimin e ujësjellësit në gjithë Dibrën. Investim i ri po bëhet edhe në ujësjellësin e Sapanikës, nga i cili përfiton një zonë e madhe.

Elementet kyç negative në sistemin infrastrukturor:

Infrastruktura e munguar rrugore, aksesit i vështirë në sistemin e transportit kombëtar dhe rajonal, për shkak të rrugës së keqe, është edhe elementi kyç më negativ që pengon zhvillimin e zonës së Dibrës.

Zona të tëra rurale nuk kanë rrugë të asfaltuara. Në të shumtën e rasteve këto rrugë bëhen të pakalueshme, sidomos në kohë të keqe. Përmendim Lurën, Selishtën, Zimurin, Cerjanin, Zagradin, etj.

Shërbimet e dobëta publike, si furnizimi me ujë të pijshëm, menaxhimi i mbetjeve, trajtimi dhe sistemimi i ujërave të zeza, mungesa e parkingjeve dhe stacioneve të transportit, keqpërdorimi i burimeve të energjisë janë disa nga elementet që e vështirësojnë jetesën e banorëve të Dibrës.

Rekomandime për ndërrhyrje në sistemin urban:

Ndërtimi i Rrugës së Arbrit është zgjidhja e vetme për aksesimin e Dibrës në korridoret dhe qendrat e zhvilluara kombëtare dhe rajonale.

Të ndërhyhet në rehabilitimin e infrastrukturës rrugore të brendshme, si në qytet, ashtu edhe në fshat, sidomos në ato fshatra që kanë distanca të shkurtra nga qyteti. Të ndërhyhet gjithashtu edhe në rregullimin e rrugëve rajonale, që u shërbejnë shumë zonave të banuara.

Të ndërhyhet në përmirësimin e transportit, atij të brendshëm dhe atij që e lidh me Tiranën, duke mirëpërcaktuar dhe shtrirë në kohë shërbimin dhe vendet e stacioneve nisëse.

Të ndërhyhet në përmirësimin e shërbimeve publike, si për zonën rurale, ashtu edhe atë urbane: shërbim cilësor të ujit të pijshëm, sistem kanalesh të zeza dhe shërbime të tjera.

Elementet kyç pozitive në sistemin natyror:

Dibra ka si elemente kyç pozitive pasuritë e shumta natyrore: tokën, pyjet, minierat, ujërat, që favorizojnë zhvillimin ekonomik. Këto pasuri i mundësojnë asaj të jetë konkurruese në turizmin balnear dhe atë malor, në bujqësinë moderne dhe atë organike, në nxjerrjen e mineraleve, sidomos gipsit, kromit, mermerëve dhe në shfrytëzimin e pasurive hidrike për energji të pastër.

Vlerat e pasura historike dhe natyrore, me specificitetin e tyre e bëjnë Dibrën unikale dhe të veçantë. Mali i Korabit, më i larti në Shqipëri, ujërat termale kurative, më të mirat në Ballkan, liqenet e shumta akullnajore, vendlindja e Skënderbeut, heroit tonë kombëtar, rrënojat arkeologjike dhe monumentet e kulturës janë resurse për zhvillimin e turizmit.

Elementet kyç negative në sistemin natyror:

Keqmenaxhimi i burimeve natyrore, prerja e pyjeve, dëmtimi i florës dhe faunës, mosadministrimi i ujërave, djegia e pyjeve janë disa nga faktorët që kanë ndikuar negativisht në dëmtimin e mjedisit.

Erozioni i lartë i tokës. Dëmtimi i pyjeve dhe i bimësisë, si dhe djegia e tyre kanë shkatërruar sipërfaqe të tëra me pyje dhe bimësi, duke rritur kështu erozionin dhe dëmtuar natyrën. Janë shkatërruar gjithashtu edhe sipërfaqe të tëra toke.

Rekomandime për ndërhyrje në sistemin urban:

Të shtohet sipërfaqja e mbrojtur, sidomos në pjesën e Lurës dhe Selishtës, duke përfshirë territore më të mëdha, qendra të banuara, të cilat do të jenë përfitueset direkte të kësaj natyre të mbrojtur.

Të merren masa për ndërhyrje në pyllëzime te reja; të sistemohen dhe të mbrohen pyjet, bimësia aktuale e të mirëmenaxhohen këto sipërfaqe të gjelbra.

Elementet kyç pozitive në sistemin bujqësor:

Imazhi pozitiv i produkteve bujqësore dibrane ka një avantazh goxha konkurrues në tregun kombëtar. Gjithashtu, fuqia e madhe punëtore, e aftë për punë, dhe dëshira për zhvillim janë elemente kyç pozitive për ecjen përpara të bujqësisë.

Skemat e reja të subvencioneve në bujqësi dhe kthimi i vëmendjes së popullsisë drejt investimeve në këtë sektor, kanë krijuar modele dhe premisa pozitive të zhvillimit të këtij sektori.

Elementet kyç negative në sistemin bujqësor:

Aksesi i vështirë i prodhimeve dibrane në tregjet kombëtare dhe rajonale është pasojë e mungesës së konkurrueshmërisë me sasi prodhimi dhe kosto të lartë. Kjo kosto rritet nga një

sërë faktorësh, si: sipërfaqja e vogël e fermave, rendimenti i ulët, mungesa e subvencioneve, mungesa e pikave të grumbullimit dhe ruajtjes, mungesa e bashkëpunimit mes fermerëve, mungesa e kapaciteteve dhe mbështetjes institucionale për aksesimin e fondeve, etj. Këta faktorë pengojnë dukshëm zhvillimin e bujqësisë.

Mungesa e rajonalizimit të tokës, e modeleve të reja të ekonomisë fermere dhe modeleve të bashkëpunimit për të dalë në treg e kanë bërë gjithmonë e më të vështirë zhvillimin e këtij sektori.

Mungesa e markës “Prodhime Dibre” ka shërbyer si mundësi për abuzim dhe spekulim me imazhin pozitiv të produkteve të Dibrës.

Mungesa e një infrastrukture mbështetëse moderne ka influencuar në rendimentin e ulët të prodhimit dhe koston e lartë të tij, duke e bërë kështu jokonkurrues në treg.

Rekomandime për ndërhyrje në sistemin bujqësor:

Të rritet sasia e prodhimit dhe cilësia e tij, duke rritur rendimentin dhe duke e profilizuar: prodhime të kërkuara nga tregu dhe me normë fitimi të lartë, siç janë pemëtaria dhe blegtoaria.

Të nxitet bashkëpunimi mes fermerëve për të krijuar SHBB, grupe prodhuese dhe pika grumbullimi, të cilat rrisin normën e fitimit dhe shtojnë konkurrueshmërinë në treg.

Të kërkohet që të fillojë një studim dhe plan veprimi për implementimin e një infrastrukture bujqësore moderne, si në ujitje, ashtu edhe në drejtimet e tjera. Kjo praktikë pune ka një ndikim të drejtpërdrejtë në rendimentin dhe normën e fitimit.

Të punohet për nxjerrjen e certifikatës “Prodhime Dibre”, e cila mbron dhe siguron avantazh konkurrues të prodhimit vendas.

Kapitulli IV: Drejtimet e zhvillimit të territorit në bazë të treguesve të sistemeve

1. Zhvillimi i sistemit urban

Zhvillimin e sistemit urban e shikojmë të lidhur ngushtë me zhvillimin në:

(A) Zonën e qytetit të Peshkopisë dhe

(B) Zonën rurale, e cila korrespondon me territorin në 141 fshatra, pjesë të 14 Njërive Administrative.

A) Ndërhyrja për zhvillimin urban të qytetit të Peshkopisë synon të rigjenerojë territorin ekzistues të qytetit dhe të përmbushë nevojat për rritje dhe zhvillim të tij deri në vitin 2030 e më tej, duke siguruar furnizimin me infrastrukturën e nevojshme për zonat e banuara, hapësirat dhe zhvillimin e biznesit e të industrisë. Kjo ndërhyrje konsiston në:

- Sistemimin e vlerave të mira urbane dhe peizazhit të qytetit, si: sheshet, rrugët, rrugicat, trotualet, fasadat dhe hapësirat në blloqet e banimit, ndriçimin, etj. Ndërhyrje do të bëhen në bulevardin kryesor duke e rregulluar si shëtitore dhe duke e zgjatur. Gjithashtu do të bëhet rregullimi i bulevardit dhe sheshit në lagjen Pazar, ose “Bajram Curri”, i rrugicave dhe shkallëve, rikualifikimi i fasadave dhe i blloqeve të banimit në të pesë lagjet e qytetit, duke pilotuar shembuj pozitivë, vepra arti, etj.
- Zhvillimin e zonave të reja të qytetit, si: ndërhyrja për urbanizimin dhe përmirësimin e shërbimeve në zonat informale, studimi dhe përcaktimi i zonave të reja për banim (përgjatë unazës së re të qytetit në Dobrovë dhe ish-ndërmarrjes “Rruga-Ura”), zhvillimi i zonës ekonomike dhe industriale përgjatë unazës së re dhe aksit Tomin-Kuben, ndërtimi i terminalit urban dhe pesë shesheve të vegjël në lagjet kryesore, etj.
- Ruajtjen dhe nxjerrjen në pah të vlerave estetike dhe historike të zonave që kanë impakt pozitiv në zhvillimin e qytetit, si: lagjja “Teqe”, lagjja “Treg”, “Kallavere”, etj. Do të ndërhyhet në rikonstruksionin e banesave të vjetra, rrugicave, fasadave dhe çatave karakteristike, si dhe objekteve fetare të këtyre lagjeve.
- Krijimin e parqeve rikreative te Lugina e Shërimit/Përroi i llixhave, duke promovuar shtigjet për ecje në natyrë, ambiente pushuese dhe çlodhëse, ambiente sportive dhe parkun arkeologjik të kishave të vjetra në kodrën e Gradishtës.

B) Ndërhyrja për zhvillimin urban të zonës rurale synon të rivitalizojë territorin ekzistues të fshatrave dhe qendrave krahinore, që korrespondojnë me qendrat e Njërive Administrative. Kjo ndërhyrje konsiston në:

1. Krijimin e një sistemi rrugor dhe shërbimi transporti cilësor, që afron komunitetet rurale me qendrën urbane, duke asfaltuar rrugët që i lidhin ato me rrugën nacionale. Prioritet do të kenë fshatrat që gjenden 1-2 km larg këtyre akseve. Do të përmirësohen gjithashtu edhe shërbimet publike në fshat, si furnizimi me ujë të pijshëm, pastrimi, shërbimi shëndetësor, arsimit, me qëllim që t’u përgjigjet kënaqshëm nevojave të banorëve të zonës rurale.
2. Rikualifikimin e urbanistikës së fshatrave duke ruajtur arkitekturën tradicionale me elemente tipike rurale, duke ndërhyrë në rregullimin e shesheve dhe qendrave të

krahinave dhe fshatrave të mëdha, me vepra simbolike arti, që prekin krenarinë lokale, duke bashkëpunuar me komunitetin, si në realizim, ashtu edhe në bashkëfinancim.

3. Zhvillimin e zonës së Maqellarës, ku është ndërhyrë me ndërtime të reja të palegalizuara, për të sistemuar dhe ofruar shërbimet e duhura publike.

2. Zhvillimi i sistemit të infrastrukturës


Infrastruktura është faktori kyç i zhvillimit të territorit të bashkisë Dibër. Ky zhvillim konsiston në rritjen e aksesueshmërisë së territorit me rrugë, korridore dhe shërbime të tjera infrastrukturore, me qendra kombëtare dhe rajonale. Projektet dhe ndërhyrjet kryesore janë:

- Ndërtimi i Rrugës së Arbrit, që shkurton rrugën ekzistuese nga 180 km në 80 km dhe krijon të gjitha lehtësirat, në mënyrë që territori i Dibrës të ketë akses të plotë në porte, aeroporte dhe tregje kryesore, duke u bërë pjesë e Korridorit 8.
- Ndërtimi i infrastrukturës rrugore të brendshme, që krijon akses dhe zhvillim të zonës. Më kryesorja është:
 - o Unaza e qytetit të Peshkopisë
 - o Rrugët rajonale që lidhin qytetin me disa fshatra dhe zona potenciale turistike, si: Kastriot-Lurë, Muhurr-Selishtë, Peshkopi-Zimur dhe Peshkopi-Rabdisht.
- Përmirësimi i furnizimit me ujë të pijshëm, duke vazhduar me investimet e mira aktuale në ujtësjellësin e Peshkopisë dhe atë të Sopanikës.

3. Zhvillimi i sistemit bujqësor

Sistemi bujqësor është sistemi kryesor në territorin e Dibrës. Aty shënohet numri më i lartë i të punësuarve dhe falë tij jeton pjesa më e madhe e popullsisë, 75%. Zhvillimi i këtij sistemi lidhet ngushtë me zhvillimin e turizmit, i cili shfrytëzon potencialet e resurseve natyrore balneare dhe malore.

Zhvillimi i sistemit bujqësor bazohet në zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë. Pjesa më e madhe e sipërfaqes së tokës në Dibër, 63% e saj, është e zënë nga pyje dhe kullota, të favorshme për zhvillimin e blegtorisë. Pjesa e tokës arë ka si destinacion final mbjelljen me foragjere, 52% e saj dhe shkon si ushqim për blegtorinë. Kjo i jep Dibrës një karakter më shumë blegtoral dhe e drejton për nga zhvillimi i frutikulturës, që megjithëse ka një sipërfaqe të vogël, rreth 70% e sasisë së prodhimit ka destinacion tregun. Shoqërohet edhe me një normë fitimi më të lartë.



Nisur nga ky profil, zhvillimi i këtij sistemi konsiston në:

- Zhvillimin e blegtorisë, kryesisht në zonën malore dhe kodrinore, me orientim drejt bagëtive të imëta, duke shtuar numrin e korrësive dhe rritur prodhimtarinë. Për zonën e vargmalit Deshat-Korab duhen më shumë dele, sepse ka më shumë kullota alpine dhe për zonën e malësisë Reç-Lurë-Selishtë, më shumë nevojiten dhitë, pasi bimësia është më e vaforshme. Rritja e sasisë së prodhimit ndihmon ekonominë e përpunimit të qumështit dhe ngritjen baxhove të reja.

Figura 25: Harta e zhvillimit të sistemit bujqësor

- Zhvillimin e bujqësisë me profil pemëtarinë, duke shtuar sipërfaqet e mbjella me dru frutorë, si: mollë, qershi, kumbull dhe arrore në zonat fushore dhe kodrinore. Kështu i jepet një vlerë e shtuar sipërfaqes aktuale, kryesisht asaj që mbillet me foragjere dhe tokës së refuzuar, joproductive, por të përshtatshme për arrore. Shtimi i sasisë së prodhimit ndikon në rritjen e sektorit të agropërpunimit të frutave.
- Diversifikimin e ekonomisë rurale duke nxitur zhvillimin e turizmit balnear dhe malor në Dibër. Zhvillimi i turizmit konsiston në zonat ku resurset natyrore janë të favorshme dhe sjellin një zhvillim të ndërthurur me sektorët e tjerë. Në territorin e Dibrës korridoret kryesore të zhvillimit të turizmit janë:
 - o Korridori i Lurës ose Malësisë, që ka si element kyç zonën e Lurës dhe vazhdon me grykën e Setës (Arrasin), grykën e Murës (Selishtën dhe Muhurrin) dhe ndihmohet nga ekonomia rurale e Reçit dhe Dardhës. Ky korridor pasurohet edhe me vlerat historike të vendlindjes së Skënderbeut në Sinë dhe festat tradicionale të Shën-Kollit dhe Shën-Gjergjit.
 - o Korridori i Korabit, që ka si element kyç malin e Korabit dhe bjeshkët tij, dhe përmbledh më shumë fshatrat e Kalasë së Dodës dhe Sllövën. Vlerat tradicionale, kulinaria, vlerat historike dhe religjioze të teqesë së “Bilbilit” në Vleshë e pasurojnë zonën.

- Korridori Gramë-Kastriot me vlera të pasura natyrore, me bjeshkën e Zonjave në Gramë, liqenin dhe traditën e pasur të zonës i japin diversifikim ekonomikë bujqësore dhe blegtorale në fshatrat e Fushë-Çidhnës dhe Kastriotit duke nxitur një agroturizëm të veçantë.
- Korridori i Luginës së Shërimit me vlerat kurative të burimeve termale të llixhave, i harmonizuar me turizmin malor në bjeshkët e Skërtecit, Zimurit dhe Hinorskës, dhe me ekonominë bujqësore të fshatrave përreth Peshkopisë, fuqizon ekonominë në këtë qytet.
- Korridori i Fushës së Shehrit/Maqellarës me vlerat natyrore të Malit të Kërcinit dhe Velivarit, që pasurohet me vlerat historike të Kalasë së Grezhdanit dhe monumenteve të tjera, me mundësi për agroturizëm, me vlera në kulinari, kulturë, traditë dhe me ndikim e ndërveprim me Dibrën e Madhe dhe Bulqizën.

4. Zhvillimi i sistemit natyror

Zhvillimi i sistemit natyror konsiston në tre drejtime kryesore, të cilat lidhen me zonat e mbrojtura, shtimin e sipërfaqeve të pyllëzuara dhe menaxhimin e mirë të mbetjeve “Dibra e pastër”.

- Shtimi i sipërfaqeve të mbrojtura, Reç-Mali i Bardhë, kryesisht lidhet me pjesën e vargmaleve të Lurës dhe Selishtës. Vargmali i Korabit është pjesë e parkut natyror Korab-Korritnik dhe është në gjendje më të mirë. Pjesa e Parkut Kombëtar të Lurës është shumë e dëmtuar dhe e shfrytëzuar keq. Kjo, për një sërë shkaqesh, por vlen të theksohet një shkak jo më pak vendimtar: komuniteti ndihet jopërfitues dhe pronar i kësaj zone. Përfshirja e gjithë masivit Reç-Mali i Bardhë në zonat e mbrojtura, sipas kriterëve të IUNCN-së krijon një korridor të madh natyror. Në këtë korridor qendrat e banuara, popullsia dhe ekonomia janë të lidhura ngushtë me territorin.
- Shtimi i sipërfaqeve të rehabilituara me pyje bëhet duke ndërhyrë me mbjellje të reja, rehabilitime natyrore dhe mbrojtje-pastrim në zonat më kritike. Kështu, parashikohen pyllëzime të reja në pyjet e larta të Lurës, Kacnisë, Buflës, Pratit dhe shtim i bimësisë dhe sipërfaqes pyjore në zonën e parkut Korab-Korritnik, me mbjellje me akacie, dushk dhe rigjenerim natyral të bimësisë.
- Përmirësimi i pastrimit dhe menaxhimit të mbetjeve “Dibra e pastër”, duke mbuluar me shërbim gjithë territorin e Dibrës, duke kryer një cikël të plotë menaxhimi, sipas standardeve dhe duke parashikuar ndërtimin e një fushe të re dekompozimi në përroin e Kubenit.

5. Zhvillimi i sistemit ujq

Zhvillimi i sistemit ujq në territorin e Dibrës bazohet te burimet ujqore të shumta, si nëntokësore, ashtu edhe ato sipërfaqësore. Nuk ka liqene të mëdhenj, apo det. Ky zhvillim bazohet në dy aspekte:

- Lumi Drini i Zi është lumi që përshkon gjithë territorin e Dibrës. Ndërtimi i hidrocentralit të Skavicës është çështja kryesore që lidhet me këtë sistem ujq, e që ka ndikim të madh në territorin e Dibrës. Sipas studimeve të deritanishme, të papërfunduara dhe jozyrtare, të shprehura vetëm në dokumente parashikuese/parastudime, janë dhënë dy variante të hidrocentralit:
 - o Varianti i parë, ai i viteve të komunizmit parashikon një vepër ujëmbledhëse të madhe, me sipërfaqe 100km² dhe me gjatësi 90km. Kjo vepër do të ndikojë në morfologjinë e territorit, pasi një sipërfaqe e madhe toke mbulohet me ujë dhe territoret nuk kanë tërësi dhe aksesueshmëri me njëra-tjetrën.
 - o Varianti i dytë, ai që lidhet me ndërtimin e vetëm një dige në Katund të Ri, ka një gjatësi prej afro 15km dhe një sipërfaqe më të vogël. Zbatimi i këtij varianti do të përmbyste afro 4 fshatra dhe nuk ndikon në tërësinë e territorit të Dibrës.
- Përrenjtë kanë vlera hidrike të rëndësishme për HEC-e të vegjël, sezonalë, që shfrytëzohen në kohën e vjeshtës, dimrit dhe pranverës. Kjo paraqet avantazhe konkurruese për zonën, pasi e vë mjedisin në shërbim të turizmit, si dhe shoqërohet me efekte sociale e mjedisore.

Kapitulli V: Vizioni i zhvillimit të territorit të njësisë vendore

1. Deklarata e vizionit

Motoja për zonën e Dibrës është: “Ne do ta bëjmë Dibrën një zonë të begatë për të jetuar, punuar dhe vizituar”.

Deklarata e vizionit është që në vitin 2030, Dibra dhe dibranët të kenë një zhvillim të qëndrueshëm, të begatë, të sigurtë, të shëndetshëm dhe të prekshëm nga të gjithë. Banorët e Dibrës, nga të gjitha anët dhe shtresat shoqërore do të kenë të siguruar një akses të plotë me shërbime publike, mundësi më të mëdha punësimi dhe kushte cilësore banimi. Atraksionet e shumta natyrore dhe historike do të shfrytëzohen me eficiencë të plotë, duke bërë të lulëzojë ekonomia agrare, bizneset dhe qendrat turistike.

Slogani: “Dibra miqësore”. Pse miqësore? Sepse në Dibër thuhet, “që të jesh miqësor duhet”:

- të dish të presësh dhe të përcjellësh, të kesh dhe të shërbesh. Dibra dhe dibranët i plotësojnë këto kushte.

Çështjet kryesore, mbi të cilat bazohet zhvillimi i zonës së Dibrës janë: ekonomia, rigjenerimi i qytetit të Peshkopisë, rivitalizimi i fshatrave të Dibrës, çështjet për një komunitet të qëndrueshëm dhe çështjet e mjedist.

2. Orientimet tematike strategjike

2.1 Si Dibra, nuk ka tjetër! Urbanistikë dhe infrastrukturë të rilindur

“Dibra në vitin 2030 do të jetë një zonë e pëlqyeshme për banim, me qytetin dhe fshatrat e rivitalizuara dhe me një infrastrukturë lehtësisht të aksesueshme dhe moderne”.

Objektivat strategjike:

OS1: Rigjenerimi i qytetit të Peshkopisë, falë ndërhyrjes në krijimin e qendrave të lulëzuara, me trotuare dhe rrugica të rregullta, artistikisht prekëse, me të gjitha lehtësitat e nevojshme për qytetarët, duke ruajtur vlerat historike, parqet rikreative, me arkitekturë miqësore të pëlqyeshme për banorët dhe vizitorët.

OS2: Fokusimi në zhvillimin e zonave të reja në mënyrë të qëndrueshme në skajet/periferitë e qytetit të Peshkopisë dhe në zonat ku ka pasur më shumë ndërtime të reja, si në aksin Kuben-Peshkopi, Peshkopi-Llixha, Peshkopi-Llasen, Peshkopi-Rruga-Ura dhe Maqellarë-Qendër e Maqellarë-Bllatë.

OS3: Rivitalizimi dhe rigjenerimi i zonave rurale/fshatrave, të qendrave krahinore (që përkojnë me qendrat e Njësisë Administrative) dhe fshatrave përgjatë gjithë territorit të Dibrës.

OS4: Sigurimi i cilësisë së lartë në projektimin e ndërtimeve të reja, duke përdorur teknika dhe materiale të reja ndërtimore, duke ruajtur karakteristikat historike dhe standardet e urbanistikës.

OS5: Sigurimi i modeleve të qëndrueshme të transportit publik, duke siguruar akses të plotë për banorët në çdo aks rrugor të brendshëm me qendrën e Peshkopisë dhe interurban me Tiranën, në partneritet me sektorin privat.

OS6: Përmirësimi i shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm dhe sistemimi i KUZ-së në të gjitha qendrat e banuara.

2.2 Dibra e hapur për biznes! Ekonomi konkurruese/zhvillim ekonomik

“Dibra në vitin 2030 do të ketë një ekonomi të zhvilluar, konkurruese dhe të diversifikuar”

Objektivat strategjike:

OS7: Mbështetja dhe inkurajimi për zhvillimin ekonomik lokal, duke siguruar rritje ekonomike të bizneseve ekzistuese dhe të reja, ekonomive familjare rurale dhe turistike, si dhe shërbimeve, duke investuar në mjedisin e shëndetshëm të informacionit dhe ndërmjetësimin, si dhe në procesin e aftësimin profesional, arsimit dhe kualifikimeve.

OS8: Mbështetja për sektorin bujqësor, si sektori prioritar i zhvillimit të ekonomisë lokale, për të qenë eficient në rendimentin e prodhimit dhe konkurrues me cilësi, sasi dhe çmim në tregun kombëtar dhe atë rajonal.

2.3 Është mirë të jesh dibran! Komunitet i qëndrueshëm/zhvillim social

“Dibranët në vitin 2030 do të jenë të lumtur, do të gjallojë jeta sportive dhe kulturore, shanset e barabarta në marrjen e shërbimeve sociale, në ndjekjen e arsimit të avancuar, ku inkurajohen familjet e qëndrueshme dhe një komunitet i shëndetshëm e i sigurtë.”

Objektivat strategjike:

OS9: Sigurimi i ambienteve dhe lehtësirave publike për nevojat e komunitetit dhe grupeve në nevojë si: të pastrehët, të moshuarit, fëmijët jetimë, gratë, rinia, etj.

OS10: Përmirësimi i cilësisë së jetës, duke rritur mirëqenien, stimuluar një mënyrë jetese sa më të shëndetshme, me akses në ambientet sportive, kulturore dhe shërbim shëndetësor e arsimor të përmirësuar. Bashkia do të kujdeset për mirëmbajtjen dhe funksionimin normal të tyre, gjithmonë në shërbim të banorëve.

2.4 E gjelbër, e pastër dhe natyrale! Mjedisi i qëndrueshëm natyror

“Dibra në vitin 2030 do të ketë një mjedis natyror të mbrojtur mirë, të promovuar për pasuritë natyrore të saj dhe të pasuruar me ndërhyrje pozitive nga dora e njeriut për mbajtjen pastër të ambienteve dhe ndikimeve klimatike”.

Objektivat strategjike:

OS11: Shtimi dhe sigurimi i burimeve natyrore, falë menaxhimit me efektivitet të tokës, pyjeve, burimeve natyrore, ajrit dhe minimizimit të presionit mbi mjedisin, si mbetjet, zjarret, erozioni, etj.

OS12: Menaxhimi dhe administrimi i mirë i ujërave (nëntokësore dhe sipërfaqësore), falë shtimit të masave mbrojtëse për brigjet e lumenjve dhe përrenjve me qëllim minimizimin e dëmeve, si përmytje dhe katastrofa të tjera ujore.

OS13: Zbutja e ndikimeve negative në ndryshimet klimatike, duke përdorur me eficiencë energjinë, mbrojtja e burimeve ujore dhe emetimi i karbonit (CO₂).

2.5 Qeverisje e mirë vendore

“Dibra do të ketë një qeverisje të mirë vendore, e aftë të orientojë zhvillimin e qëndrueshëm të teritorit, të menaxhojë me efektivitet resurset dhe financat publike; një qeveri që i shërben me cilësi komunitetit, e përgjegjshme dhe e hapur për llogaridhënie ndaj qytetarëve”.

Objektivat strategjike:

OS14: Sigurimi i një qeverisjeje të mirë vendore, transparente dhe bashkëpunuese me qytetarët, sektorin privat, njësitë e tjera vendore dhe ndërkufitare, si dhe me binjakëzime me njësi vendore në Evropë.

Kapitulli VI: Objektivat strategjike për zhvillimin e territorit e njësisë vendore

Përcaktimi i objektiveve strategjike është në linjë me prioritetet për arritjen e vizionit të zhvillimit të Dibrës në vitin 2030. Ato bazohen në politikat kombëtare dhe adresojnë sfidat kryesore vendore. Objektivat sigurojnë bazën e strategjive hapësinore të territorit të Dibrës, përfshi këtu politikat thelbësore për arritjen e vizionit. Objektivat strategjike janë:

OS1: Rigjenerimi i qytetit të Peshkopisë, falë ndërhyrjes në krijimin e qendrave të lulëzuara, me trotuare dhe rrugica të rregullta, artistikisht prekëse, me të gjitha lehtësitë e nevojshme për qytetarët, duke ruajtur vlerat historike, parqet rikreative, me arkitekturë miqësore të pëlqyeshme për banorët dhe vizitorët.

OS2: Fokusimi në zhvillimin e zonave të reja në mënyrë të qëndrueshme në skajet/periferitë e qytetit të Peshkopisë dhe në zonat ku ka pasur më shumë ndërtime të reja, si në aksin Kuben-Peshkopi, Peshkopi-Llixha, Peshkopi-Llasen, Peshkopi-Rruga-Ura dhe Maqellarë-Qendër e Maqellarë-Bllatë.

OS3: Rivitalizimi dhe rigjenerimi i zonave rurale/fshatrave, të qendrave krahinore (që përkrijnë me qendrat e Njësisë Administrative) dhe fshatrave përgjatë gjithë territorit të Dibrës.

OS4: Sigurimi i cilësisë së lartë në projektimin e ndërtimeve të reja, duke përdorur teknika dhe materiale të reja ndërtimore, duke ruajtur karakteristikat historike dhe standardet e urbanistikës.

OS5: Sigurimi i modeleve të qëndrueshme të transportit publik, duke siguruar akses të plotë për banorët në çdo aks rrugor të brendshëm me qendrën e Peshkopisë dhe interurban me Tiranën, në partneritet me sektorin privat.

OS6: Përmirësimi i shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm dhe sistemimi i KUZ-së në të gjitha qendrat e banuara.

OS7: Mbështetja dhe inkurajimi për zhvillimin ekonomik lokal, duke siguruar rritje ekonomike të bizneseve ekzistuese dhe të reja, ekonomive familjare rurale dhe turistike, si dhe shërbimeve, duke investuar në mjedisin e shëndetshëm të informacionit dhe ndërmjetësimin, si dhe në procesin e aftësimin profesional, arsimit dhe kualifikimeve.

OS8: Mbështetja për sektorin bujqësor, si sektori prioritar i zhvillimit të ekonomisë lokale, për të qenë eficient në rendimentin e prodhimit dhe konkurrues me cilësi, sasi dhe çmim në tregun kombëtar dhe atë rajonal.

OS9: Sigurimi i ambienteve dhe lehtësirave publike për nevojat e komunitetit dhe grupeve në nevojë si: të pastrehët, të moshuarit, fëmijët jetimë, gratë, rinia, etj.

OS10: Përmirësimi i cilësisë së jetës, duke rritur mirëqenien, stimuluar një mënyrë jetese sa më të shëndetshme, me akses në ambientet sportive, kulturore dhe shërbim shëndetësor e arsimor të përmirësuar. Bashkia do të kujdeset për mirëmbajtjen dhe funksionimin normal të tyre, gjithmonë në shërbim të banorëve.

OS11: Shtimi dhe sigurimi i burimeve natyrore, falë menaxhimit me efektivitet të tokës, pyjeve, burimeve natyrore, ajrit dhe minimizimit të presionit mbi mjedisin, si mbetjet, zjarret, erozioni, etj.

OS12: Menaxhimi dhe administrimi i mirë i ujërave (nëntokësore dhe sipërfaqësore), falë shtimit të masave mbrojtëse për brigjet e lumenjve dhe përrenjve me qëllim minimizimin e dëmeve, si përmbytje dhe katastrofa të tjera ujore.

OS13: Zbutja e ndikimeve negative në ndryshimet klimatike, duke përdorur me eficiencë energjinë, mbrojtja e burimeve ujore dhe emetimi i karbonit (CO₂).

OS14: Sigurimi i një qeverisjeje të mirë vendore, transparente dhe bashkëpunuese me qytetarët, sektorin privat, njësitë e tjera vendore dhe ndërkufitare, si dhe me binjakëzime me njësi vendore në Evropë.

Kapitulli VII: Programet dhe projektet kryesore të zhvillimit

Një numër të konsiderueshëm të temave, që përdoren për realizimin e objektivave strategjike janë të ndërthurura njëra me tjetrën, dhe në strukturën e politikave ato përsëriten. Si politika bazë janë marrë politikat në nivel kombëtar, të parashikuara në PPK dhe sipas Ligjit 107 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, të rishikuar.

OS1: Rigjenerimi i qytetit të Peshkopisë, falë ndërhyrjes në krijimin e qendrave të lulëzuara, me trotuare dhe rrugica të rregullta, artistikisht prekëse, me të gjitha lehtësirat e nevojshme për qytetarët, duke ruajtur vlerat historike, parqet rikreative, me arkitekturë miqësore të pëlqyeshme për banorët dhe vizitorët.

POLITIKA: *Zhvillim policentrik, densifikim, gjithëpërfshirje. “Qytetet dinamike, tërheqëse dhe konkurruese në rajone të urbanizuara”.*

Tendenca e zhvillimit urban të qytetit të Peshkopisë në 25 vitet e fundit është karakterizuar nga tre tipare kryesore:

1. Migrimi drejt qendrave të mëdha të zhvilluara metropolitane, Tiranë dhe Durrës.
2. Imigrimi (ardhja) e popullsisë nga zonat rurale të fshatrave të Dibrës.
3. Shpërhapja urbane në dëm të sipërfaqeve të gjelbra, të tokës bujqësore dhe tokës së lirë natyrore.

Të gjitha këto tipare kanë rezultuar në një zhvillim monocentrik të qytetit, me tipare të theksuara të pabarazisë ekonomike dhe sociale. Kjo rritje e shpejtë nuk u shoqërua me rritje të cilësisë së jetesës urbane. Mungesa e infrastrukturës ekzistuese, rrugëve, kanalizimeve, shkollave dhe kopshteve ka bërë që pjesa më e madhe e popullsisë të braktisë zonën e lindjes për një jetë më të mirë. Nga njëra anë, territori karakterizohet nga një depopullim i lartë, mungesë e forcës punëtore dhe për pasojë, varfëri dhe nga ana tjetër, përqendrim i lartë i popullsisë, por pa infrastrukturën e nevojshme sociale e infrastrukturë. Informaliteti, shpërhapja urbane, stoku i banesave dhe i apartamenteve të dyta, në shumicën e rasteve, ndërtime që nuk plotësojnë kushtet minimale për ndriçim dhe ajrim; ndërtimi masiv në qendër apo buzë rrugëve kryesore të qytetit, duke zënë hapësirat e gjelbra, e që nuk janë atraktive për shërbime apo biznese cilësore; dhe përsëri, mungesa e strehimit për një kategori të gjerë të popullatës, janë tiparet dominuese që karakterizojnë zhvillimin urban të 25 viteve të fundit të qytetit të Peshkopisë.

Masat/Ndërhyrja:

1. Rikualifikimi i qendrës ekzistuese (bulevardi kryesor), ruajtja e qendrës historike në lagjen e vjetër, si dhe krijimi i miniqendrave nëpër lagje, me monumente/vepra artistike simbolike, synon diversifikimin e tipologjive dhe policentrizmin e Peshkopisë.
2. Rikualifikimi dhe rehabilitimi i fasadave të objekteve, zonave ekzistuese të banimit me hapësirat e gjelbra dhe densifikimi i tyre aty ku ekziston mundësia.
3. Rikonstruksioni i lagjes së vjetër historike, i rrugicave, fasadave dhe shtëpive në lagjet “Teqe”, “Vehbi Dibra”, “Kallavere” dhe “Kamen”, duke ruajtur arkitekturën e vjetër

dibrane, çatitë karakteristike dhe përshtatur ato, në funksion të shërbimeve dhe atraksioneve turistike.

4. Peshkopia, qyteti i “trëndafilave dhe luleboreve”, që qarkojnë me gardhe të gjelbëruara trotuaret dhe rrugicat, kontribut i vetë bizneseve me aktivitete në këto zona; vitrinat e mirërregulluara nga vetë ata, me një stil unik të përcaktuar nga bashkia zbukurojnë qytetin.
5. Rikonceptimi i hapësirave të dedikuara arsimit për të fuqizuar më shumë rolin e Peshkopisë si qendër arsimore e Dibrës, qarkut dhe rajonit të Veriut të Shqipërisë.
6. Krijimi i një sistemi të transportit urban modern, që i mundëson komunitetit akses në një infrastrukturë rrugore qytetase të rregulluar, lëvizje mjedisore, parkingje dhe stacione urbane, sinjalistikë të duhur, cilësi shërbimi për qytetarët.
7. Peshkopia, qendër administrative e rajonit të Dibrës. Institucionet publike, të shpërndara nëpër territorin e Peshkopisë duhet të ruhen dhe përdoren si gjeneratorë aktivitetesh sociale për qytetin. Objekte të reja, me funksione publike duhet të ndërtohen për të pasuruar territorin dhe fuqizuar aspektin komunitar.
8. Përmirësimi i kushteve dhe ambienteve shëndetësore të spitalit rajonal, duke përmirësuar aksesin dhe rezervimi i hapësirës për qendra shëndetësore në lagje, ose të integruar dhe rehabilitimi i qendrës kurative balneare të llixhave.
9. Ndërtimi i parkut rikreativ të “Luginës së Shërimit” me ambiente çlodhëse, pushimi dhe sportive e me shtigje e rrugë këmbësore për të apasionuarit e ecjeve në natyrë.
10. Rikualifikimi i ambienteve sportive, në mënyrë që të shërbejnë si qendra sporti dhe i ekipeve që përfaqësojnë vlerat e Dibrës; krijimi i lehtësirave për aktivitetin e fëmijëve, amatorëve dhe qytetarëve të Peshkopisë.
11. Ruajtja dhe pasurimi i vlerave kulturore dhe artistike të Dibrës, duke përmirësuar infrastrukturën në objektet kryesore kulturore, si: Muzeu, Qendra e fëmijëve, Pallati i kulturës, “Haki Stërmilli”, Biblioteka, QEK-u dhe duke vitalizuar jetën kulturore dhe artistike të banorëve, vizitorëve dhe brezave të rinj.

OS2: Fokusimi në zhvillimin e zonave të reja në mënyrë të qëndrueshme në skajet/periferitë e qytetit të Peshkopisë dhe në zonat ku ka pasur më shumë ndërtime të reja, si në aksin Kuben-Peshkopi, Peshkopi-Llixha, Peshkopi-Llasen, Peshkopi-Rruga-Ura dhe Maqellarë-Qendër e Maqellarë-Bllatë.

Politika: *Kontroll i ekspansionit fizik të qyteteve dhe zonave të urbanizuara duke promovuar densifikimin në vend të shpërhapjes urbane.*

Tendenca në zonat periferike të qytetit të Peshkopisë, ish-zonat industriale apo ato ushtarake dhe në anë të akseve kryesore të rrugëve, kanë qenë pjesë e ndërtimeve pa leje dhe kanë shkaktuar krijimin e zonave informale. Këto janë transformuar gjatë viteve të fundit, si pasojë e procesit jokohorent të zhvillimit urban. Në këto territore sot gjendet një përzierje formash (arkitekturë tradicionale, godina të reja informale, arkitekturë bashkëkohore, etj), të cilat janë shumë të ndryshme dhe nuk ndjekin asnjë rregull. Në këto territore vihet re një mungesë rrjeti rrugor dhe hapësirash publike. Synimi për këto zona është mbështetja e aktorëve lokalë në menaxhimin e situatës, duke kryer përmirësime, rregullime në infrastrukturë, shërbime, ambiente sociale dhe çlodhëse për kalimin e kohës. Këto, nëpërmjet një ndërhyrjeje nga sektori publik dhe fokusimit në krijimin e zonave të reja të zhvillimit urban, falë një procesi koherent planifikimi.

Masat/Ndërhyrja:

1. Legalizimi dhe urbanizimi i lagjeve dhe pjesëve informale të llixhave, ndërtimeve në aksin Kuben-Peshkopi, lagjja e zonës ish-ushtarake, ndërtimet në ish-zonën industriale, ndërtimet në Dobrovë dhe Llasen, ndërtimet në Maqellarë-qendër dhe ndërtimet në aksin e rrugës Maqellarë-Doganë e Bllatës, me infrastrukturë urbane të nevojshme, shërbime publike dhe sociale bazë të domosdoshme.
2. Hartimi i planit vendor urban, që të mund të përcaktojë qartë zonimin e zhvillimit në territorin e Dibrës, duke ruajtur traditën; t'i përgjigjet realitetit ekzistues, duke mbrojtur natyrën dhe vlerat historike, duke nxitur zhvillimin ekonomik konkurrues; të jetë një rregullore urbane për zgjerimin dhe sistemimin e territorit.
3. Zgjerimi i zonës urbane të Peshkopisë në pjesën jug-lindore dhe jug-perëndimore, ku do të ndërtohet unaza e qytetit, si një arterie e zgjerimit të kontrolluar urban me ndërtime të reja mikse, me akses në qendër; ruhet kështu mjedisi i qëndrueshëm dhe promovohet zhvillimi i zonës ekonomike dhe industriale, si dhe lehtësohet lëvizja dhe transporti, duke i dhënë frymëmarrje qytetit.
4. Krijimi i lehtësirave të nevojshme infrastrukturore për zhvillimin e zonës industriale në aksin SMT-Kuben.
5. Sistemimi i zonës Maqellarë-Doganë në Bllatë, si zonë ekonomike shumëfunktionale për banorët e fshatrave të Maqellarës dhe me një orientim kah ndërveprimi ekonomik ndërkufitar me Dibrën e Madhe.

OS3: Rivitalizimi dhe rigjenerimi i zonave rurale/fshatrave, të qendrave krahinore (që përkopjnë me qendrat e Njësive Administrative) dhe fshatrave përgjatë gjithë territorit të Dibrës.

Politika: Zhvillimi rural i qëndrueshëm.

Dibra ka një territor, në më shumë se 91% të tij, zonë rurale, ku gjenden 141 fshatra si pjesë përbërëse e 14 Njësive Administrative, dhe ku jeton 75% e popullsisë. Tendanca e deritanishme ka qenë braktisja e zonave rurale/fshatrave dhe lëvizja drejt qendrave urbane e metropolitane. Kjo ka bërë që në shumë fshatra të kemi shtëpi të pabanuara, humbje interesi për të jetuar në fshat, e shoqëruar kjo me një sërë fenomenesh negative sociale. Arsytet e largimit nga fshatrat janë, kryesisht: mungesa e infrastrukturës rrugore, e cila pengon aksesimin me tregun dhe zhvillimin, cilësia e ulët e shërbimeve bazë publike, si uji i pijshëm, arsimit, shërbimi shëndetësor, etj. Ka munguar edhe mbështetja financiare për gjallërimin e jetës ekonomike dhe

sociale në fshat. Ekonomitë e vogla familjare, më shumë kishin destinacion shfrytëzimin vetjak, sesa tregun. Mungesa e mekanikës, sistemit ujitës dhe copëtimi i tokës në ngastra të vogla ka bërë që rendimenti i prodhimit të jetë i ulët dhe të ardhurat për ekonomitë e familjeve rurale të jenë të vogla. Kohët e fundit shihet një stabilitet i lëvizjes së familjeve nga fshati, janë rritur investimet personale në ekonomitë rurale dhe qeveria ka vënë në shërbim potenciale për mbështetjen me skema të ndryshme subvencionesh të zhvillimit rural. Edhe emigrantët, apo të larguar të tjerë në zonat urbane dhe metropolitane po kthehen për të jetuar e punuar, sezonalisht, apo edhe përgjithmonë në fshat.

Masat/Ndërhyrjet:

4. Përmirësimi i shërbimeve publike në fshat, duke shtuar investimet në furnizimin me ujë të pijshëm, pastrim, shërbim shëndetësor, arsim; përgjigja ndaj nevojave të banorëve të Dibrës në mënyrë të kënaqshme.
5. Krijimi i një sistemi rrugor dhe shërbimi transporti cilësor që afron komunitetet rurale me qendrën urbane dhe mundëson lidhje të shpejta me tregjet lokale, rajonale dhe kombëtare.
6. Rikualifikimi i urbanistikës së fshatrave, duke ruajtur arkitekturën tradicionale me elemente tipike rurale të shesheve dhe qendrave të krahinave e fshatrave të mëdhenj, me vepra simbolike arti që prekin krenarinë lokale, duke bashkëpunuar me komunitetin si në realizim dhe bashkëfinancim.
7. Gjallërimi i jetës sociale, kulturore dhe sportive në zonat rurale, duke investuar terrenet sportive në shkollat e mesme, duke mbështetur festat lokale dhe duke përfshirë zona të ndryshme rurale në kalendarin e festave tradicionale të Dibrës.
8. Diversifikimi i ekonomisë familjare rurale, duke stimuluar rritjen e prodhimit të fermave, krijimin e grupeve prodhuese, shfrytëzimin e ekonomive rurale shtesë, si bimët mjekësore, bletarinë, shpendët, punimet artizanale dhe turizmin rural.

OS4: Sigurimi i cilësisë së lartë në projektimin e ndërtimeve të reja, duke përdorur teknika dhe materiale të reja ndërtimore, duke ruajtur karakteristikat historike dhe standardet e urbanistikës.

Politika: *Standartizimi dhe modernizimi i ndërtimeve urbane.*

Tendenca që të ndërtohet kudo dhe sido ka qenë tipari që ka shoqëruar procesin e ndërtimeve të reja në Shqipëri, po kështu edhe në Dibër. Ndërtime të ngritura në zona të pastuduara, pa arkitekturë, duke mos ruajtur asnjë standard urbanistik dhe teknik kanë shoqëruar ndërtimtarinë në këtë periudhë. Sot kemi shumë objekte të ndërtuara, jofunksionale dhe të pashfrytëzuara. Edhe nga aspekti i estetikës urbane, ato janë të shëmtuara, nuk kanë ruajtur arkitekturën lokale dhe nuk përshtaten me ambjentin, historinë dhe traditën.

Masat/Ndërhyrja:

1. Përcaktimi i rregullave urbane për zonimin, arkitekturën e ndërtimit, vendosjen dhe materialin e ndërtimit, rregullat në planin urban të bashkisë dhe ndërgjegjësimi i qytetarëve, ndërtuesve dhe inxhinierëve për t'i familjarizuar me këto rregulla.
2. Të kontribuohet pozitivisht në zhvillimin e qëndrueshëm të zonës, duke krijuar një mjedis estetikisht urban të pranueshëm, duke mbrojtur vlerat historike, rritur punësimin dhe aftësuar personelin inxhinierik e ndërtues me teknologjinë e re bashkëkohore në ndërtim.
3. Të modernizohet, të futen elementë të arkitekturës dibrane dhe të nxitet zinxhiri i plotë lokal i ndërtimit, në përputhje me standardet dhe kërkesat bashkëkohore.

4. Promovimi i artit edhe në arkitekturën publike.
5. Të hartohen dhe planifikohen hapësirat, sipërfaqet e gjelbra, aksesit rrugor dhe rrugicat në funksion të një ambienti miqësor me qytetarin.
6. Të kontrollohen dhe zbatohen standardet dhe politikat teknike urbane të përcaktuara në manualin dhe në kuadrin ligjor të shtetit shqiptar.

OS5: Sigurimi i modeleve të qëndrueshme të transportit publik, duke siguruar akses të plotë për banorët në çdo aks rrugor të brendshëm me qendrën e Peshkopisë dhe interurban me Tiranën, në partneritet me sektorin privat.

Politika: *Rritja e aksesueshmërisë me infrastrukturë moderne.*

Problematika kryesore në zonën e Dibrës ka qenë dhe mbetet infrastruktura e dobët dhe shërbimet publike jocalësore. Dibra sot është zona më e izoluar dhe e largët e Shqipërisë, me rrugën nacionale plotësisht të shkatërruar. Vështirësi paraqet edhe infrastruktura rrugore brenda territorit, ku akoma kemi fshatra që nuk kanë rrugë, ose me një lëvizje shumë të vështirë e në mot të keq, të pakalueshëm. Rrugët e brendshme lokale dhe rrugët rurale rajonale kanë kaluar në kompetencat e bashkisë së re, e cila do të kujdeset për investimet dhe mirëmbajtjen e tyre. Rrugët e brendshme në qytet dhe rrugët që lidhin fshatrat janë në gjendje jo të mirë dhe kanë nevojë për ndërhyrje të plotë.

Masat/Ndërhyrja:

1. Përmirësimi i transportit publik, duke siguruar akses të plotë për banorët në çdo aks rrugor të brendshëm të asfaltuar, me qendrën e Peshkopisë dhe interurban me Tiranën, në partneritet me sektorin privat.
2. Ngritja e terminaleve të transportit publik në Peshkopi, për të rehabilituar parkingun dhe transportin.
3. Asfaltimi i rrugëve të brendshme, që lidhin disa fshatra, si Kastriot-Lurë, Muhurr-Selishtë, Peshkopi-Rabdisht, Peshkopi-Zimur dhe të gjitha rrugët e fshatrave me 1-2 km distancë lidhjeje me rrugët e asfaltuara.
4. Krijimi i strukturave eficiente për mirëmbajtjen dhe kujdesin ndaj sistemit rrugor, duke i pajisur me mjetet, burimet njerëzore dhe financiare të nevojshme.

OS6: Përmirësimi i shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm dhe sistemimi i KUZ-së në të gjitha qendrat e banuara.

Politika: *Shpërndarja cilësore e shërbimeve publike.*

Në territorin e bashkisë së Dibrës, për një sërë zonash, shërbimi me ujë të pijshëm mungon. Rreth 32% e popullsisë nuk ka akses në shërbimin e ujit të pijshëm. Në qytetin e Peshkopisë dhe në shumë zona të tjera ka shërbim me orë të kufizuara, afro 2-4 orë në ditë. Cilësia e ujit lë për të dëshiruar. Mundësi e mirë janë investimet e reja që po bëhen në ujësjellësin e qytetit dhe në atë të Sopanikës, modele të mira që tregojnë se si mund të përmirësohet dhe menaxhohet sistemi i

ujësjellësit në Dibër. Trajtimi i ujërave të zeza dhe kanalizimeve për 83% të popullatës mungon. Prandaj, në këtë sistem duhen investime të mëdha.

Masat/Ndërhyrja:

1. Përmirësimi i furnizimit me ujë të pijshëm për popullatën; ujë me cilësi dhe standarde, duke shfrytëzuar me efektivitet ujësjellësat ekzistues, duke rritur investimet dhe miradministruar ujësjellësat aktualë.
2. Menaxhimi cilësor i ujërave të përdorura, duke rritur investimet për ndërtimin e KUZ-ve aty ku mungojnë, rehabilitimi i atyre ekzistuese dhe ngritja e impianteve të trajtimit.

OS7: Mbështetja dhe inkurajimi për zhvillimin ekonomik lokal, duke siguruar rritje ekonomike të bizneseve ekzistuese dhe atyre të reja, ekonomive familjare rurale dhe turistike, si dhe shërbimeve, duke investuar në mjedisin e shëndetshëm të informacionit dhe ndërmjetësimin, si dhe në procesin e aftësimin profesional, arsimit dhe kualifikimeve.

Politika: *Ekonomi diverse konkurruese në tregjet kombëtare dhe rajonale.*

Dibra është pjesë e rajonit ekonomik të specializuar, Mat-Bulqizë-Dibër. Profili rajonal i saj ka tipare komplekse, si: turizmi malor, natyror dhe ai balnear. Gjithashtu, vlerat e specializimit të këtij rajoni qëndrojnë në nxjerrjen dhe përpunimin e mineraleve, në zhvillimin e industrisë dhe teknologjisë përpunuese (sipas PPK-së). Ekonomia lokale, me gjithë potencialet e resurseve natyrore minerale, hidrike, pyjore dhe fuqinë e lartë të aftë për punë, nuk është konkurruese dhe fitimprurëse. Infrastruktura e dobët rrugore, lëvizja e madhe demografike, që është shoqëruar dhe me ikjen e kapitalit, mungesa e investimeve vendase dhe të huaja, mungesa e qendrave të formimit profesional ka sjellë pengesa për krah pune të kualifikuar. Këto dhe aspekte të tjera kanë bërë që niveli ekonomik i zhvillimit lokal të jetë në nivele të ulëta. Turizmi balnear në Peshkopi mund të presë një numër të konsiderueshëm pushuesish, por akoma nuk është aq eficient sa ç' duhet të jetë. Turizmi malor është në fillesat e veta, me disa shtëpi pritëse dhe guida jo të formalizuara, si nga biznesi dhe profesionalizmi. Ka tendencë të një vëmendjeje të investitorëve dhe qeverisë, por jo në ritmin dhe vendosmërinë e duhur.

Masat/Ndërhyrja:

1. Krijimi i kushteve favorizuese për tërheqjen e investimeve të mëdha vendase dhe të huaja në sektorin e burimeve natyrore minerale të kromit, gipseve dhe mermerit, si dhe pasurive hidrike në përrrenjtë që ndodhen në territorin e Dibrës, në harmoni me standardet mjedisore e në përputhje me interesat sociale të komunitetit.
2. Përmirësimi i standardit të shërbimit në turizmin balnear, duke shtuar numrin e vizitorëve, duke zgjatur sezonin turistik dhe rinovuar qendrën balneare me shërbime dhe ambiente të reja bashkëkohore.
3. Nxitja dhe mbështetja për zhvillimin e turizmit rural dhe malor me politika sektoriale zhvillimi, si dhe për hapjen e bizneseve të reja pritëse (500 shtëpi pritëse), guidave dhe infrastrukturës turistike të duhur (pika informuese, webpage, sinjalistikë dhe markimi i shtigjeve turistike në gjithë territorin e Dibrës).
4. Promovimi i vlerave historike-tradicionale në funksion të turizmit, duke mbështetur organizimin e kalendarit vjetor të festave, evente këto që kontribuojnë në tërheqjen e vizitorëve. Një funksion strukturor i bashkisë, ky.

5. Nxitja dhe mbështetja e krijimit të grupeve prodhuese të diversifikuara në zonat rurale dhe urbane.
6. Krijimi i lehtësirave dhe ambienteve të duhura për tregjet ditore, javore dhe të vazhdueshme, me kushtet e duhura, vendin e duhur dhe sistemin e kontrollit dhe sigurisë.
7. Zhvillimi i aftësive profesionale për fuqi punëtore të kualifikuar e të trajnuar, nëpërmjet programit “Mësojmë gjatë gjithë jetës”, si dhe ngritja e qendrës së formimit profesional “Mjeshtria dibrane” me profesione që përshtaten me tregun e punës në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
8. Fuqizimi i ndërveprimit ekonomik ndërkufitar me Dibrën e Madhe, i shkëmbimeve, i lëvizjes së mallit dhe kapitaleve, i tregjeve dhe fuqisë punëtore nga vetë bizneset dhe programet e EU-së për bashkëpunimin rajonal.

OS8: Mbështetja për sektorin bujqësor, si sektori prioritar i zhvillimit të ekonomisë lokale, për të qenë eficient në rendimentin e prodhimit dhe konkurrues me cilësi, sasi dhe çmim në tregun kombëtar dhe atë rajonal.

Politika: *Ruajtje, konsolidim, modernizim.*

Bujqësia në Dibër është sektori kryesor që mban peshën më të madhe të punësimit, rreth 58.6% e që ka potenciale të mira zhvillimi. Bujqësia dhe blegtoria janë dy degë të pandara të zhvillimit bujqësor në Dibër. Tradicionalisht bujqit dibranë janë marrë me kultivimin e drithërave të bukës, perimeve, për nevojat familjare dhe foragjereve për ushqim për bagëtinë. Pemëtaria ka një imazh shumë të mirë në Dibër dhe, megjithëse sipërfaqja nuk është e madhe, prodhimi i saj ka destinacion kryesor tregun lokal dhe atë kombëtar, duke sjellë të ardhura të konsiderueshme për familjet agrare. Agropërpunimi ka filluar të rrisë investimet në këtë sektor, si në prodhimin e lëngut të frutave (fabrika moderne dhe me kapacitet të plotë e Fehip Salkurtit), ashtu edhe në përpunimin e qumështit, gjithsej 19 baxho. Problem haset me bashkëpunimin ndërmjet fermerëve për t’u bashkuar në shoqëri të bashkëpunimit bujqësor, apo në grupe prodhuese. Kështu ata do të rrisnin cilësinë, prodhimin dhe aftësinë konkurruese në tregje. Vështirësi të tjera fermerët hasin me daljen në treg, për shkak të infrastrukturës dhe cilësisë së dobët të marketingut.

Masat/Ndërhyrja:

1. Rritja e produktivitetit dhe konkurrueshmërisë me sasi, cilësi të prodhimeve bujqësore dhe blegtorale me orientim drejt tregut; shtimi i sipërfaqes së mbjellë me pemëtari (3-fishimi i sipërfaqes së mbjellë me pemë frutore dhe 2-fishimi i numrit të krerëve në blegtori), sidomos me mollë, qersh, kumbull arra dhe shtimi i krerëve të bagëtive të imëta.
2. Mbështetja me investime në agropërpunim, në nivele të vogla e të mesme dhe ngritja e pikave të grumbullimit.
3. Stimulimi i krijimit të SHBB-ve (Shoqërive të Bashkëpunimit Bujqësor), ose grupeve prodhuese, si instrumente që bëjnë optimizimin e përdorimit të burimeve bujqësore dhe shfrytëzimin, menaxhimin efikas të tokës dhe burimeve bujqësore.
4. Krijimi i markës “Prodhime Dibre”, me qëllim nxitjen e zhvillimit të konkurrueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së sektorit bujqësor. Kjo, nëpërmjet integritit të prodhuesve

kryesorë në zinxhirin ushqimor përmes skemave të cilësisë dhe promovimit në tregun vendas.

5. Rritja e investimeve për të ngritur një infrastrukturë moderne bujqësore, si ajo e ujitjes dhe bazat e furnizimit bujqësor me teknikën, farërat, pesticidet, etj.
6. Aftësimi i fermerëve, agropërpunuesve, teknologëve me njohuri të duhura nëpërmjet kualifikimeve, trajnimeve nga specialistët e ekzistencionit të drejtorisë së Bujqësisë dhe mundësimi të hapjes së një dege bujqësore në shkollën profesionale, “Nazmi Rushiti”.
7. Shtimi i masave lobuese për thithjen e donacioneve dhe investimeve në sektorin e bujqësisë.

OS9: Sigurimi i ambienteve dhe lehtësirave publike për nevojat e komunitetit dhe grupeve në nevojë si: të pastrehët, të moshuarit, fëmijët jetimë, gratë, rinia, etj.

Politika: Përfshirja e integrimi të komuniteteve të pafavorizuara/Fuqizimi i sektorit social.

Dibra është nga zonat më të pafavorizuara në vend, me nivelin e varfërisë më të lartë dhe me aksesin më të dobët në shërbimet sociale. Kujdesi nga qeveria matet vetëm me ndihmën ekonomike për familjet më të varfra. Institucionet, aktivitetet dhe nismat për zhvillim social janë të pakëta, ose mungojnë fare. Grupet në nevojë dhe ato me aftësi të kufizuar ndihen si të lëna pas dore. Ato kanë pak mundësi për t’u integruar në jetën shoqërore. Edhe ndërhyrja e organizatave dhe projekteve të Shoqërisë Civile ka qenë e vogël, sporadike, me projekte të veçuara dhe të jointeguara.

Masa/Ndërhyrja:

1. Ngritja e një qendre për shërbimet sociale në Dibër, ku të mundësohet marrja e shërbimit dhe kujdesit të specializuar për grupet në nevojë, si gratë e trafikuar dhe të dhunuara, fëmijët e braktisur, jetimët dhe moshën e tretë, të cilat janë të privuara nga çdo kujdes.
2. Krijimi i qendrave funksionale ditore për fëmijët, të papunët dhe pensionistët, me ambientet dhe lehtësirat e nevojshme.
3. Mbështetja me banesa sociale për strehimin e grupeve që nuk kanë mundësi strehimi.
4. Fuqizimi i qendrës ditore të shëndetit mendor.
5. Mbështetja me programe sociale e komunitetit rom dhe atij egjiptian, programe këto që lidhen me edukimin dhe integrimin e tyre në shoqëri.

OS10: Përmirësimi i cilësisë së jetës, duke rritur mirëqenien, stimuluar një mënyrë jetese sa më të shëndetshme, me akses në ambientet sportive, kulturore dhe shërbim shëndetësor e arsimor të përmirësuar. Bashkia do të kujdeset për mirëmbajtjen dhe funksionimin normal të tyre, gjithmonë në shërbim të banorëve.

Politika: *Shoqëri dinamike me mundësi të barabarta!*

Pjesa tranzitore ka qenë shumë e vështirë për institucionet, profesionistët dhe gjithë komunitetin e artistëve, krijuesve dhe sportistëve në Dibër. Fondet e vogla, të vëna në dispozicion kanë bërë që shumë institucione kulturore dhe sportive të shkatërrohen, ose të gjenden në vështirësi për t'u mirëmbajtur. Qytetarët dhe amatorët, gjithnjë e më pak akses kanë patur në aktivitete sportive dhe kulturore. Këndet sportive dhe ambientet kulturore në zonën rurale pothuajse janë shkatërruar plotësisht. Kurset, ekipet dhe rrethet për edukimin dhe praktikimin e fëmijëve dhe brezit të ri nuk ekzistojnë. Sistemi, ambientet dhe fryma që përçojnë drejtuesit e këtyre institucioneve duket si e pashpresë.

Masat/Ndërhyrja:

1. Gjallërimi i jetës kulturore dhe artistike të komunitetit, që nxit krijimtarinë dhe pasuron jetën shpirtërore.
2. Mbrojtja dhe rikonstruksioni i atyre objekteve që përçojnë vlerat historike dhe tradicionale të trevës së Dibrës.
3. Mbështetja e institucionalizuar e edukimit komunitar, grupeve dhe shoqërisë civile që promovojnë ndryshime cilësore në kulturën pozitive të komunikimit dhe dialogut qytetar.
4. Nxitja e vitalitetit të komunitetit dibran nëpërmjet mbështetjes së jetës aktive sportive, duke filluar që nga fëmijët dhe amatorët deri te profesionistët në sporte shumëdisiplinëshe.
5. Zhvillimi i një arsimi bashkëkohor, që mundëson nxënës me dije të avancuara dhe inovatore, të aftë për t'u përshtatur me tregun e punës.
6. Përmirësimi i shërbimit shëndetësor për banorët e Dibrës, duke rehabilituar qendrat shëndetësore dhe duke rritur cilësinë e kujdesit nga një personel i kualifikuar mjekësor.

OS11: Shtimi dhe sigurimi i burimeve natyrore, falë menaxhimit me efektivitet të tokës, pyjeve, burimeve natyrore, ajrit dhe minimizimit të presionit mbi mjedisin, si mbetjet, zjarret, erozioni, etj.

Politika: *Zhvillim i qëndrueshëm i sistemit natyror*

Problematika kryesore mjedisore në Dibër lidhet me prerjen masive të pyjeve të larta, sidomos në Parkun e Lurës, prerjen e pyjeve, vendosjen e zjarreve në pyje, gjuetinë e paligjshme dhe vjeljen pa kriter të bimëve mjekësore. Këto kanë sjellë një përkeqësim të situatës mjedisore, prishje të peizashit, rrezikim me zhdukje të shumë bimëve dhe kafshëve të egra, si dhe rritje të erozionit.

Masat/Ndërhyrja:

1. Ruajtja, konservimi dhe zhvillimi i vlerave të ekosistemeve natyrore në Dibër, në harmoni me natyrën duke krijuar institucionet, politikat dhe rregulloret përkatëse, të njohura nga komuniteti dhe në zbatim të kuadrit ligjor.
2. Shtimi i zonës së mbrojtur të Parkut Kombëtar të Lurës në gjithë territorin e vargmaleve të Lurës, deri në Malin e Pratit e duke zbritur poshtë, buzë Drinit.

3. Përmirësimi i menaxhimit të zonave të mbrojtura dhe monumenteve të natyrës, që gjenden në territorin e Dibrës.
4. Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve urbane (pastrim, grumbullim, transport dhe dekompozim) dhe shtrirja e shërbimit të pastrimit në gjithë territorin e bashkisë së Dibrës.
5. Rritja e kujdesit ndaj pyjeve me një proces të integruar, ku të gjithë aktorët të jenë pjesëmarrës, dhe të zbatohen rreptësisht reformat dhe ligjet në fuqi.
6. Mbështetja për menaxhimin e pyjeve komunale dhe përfundimi i procesit të transferimit të tyre në pronësi të fermerëve.
7. Mbrojtja e florës dhe faunës së Dibrës, duke shtuar masat për ndërgjegjësimin e komunitetit dhe përfshirjen e institucioneve në përpjekjet për zbatimin e reformave dhe ligjeve që rregullojnë biodiversitetin.
8. Mbështetja e nismave të OJF-ve dhe programeve të ndryshme në hartimin dhe zbatimin e një programi të plotë për rehabilitimin dhe zhvillimin e territorit të Parkut të Lurës.
9. Nxitja dhe mbështetja e nismave që promovojnë vlerat natyrore të Dibrës, me fokus turizmin malor dhe ekoturizmin.

OS12: Menaxhimi dhe administrimi i mirë i ujërave (nëntokësore dhe sipërfaqësore), falë shtimit të masave mbrojtëse për brigjet e lumenjve dhe përrrenjve me qëllim minimizimin e dëmeve, si përmytje dhe katastrofa të tjera ujore.

Politika: *Administrimi i mirë i ujërave*

Gjatë viteve të tranzicionit u kryen ndërhyrje negative në argjinaturat e lumenjve dhe përrrenjve, të cilave u dëmtuan gardhet sanitare mbrojtëse të brigjeve. Gjithashtu u dëmtuan edhe pritat mbrojtëse. Si pasojë patëm daljen e ujit nga shtrati i tyre, duke rrezikuar kështu zhavorizimin e sipërfaqeve të mëdha të tokës bujqësore, shoqëruar me gërryerje dhe shembje. Më e rrezikuar është zona e Kastriotit, rrezik që i kanoset nga përroi i Gjelagjoshit dhe zona e Luznisë, e rrezikuar nga përroi i Kusares. Edhe me përroin e Llixhave ka ndodhur i njëjti fenomen, ai i prerjes së brezit të gjelbër mbrojtës dhe ndërhyrje të shumta me ndërtime, të cilat janë të rrezikuara.

Masat/Ndërhyrja:

1. Mbrojtja nga erozioni e brigjeve të lumenjve dhe tokave me pjerrësi të lartë, duke stimuluar ndërhyrjet natyrale dhe ato inxhinierike konkrete.
2. Hartimi i planit të menaxhimit të Drinit të Zi.

OS13: Zbutja e ndikimeve negative në ndryshimet klimatike, duke përdorur me eficiencë energjinë, mbrojtja e burimeve ujore dhe emetimi i karbonit (CO2).

Politika: *Diversifikimi drejt energjisë së rinovueshme*

Dibra është një zonë me dimër të ftohtë e të gjatë. Për ngrohje përdoret lëndë drusore, e cila sigurohet që në periudhën e verës. Mungesa e energjisë alternative, diellore apo termale - shfrytëzimi i burimeve termale të llixhave - cilësia e dobët e ndërtimeve, pa materiale termoizoluese, teknologjia e vjetër për pajisjet e ngrohjes, të gjitha këto ndikojnë negativisht në harxhimin e lëndës së parë (drusore) dhe shoqërohen me një përfitim të ulët të energjisë.

Ky fenomen ka ndikuar për keq edhe në ambientin e qytetit: hapësirat publike dhe ato të gjelbra rreth blloqeve të pallateve zihen me drutë e zjarrit. Reduktimi i harxhimit të lëndës drusore për ngrohje, duke përdorur burimet e tjera alternative, teknologjinë e re të sistemit të kaldajave dhe përmirësimin e ndërtimit me materiale termoizoluese janë disa nga sfidat, me të cilat do të përballet komuniteti dibran në të ardhmen. Vetëm kështu ky komunitet do të ketë një ambient më të pastër, të rregullt dhe me më shumë pyje të paprera.

Masat/Ndërhyrja:

1. Rritja e eficiencës së përdorimit të energjisë, duke mundësuar futjen e energjisë së pastër alternative diellore, termale, etj.
2. Rritja e eficiencës së përdorimit të energjisë, duke mundësuar kursimin e përdorimit të saj me shfrytëzimin e pajisjeve termoizoluese në ndërtim, si dhe ndriçuesve e pajisjeve që harxhojnë pak (flourishente dhe luminishente, sipas standardeve të EU-së), si për ambientet publike, ashtu edhe ato familjare.
3. Reduktimi i harxhimit të lëndës drusore për ngrohje, duke rritur eficiencën e ngrohjes për sasi të njëjtë, ambiente të termoizoluara dhe teknologji të re për djegie, që përhap energjinë në sipërfaqe më të mëdha, duke përdorur burime alternative.

OS14: Sigurimi i një qeverisjeje të mirë vendore, transparente dhe bashkëpunuese me qytetarët, sektorin privat, njësitë e tjera vendore dhe ndërkufitare, si dhe me binjakëzime me njësi vendore në Evropë.

Politika: *Qeverisje e mirë vendore*

Reforma e re territoriale dhe ligji i ri i qeverisjes vendore u ka dhënë më shumë mundësi, fuqi dhe kompetenca autoriteteve të qeverisjes vendore për zhvillimin dhe qeverisjen e territorit. Sfida për fuqizimin e qeverisjes dhe integrimin në një sistem qeverisjeje të të gjithë territorit është thelbësore për strukturën e re të bashkisë. Territor i madh, akses i dobët në shërbime i popullsisë rurale, e cila gjendet larg qendrës urbane. Cilësia e dobët e shërbimeve publike për qytetarët, përfshirja e komunitetit në vendimmarrje, gjetja e instrumenteve efikase për thithjen dhe menaxhimin e fondeve janë disa nga problemet, me të cilat stafi i bashkisë së re përballet që në hapat e para të qeverisjes. Për të siguruar një qeverisje sa më të mirë dhe sa më afër qytetarëve, në strategji propozojmë këto masa.

Masat/Ndërhyrja:

1. Fuqizimi i pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje nëpërmjet bashkëpunimit, këshillimit dhe komunikimit të vazhdueshëm me qytetarët, si dhe krijimi i strukturës këshillimore qytetare, që përfaqëson interesat e komunitetit.

2. Ngritja e lehtësirave për një shërbim të shpejtë të qytetarëve, on-line dhe bashkëkohor nëpërmjet vendosjes së sistemit të zyrave me një ndalesë (Z1N).
3. Ngritja e një instrumenti financiar bashkëfinancimi i “Fondit të Besimit”, që ofron mbështetje financiare të vogla e të shpejta për iniciativat komunitare, rastet emergjente dhe bashkëkontributin në projekte me donatorë të ndryshëm, duke mundësuar aksesimin e fondeve të tjera, përdorimi me efikasitet i fondeve bashkiake dhe zgjidhja e çështjeve kritike në favor të komunitetit.
4. Forcimi i bashkëpunimit me bashkitë e tjera të qarkut Dibër, duke luajtur rolin e promotorit në rajon, duke kontribuar në qeverisjen e mirë të rajonit dhe duke luajtur një rol aktiv në strukturat dhe bordet e përbashkëta me drejtoritë dhe agjencitë rajonale, organizatat e shoqërisë civile dhe grupet e tjera të interesit.
5. Rritja e përpjekjeve për të vendosur ura të forta bashkëpunimi me Dibrën e Madhe, Gostivarin dhe Tetovën në çështje dhe projekte ndërkufitare.
6. Binjakëzimi me komunën e Meranos në Itali, duke shërbyer si model i ambicjeve dhe planeve të zhvillimit të territorit të Dibrës.

Kapitulli VIII: Plani i veprimeve (Plani i Investimeve Kapitale)

1. Plani i veprimit

Bashkia Dibër, pas një konsultimi me forumet qytetare dhe grupin e punës, si dhe duke vlerësuar atë çka qytetarët kanë si prioritet, ka si objektiv të saj realizimin e të gjitha objektivave të parashikuara në Planin e Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Dibër, duke vënë fokusin kryesor në përmirësimin e kushteve të jetesës dhe rritjen e aksesueshmërisë në shërbimet bazë për të gjithë komunitetin. Një rol të rëndësishëm në këtë aspekt merr përmirësimi i ndjeshëm i infrastrukturës së bashkisë (qyteti dhe qendra të njësive administrative), zhvillimi i bujqësisë, blegtorisë dhe turizmit malor (përfshi agroturizmin) si potencial për zhvillimin ekonomik të zonës dhe sigurisht, shfrytëzimi pozitiv i të gjitha burimeve natyrore dhe historike të zonës.

Realizimi i orientimeve strategjike, të përcaktuara në kapitullin V do të bëhet i mundur nëpërmjet planifikimit të ndarjes së investimeve, të përfshira këto në Planin e Investimeve kapitale (PIK) nga të gjitha burimet e mundshme të të ardhurave. Nëpërmjet rishikimit vit pas viti të këtij procesi, bashkia synon që, mbas 15 vitesh të ketë përmbushur vizionin për zhvillimin e saj të qëndrueshëm, në realizim të orientimeve dhe objektivave strategjike, të përcaktuara në një linje me politikat kombëtare të zhvillimit të territorit. (tabela që paraqet planin e veprimit për realizimin e projekteve në përmbushje të objektivave strategjike jepet bashkangjitur si Aneks 2)

2. Plani i Investimeve Kapitale

Plani i Investimeve Kapitale (PIK) në vetvete është një plan 3-5-vjeçar (plan afatmesëm, që rishikohet çdo vit në varësi të burimeve financiare në dispozicion të bashkisë), i cili hartohet me qëllim identifikimin e investimeve që bashkia do të aplikojë në këto vite. Ky dokument, i cili vjen si pjesë integrale e Planit të Zhvillimit të Territorit të bashkisë Dibër do të bëjë të mundur identifikimin e qartë dhe të saktë të objekteve që do të rikonstruktohen, bazuar te prioritetet e qytetarëve, periudhën e rikonstruksionit, koston e ndërtimit të secilit objekt, burimin e financimit, mënyrën e financimit në vite, etj.

Për procesin e PIK-ut janë grumbulluar të dhëna në lidhje me shumën totale që është parashikuar në buxhet për projekte kapitale, si dhe atë çka parashikon bashkia. Gjithashtu, duhet parashikuar mënyra e rritjes së burimeve financiare të bashkisë (nga të ardhurat e veta dhe nga burime të tjera alternative) gjatë periudhës së realizimit të Planit të Investimeve Kapitale. Në burimet kapitale (BK) do të futen edhe të gjitha të ardhurat e tjera, të cilat mund të përdoren për investime kapitale, si: grantet nga donatorët, grantet nga qeveria, të ardhurat nga përdorimi i pronave, dhënia me qera, ose shitja e aseteve të bashkisë, huatë, etj.

Identifikimi i burimeve kapitale do të bëjë të mundur realizimin hap pas hapi në kohë të PIK-ut dhe, për më tepër, do të mundësojë krijimin dhe institucionalizimin e mekanizmave të menaxhimit financiar të bashkisë.

Analiza financiare/Buxheti kapital

Të ardhurat kapitale përfshijnë fondet e disponueshme për investime kapitale në çdo vit. Bashkia Dibër ka një të ardhur, prej afërsisht 500 milion lekësh për vitin 2016. Vihet re që ky buxhet është dyfishuar, krahasimisht me vitin 2014 (me vlerën më të lartë, 308 milion, llogaritur për të gjitha 15-të ish-NJQV-të) dhe vitin 2013 (afërsisht, 302 milion lekë).

Për vitin 2016, për investimet parashikohet afërsisht një buxhet prej 200 milion lekësh (nga të ardhurat totale të bashkisë), pa llogaritur këtu donacionet dhe investimet nga palë të tjera. Nëse bashkia Dibër do të ketë mundësi të alokojë pothuajse të njëjtën vlerë për investime kapitale, parashikohet që projektet proritare, të dhëna më poshtë, të realizohen në gjashtë vitet e ardhshme.

Nëse të ardhurat e bashkisë do të rriten (vetëm për investimet) me 30-40% në vit, ky plan mund të realizohet në katër vite.

Më poshtë po listojmë disa nga burimet, që përbëjnë buxhetin kapital të bashkisë Dibër:

1. Buxheti i transferuar nga qeveria qendrore (e pakushtëzuar), që për vitin 2016 është afërsisht 315 milion lekë.
2. Transferta e kushtëzuar nga qeveria qendrore është një tjetër burim i financimit të investimeve kapitale (për vitin 2016, afërsisht 185 milion lekë). Në vitet e fundit, nga qeveria shqiptare (ministritë e Linjës) po aplikohet edhe skema e granteve konkurruese, ku njësitë vendore konkurrojnë me projekte për investime kapitale, projekte që në shumicën e rasteve i referohen përmirësimit të infrastrukturës rrugore. Përzgjedhja e tyre bëhet nga një komision i posaçëm mbi bazën e plotësimit të kriterëve të përcaktuara më parë.
3. Treguesit e realizimit të të ardhurave nga taksat/tarifat vendore. Bazuar në të dhënat e grumbulluara për nivelin e grumbullimit të taksave dhe tarifave për bashkinë Peshkopi dhe ish-komunat, niveli i parashikuar i të ardhurave nga ky zë buxheti mund të jetë rreth 100 milion lekë. Në funksion të Planit të Investimeve Kapitale, ky planifikim të ardhurash e shpenzimesh e lejon bashkinë të parashikojë me fonde në dispozicion të realizimit të tij për vitet në vazhdim, pavarësisht ndryshimeve strukturore të të ardhurave dhe shpenzimeve, ndryshime këto, të cilat mbajnë në nivele pothuajse konstante mbetjen operative të bashkisë.
4. Në të ardhurat lokale kapitale, ku përfshihen të ardhurat që vijnë vetëm një herë dhe të cilat krijohen, p.sh. nga shitja e një ndërtese në pronësi të bashkisë, por që nuk nevojitet për përdorim publik, apo nga dhënia me qera e një objekti apo aseti të vet me qëllim përdorimin për interesa publike, bashkia Dibër nuk parashikon të ketë të ardhura lokale kapitale për vetë inventarin e pronave që ajo disponon.

5. Aktualisht bashkia Dibër nuk ka filluar të krijojë një fond rezervë kapital, i cili të mund të përdoret për zëvendësimin e ndonjë pajisjeje kapitale në kohën kur kjo pajisje vjetërohet, ose për investime të tjera kapitale.
6. Përdorimi i huasë: aktualisht, me Ligjin nr.8652, datë 31.07.2000 Njësitë e Qeverisjes Vendore mund të marrin hua dhe kuadri ligjor tashmë është miratuar. Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008, “Për huamarrjen e Qeverisjes Vendore” u jep të drejtë Njësitë të Qeverisjes Vendore të marrin hua (afatshkurtër dhe afatgjatë) për të financuar investime kapitale (për investime kapitale operohet me huamarrje afatgjatë). Në këtë rast pagesat vjetore të huasë do të ishin prioriteti i parë në përdorimin e mbetjes operative, para se fondet të parashikoheshin për investime të reja kapitale, apo të fondit rezervë.
